



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 9 nëntor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

Tabela e përmbajtjes

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	5
II.	PARASHTRIME	6
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	9
IV.	DISKUTIM	13
A.	Intervistat e ZPS-së	15
1.	Përputhshmëria me Ligjin dhe Rregulloren e intervistave të ZPS-së me të akuzuarit sipas rregullës 138(2)	15
(a)	Intervista e ZPS-së me z. Thaçi e janarit 2020	15
i.	Parashtrime	15
ii.	Vlerësimi i Trupit Gjykses	17
(b)	Intervista e ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020	19
i.	Parashtrime	19
ii.	Vendimi i Trupit Gjykses	20
(c)	Intervista e ZPS-së me z. Selimi e nëntorit 2019	23
i.	Parashtrime	23
ii.	Vlerësimi i Trupit Gjykses	25
(d)	Intervista e ZPS-së me z. Selimi e shkurtit 2020	27
i.	Parashtrime	27
ii.	Vlerësimi i Trupit Gjykses	28
(e)	Përfundim	30
2.	Pranueshmëria e intervistave të ZPS-së me të akuzuarit dhe e provave materiale shoqëruese sipas rregullës 138(1)	30
(a)	Intervista e ZPS-së me z. Thaçi e janarit 2020	31
i.	Parashtrime	31
ii.	Vlerësimi i Trupit Gjykses	32
(b)	Intervista e ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020	35
i.	Parashtrime	35
ii.	Vlerësimi i Trupit Gjykses	36

(c)	Intervista e ZPS-së me z. Selimi e nëntorit 2019	39
i.	Parashtrime	39
ii.	Vlerësimi i Trupit Gjykues	39
(d)	Intervista e ZPS-së me z. Selimi e shkurtit 2020	42
i.	Parashtrime	42
ii.	Vlerësimi i Trupit Gjykues	42
(e)	Përfundim	45
B.	Intervistat e tjera si të dyshuar	45
1.	Përputhshmëria e intervistave të tjera të të akuzuarve si të dyshuar me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, sipas rregullës 138(2).....	45
(a)	Intervista e PSRK-së me z. Thaçi e vitit 2016	45
i.	Parashtrime	45
ii.	Vlerësimi i Trupit Gjykues	46
(b)	Intervista e PSRK-së me z. Krasniqi e dhjetorit 2013	47
i.	Parashtrime	47
ii.	Vlerësimi i Trupit Gjykues	49
(c)	Përfundim	50
2.	Pranueshmëria e intervistave të tjera të të akuzuarve si të dyshuar dhe e provave materiale shoqëruese sipas rregullës 138(1)	50
(a)	Intervista e PSRK-së me z. Thaçi e majit 2016.....	51
i.	Parashtrime	51
ii.	Vlerësimi i Trupit Gjykues	52
(b)	Intervista e PSRK-së me z. Krasniqi e dhjetorit 2013	53
i.	Parashtrime	53
ii.	Vlerësimi i Trupit Gjykues	54
(c)	Përfundim	56
C.	Deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitarë të të akuzuarve	56
1.	Deklaratat si dëshmitar të Thaçit	57
(a)	Parashtrime	57

(b)	Vlerësimi i Trupit Gjykues.....	58
i.	Deklarata e Thaçit si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011.....	58
ii.	Deklarata si dëshmitar e Thaçit dhënë PSRK-së në korrik 2018.....	61
iii.	Deklarata si dëshmitar e Thaçit dhënë TPNJ-së në maj 2004.....	62
(c)	Përfundim	65
2.	Deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Selimit.....	65
(a)	Parashtrime	65
(b)	Vlerësimi i Trupit Gjykues.....	67
i.	Deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë PSRK-së në shtator 2011.....	67
ii.	Deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë PSRK-së në qershor 2013.....	69
iii.	Deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë PSRK-së në tetor 2016.....	71
iv.	Deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë PSRK-së në maj 2018.....	73
v.	Dëshmia e Selimit e janarit 2018 në gjykimin e PSRK-së.....	75
vi.	Deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë TPNJ-së në prill 2004	77
vii.	Dëshmia e Selimit e majit 2005 në gjykimin e TPNJ-së.....	79
(c)	Përfundim	84
3.	Dëshmia dhe deklaratat si dëshmitar të Veselit	85
(a)	Parashtrime	85
(b)	Vlerësimi i Trupit Gjykues.....	85
i.	Deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë PSRK-së më 2010/2011.....	85
ii.	Deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë PSRK-së në shtator 2011	87
iii.	Deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë PSRK-së në korrik 2018.....	88
iv.	Dëshmia e Veselit e qershorit 2012 në gjykimin të EULEX-it	90
v.	Deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003	91
(c)	Përfundim	93
4.	Deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Krasniqit.....	93
(a)	Parashtrime	93
(b)	Vlerësimi i Trupit Gjykues.....	96
i.	Deklarata si dëshmitar e Krasniqit dhënë PSRK-së në qershor 2018	96

ii.	Dëshmia e Krasniqit e shkurtit 2018 në gjykimin e PSRK-së.....	98
iii.	Deklarata si dëshmitar e Krasniqit dhënë TPNJ-së në maj 2007	101
iv.	Dëshmia e Krasniqit e shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së	105
v.	Dëshmia e Krasniqit e majit 2007 në gjykimin e TPNJ-së.....	108
(c)	Përfundim	112
D.	Pranueshmëria e deklaratave të të akuzuarve kundër të bashkakuzuarve ...	112
1.	Parashtrime	113
2.	Vlerësimi i Trupit Gjykses.....	115
V.	KLASIFIKIMI.....	119
VI.	VENDIM.....	120

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21, 37-38 dhe 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 42-44 dhe 137-138 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 mars 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi një kërkesë për pranimin si prova të procesverbaleve të intervistave dhe dëshmive të mëhershme të Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Kadri Veselit ("z. Veseli"), Rexhep Selimit ("z. Selimi") dhe Jakup Krasniqit ("z. Krasniqi") (bashkërisht, "të akuzuarit") ("Kërkesa").¹

2. Më 24 prill 2023, pas dy zgjatjeve të njëpasnjëshme të afatit,² Mbrojtjet e z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit"), z. Veseli ("Mbrojtja e Veselit"), z. Selimi ("Mbrojtja e Selimit") dhe z. Krasniqi ("Mbrojtja e Krasniqit") dorëzuan përgjigjet ndaj Kërkesës (përkatësisht, "Përgjigjja e Thaçit", "Përgjigjja e Veselit", "Përgjigjja e Selimit" dhe "Përgjigjja e Krasniqit", bashkërisht, "Përgjigjet").³

¹ F01351, Prokurori i Specializuar, Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 8 mars 2023, me Shtojcën 1.

² F01378, Trupi Gjykues, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit, Selimit dhe Krasniqit për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Përgjigjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 16 mars 2023, para. 7, 8(b); Transkripti i seancës, 17 prill 2023, f. 2955, rreshti 17 deri në f. 2957, rreshti 4.

³ F01473, Mbrojtësi i Specializuar, Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Mocionit të ZPS-së për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 24 prill 2023, konfidenciale; F01474, Mbrojtësi i Specializuar, Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 24 prill 2023, konfidenciale; F01475, Mbrojtësi i Specializuar, Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 24 prill 2023, konfidenciale; F01476, Mbrojtësi i Specializuar, Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 24 prill 2023, konfidenciale.

3. Më 8 maj 2023, pas zgjatjes së afatit,⁴ ZPS-ja iu kundërpërgjigj Përgjigjeve (përkatësisht, “Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Thaçit”, “Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Veselit”, “Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Selimit” dhe “Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit”, bashkërisht “Kundërpërgjigjet”).⁵

4. Më 17 maj 2023, ZPS-ja dorëzoi një parashtrim plotësues të Kërkesës së saj (“Parashtrimi Plotësues”),⁶ me të cilin i kërkoi Trupit Gjykses që krahas materialeve të evidentuara më parë në Shtojcën 1 të Kërkesës⁷, të pranonte si prova edhe përkthimet e renditura në Shtojcën 1 të Parashtrimit Plotësues.

II. PARASHTRIME

5. ZPS-ja kërkon pranimin si prova të procesverbaleve të intervistave dhe dëshmime të mëhershme të të akuzuarve (“deklaratat”) dhe të çdo dokumenti procedural ose prove materiale shoqëruese (“provat materiale shoqëruese”). Deklaratat përbëhen nga tri kategori dokumentesh: (i) procesverbale të intervistave të ZPS-së me z. Thaçi dhe z. Selimi (“intervistat e ZPS-së”); (ii) dokumente të tjera të intervistave me z. Thaçi dhe z. Krasniqi si të dyshuar (“intervista të tjera si të dyshuar”); dhe (iii) procesverbale të intervistave dhe dëshmime të të akuzuarve si dëshmitarë të marra nga hetues të tjerë përveç ZPS-

⁴ F01486, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Zgjatje të Afatit për Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjeve të Mbrojtjes në lidhje me Mocionin për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 28 prill 2023, para. 11-12.

⁵ F01509, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Krasniqit në lidhje me Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 8 maj 2023, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 11 korrik 2023, F01509/RED); F01510, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Selimit në lidhje me Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 8 maj 2023, konfidenciale; F01511, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Thaçit në lidhje me Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 8 maj 2023, konfidenciale; F01512, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Veselit në lidhje me Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 8 maj 2023, konfidenciale.

⁶ F01533, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë Plotësuese e Prokurorisë në lidhje me Mocionin F01351*, 17 maj 2023, me Shtojcën 1.

⁷ Parashtrimi Plotësues, para. 2.

së (“deklarata dhe dëshmi si dëshmitarë”).⁸ ZPS-ja parashtron se deklaratat: (i) ishin në përputhje, sipas rastit përkatës, me kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara (“DHS-së”) dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;⁹ dhe (ii) kanë lidhje me lëndën, janë autentike e kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarit.¹⁰

6. Mbrojtja e Selimit kundërshton pranimin si prova të: (i) dy intervistave të ZPS-së me z. Selimi; dhe (ii) deklaratave dhe dëshmive si dëshmitar të z. Selimi dhe të provave materiale shoqëruese.¹¹ Mbrojtja e Selimit parashtron se, nëse Trupi Gjykses vlerëson se ndonjë prej deklaratave të të akuzuarit është e pranueshme si provë, këto deklarata duhet të përdoren në mënyrë të kufizuar dhe ato: (i) duhet të pranohen si prova vetëm kundër personit që ka dhënë deklaratën ose intervistën e jo si prova kundër të bashkakuzuarve të tjerë; dhe, në çdo rast, (ii) të mos pranohen si prova në lidhje me veprimet dhe sjelljen e të bashkakuzuarve, ose si prova në lidhje me elemente kritike të provave dhe argumenteve të ZPS-së, përveç nëse konfirmohen nga prova të tjera.¹²

7. Mbrojtja e Thaçit kundërshton pranimin si prova të dy intervistave të ZPS-së me z. Thaçi¹³ dhe shënimit të hetuesit në lidhje me intervistën që z. Thaçi i dha si dëshmitar Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”) në maj 2004.¹⁴ Mbrojtja e Thaçit nuk kundërshton pranimin si provë të intervistës si i dyshuar dhe deklaratave si dëshmitar dhënë Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (“PSRK”).¹⁵ Mbrojtja e Thaçit kundërshton përdorimin e deklaratave të një të bashkakuzuari dhënë jashtë gjykimit si prova në lidhje me elemente kritike

⁸ Kërkesa, para. 1; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 2-12.

⁹ Kërkesa, para. 2.

¹⁰ Kërkesa, para. 2, 90.

¹¹ Përgjigja e Selimit, para. 2-3.

¹² Përgjigja e Selimit, para. 59, 84.

¹³ Përgjigja e Thaçit, para. 9, 25.

¹⁴ Përgjigja e Thaçit, para. 31.

¹⁵ Përgjigja e Thaçit, para. 34.

të provave dhe argumenteve të ZPS-së përveç nëse konfirmohen nga prova të tjera, apo si prova të veprimeve dhe sjelljes së z. Thaçi.¹⁶

8. Mbrojtja e Krasniqit kundërshton pranimin e të gjitha deklaratave të mëhershme të z. Krasniqi, pasi efekti dëmtues i pranimin të këtyre provave, disa prej të cilave u morën në shkelje të të drejtave të z. Krasniqi, zhbën vlerën provuese të tyre.¹⁷ Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu kundërshton pranimin si prova të deklaratave të mëhershme të të bashkakuzuarve, në qoftë se ZPS-ja synon të mbështetet në dëshmitë e tyre kundër z. Krasniqi, sepse ai ka të drejtën të ballafaqojë provat kundër tij.¹⁸ Së fundi, Mbrojtja e Krasniqit kundërshton pranimin e çdo prove materiale shoqëruese të këtyre deklaratave të mëhershme.¹⁹

9. Mbrojtja e Veselit nuk kundërshton pranimin e deklaratave të dhëna më parë nga z. Veseli. Sidoqoftë, Mbrojtja e Veselit parashtrohet se, në qoftë se deklaratat e të bashkakuzuarve pranohen, Trupi Gjyqësor duhet të kufizojë qëllimin për të cilin pranohen, që ato të mos mund të përdoren kundër të bashkakuzuarve.²⁰ Si alternativë, Mbrojtja e Veselit parashtrohet se disa pjesë të deklaratave të të bashkakuzuarve duhet të përjashtohen, pasi efekti dëmtues zhbën vlerën e tyre provuese.²¹ Së fundi, Mbrojtja e Veselit kundërshton pranimin e disa provave materiale që kanë lidhje me deklaratat e të bashkakuzuarve.²²

10. ZPS-ja kundërpërgjigjet se të gjitha deklaratat dhe provat materiale shoqëruese janë të pranueshme pasi: (i) ZPS-ja ka përmbushur detyrimet e zbatueshme në intervistat e ZPS-së, përfshirë informimin e mjaftueshëm të të akuzuarve për akuzat kundër tyre;²³ (ii) të akuzuarve iu akorduan të drejtat e të

¹⁶ Përgjigja e Thaçit, para. 35-36.

¹⁷ Përgjigja e Krasniqit, para. 2.

¹⁸ Përgjigja e Krasniqit, para. 3.

¹⁹ Përgjigja e Krasniqit, para. 4, 75.

²⁰ Përgjigja e Veselit, para. 3.

²¹ Përgjigja e Veselit, para. 4.

²² Përgjigja e Veselit, para. 5.

²³ Kundërpërgjigja ndaj Përgjigjes së Thaçit, para. 8; Kundërpërgjigja ndaj Përgjigjes së Selimit, para. 2-17.

dyshuarve gjatë intervistave të tjera të tyre si të dyshuar;²⁴ (iii) në kundërshtim me çka parashtrohet Mbrojtja, të akuzuarve nuk u takonin të drejtat si të dyshuar gjatë dhënies së deklaratave dhe dëshmimeve të tyre si dëshmitarë, dhe, rrjedhimisht, të drejtat e tyre u respektuan;²⁵ dhe (iv) të gjitha provat materiale shoqëruese janë të pranueshme, për arsye se Mbrojtja nuk ka vërtetuar mjaftueshëm pse nuk duhet të pranohen dhe ato janë pjesë “e pandashme dhe e domosdoshme” e dokumentacionit të çështjes.²⁶ Së fundi, ZPS-ja parashtrohet se deklaratat janë të pranueshme pa kufizime, përfshirë kundër të bashkakuzuarve.²⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Sipas nenit 37(1), pranueshmëria e provave të mbledhura gjatë procedurave ose hetimeve penale brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara para themelimit të tyre nga ndonjë autoritet ose agjenci kombëtare ose ndërkombëtare për zbatimin e ligjit ose për zhvillimin e hetimeve penale, përfshirë Prokurorin e Shtetit të Kosovës, autoritetet policore të Kosovës, TPNJ-në, Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (“EULEX”) ose Task Forcën Hetimore Speciale (“TFHS”), vendoset nga panele të caktuara në pajtim me standardet ndërkombëtare për mbledhjen e provave dhe nenin 22 të Kushtetutës.

12. Në bazë të nenit 37(3)(a), transkriptet e dëshmimeve të dhëna nga dëshmitarët para TPNJ-së dhe procesverbalet e deklaratave të dëshmitarëve në TPNJ-së në pajtim me rregullën 71 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të TPNJ-së, mund të jenë të pranueshme para Dhomave të Specializuara, me kusht që dëshmia

²⁴ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 13.

²⁵ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 3; Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Selimit, para. 13-17.

²⁶ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Thaçit, para. 9; Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 15; Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Veselit, para. 6.

²⁷ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Thaçit, para. 10, f. 5-6; Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 14; Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Veselit, para. 2-3; Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Selimit, para. 10, f. 6-7.

ose deklaratat të kenë lidhje me një fakt nën shqyrtim në procesin para Dhomave të Specializuara. Në mënyrë të ngjashme, në bazë të nenit 37(3)(b), transkriptet e dëshmimeve të dëshmitarëve dhënë në një gjykatë të Kosovës mund të jenë të pranueshme në Dhomat e Specializuara.

13. Sipas nenit 38(3) dhe rregullave 42-44, nëse merret në pyetje, i dyshuari nuk detyrohet të fajësojë veten apo të pranojë fajësinë. I dyshuari ose e dyshuara nuk i nënshtrohet asnjë forme të shtrëngimit, trysnisë apo kërcënimit, torturës dhe asnjë forme tjetër të trajtimit apo ndëshkimit mizor, çnjërzor dhe degradues. Ai ose ajo ka të drejtat në vijim, për të cilat informohet para marrjes në pyetje, në një gjuhë që ai ose ajo e flet dhe e kupton:

- a. të drejtën për t'u informuar se ekzistojnë arsye për të besuar se ai ose ajo ka kryer një vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara;
- b. të drejtën për të heshtur, ku kjo heshtje nuk merret parasysh për përcaktimin e fajësisë ose të pafajësisë, dhe për t'u paralajmëruar se çdo deklaratë që ai ose ajo jep regjistrohet dhe mund të përdoret si provë;
- c. të drejtën për t'u ndihmuar nga Mbrojtësi i Specializuar i zgjedhur prej tij/saj dhe për t'u marrë në pyetje në prani të Mbrojtësit të Specializuar, si dhe të drejtën për të pasur ndihmë ligjore falas të ofruar nga Dhomat e Specializuara kur ai ose ajo nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për të;
- d. të drejtën për të pasur ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur ai ose ajo nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e përdorur gjatë marrjes në pyetje.

14. Sipas rregullës 140(4), shpallja e fajësisë nuk mund të bazohet vetëm, ose në masë vendimtare, në deklaratën e një dëshmitari të cilin Mbrojtja nuk ka pasur

mundësi ta pyesë.²⁸

15. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se: (i) në bazë të nenit 40(6)(h), trupi gjykses mund të nxjerrë vendim mbi pranueshmërinë e provave para shqyrtimit gjyqësor ose gjatë tij; dhe (ii) në bazë të rregullës 138(1), në rast se nuk janë kundërshtuar ose përjashtuar *proprio motu*, provat e paraqitura trupit gjykses pranohen vetëm në qoftë se kanë lidhje me lëndën, kanë vlerë provuese dhe vlera provuese e tyre nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.²⁹

16. Trupi Gjykses vëren se Ligji dhe Rregullorja nuk rregullojnë shprehimisht aspektin e pranueshmërisë së deklaratave të të akuzuarit në përgjithësi dhe në lidhje me të bashkakuzuarit në veçanti. Për pranimin si prova të kësaj kategorie materialesh zbatohen rregullat dhe parimet e përgjithshme për pranimin e provave në këtë juridiksion. Tribunalët penalë ndërkombëtarë kanë përcaktuar se nuk ka ndalim të përgjithshëm për pranimin si provë të procesverbalit të një interviste ose deklarate të një të akuzuari, në qoftë se ajo u dha vullnetarisht, në përputhje me kornizën ligjore përkatëse dhe është relevante dhe me vlerë provuese.³⁰ Pranueshmëria e deklaratës ose procesverbalit të intervistës së një të akuzuari në lidhje me të bashkëpandehurit, trajtohet më poshtë.³¹

17. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se, në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut një person i “akuzuar për një vepër penale”, siç është rasti me një të dyshuar që merret në pyetje lidhur me përfshirjen e pretenduar të tij në akte që përbëjnë vepër penale, mund të kërkojë mbrojtjen që

²⁸ F01603, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 155* (“Vendimi sipas Rregullës 155”), 14 qershor 2023, konfidencial, para. 18 dhe referencat e cituara në të (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 shtator 2023, F01603/RED).

²⁹ F01409, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore* (“Vendimi i Parë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore”), 31 mars 2023, konfidencial, para. 8-13 dhe referencat në poshtëshënimet 11-29.

³⁰ Shih *p.sh.* ICTY, *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-T, Trial Chamber I(A), Decision on Motion for Exclusion of Statement of Accused (“[Halilović Trial Decision](#)”), 8 July 2005, para. 18, dhe referencat e cituara aty.

³¹ Shih më poshtë Pjesën IV.D.

ofron neni 6 i Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa Evropiane").³² Më konkretisht, personi: (i) ka të drejtë të informohet për llojin dhe shkakun e akuzave kundër tij brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai ose ajo e kupton (neni 6(3)(a) i Konventës Evropiane);³³ (ii) ka të drejtë të njoftohet për të drejtën e mosinkriminimit të vetes dhe të drejtën për të heshtur; dhe (iii) duhet t'i mundësohet përfaqësim juridik që nga momenti i ngritjes së një akuze penale kundër tij ose saj (neni 6(3)(c) i Konventës Evropiane).

18. E drejta për përfaqësim juridik nuk është e drejtë absolute, por është tipar themelor i gjykit të drejtë. Një person mund të heqë dorë nga e drejta për të pasur mbrojtës por nuk mund të heqë dorë nga e drejta për gjykim të drejtë. Sidoqoftë, heqja dorë nga ushtrimi i një të drejte duhet të bëhet në një mënyrë që nuk le asnjë dyshim dhe të shoqërohet me garanci minimale që i përgjigjen rëndësisë së saj. Duke qenë se e drejta për mbrojtës përbën një garanci themelore për gjykim të drejtë, heqja dorë prej saj duhet të bëhet vullnetarisht dhe në mënyrë të vetëdijshme dhe racionale.³⁴ Kjo do të thotë se i dyshuari që heq dorë nga kjo e drejtë, duhet të ketë dijeni për të drejtat e tij, përfshirë të drejtën për të pasur mbrojtës.³⁵ Mund të thuhet se një i dyshuar ka hequr dorë nga e drejta për mbrojtës

³² KSC-BC-2020-04, Trupi Gjykses I, F00364, *Vendim në lidhje me Deklaratat e Mëparshme të Pjetër Shalës*, 6 dhjetor 2022, konfidencial, para. 24 (versioni i korrigjuar u dorëzua si konfidencial më 8 dhjetor 2022, F00364/COR; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 26 janar 2023, F00364/COR/RED); European Court of Human Rights ("ECtHR"), *Aleksandr Zaichenko v. Russia*, Application no. 39660/02, [Judgment](#), 18 February 2010, para. 41-43. *Shih gjithashtu*, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave Civile dhe Politike, 16 dhjetor 1966, *U.N.T.S.*, Vol. 999, p. 171, neni 14.

³³ Ky nen nuk përcakton ndonjë kriter formal konkret për mënyrën se si duhet të informohet i akuzuari për llojin dhe shkakun e akuzës kundër tij; *shih* ECtHR, *Giosakis v. Greece (no. 3)*, Application no. 5689/08, [Judgment](#), 3 May 2011, para. 29.

³⁴ ECtHR, *Simeonovi v. Bulgaria*, Application no. 21980/04, *Judgment* ("[Simeonovi Judgment](#)"), 12 May 2017, para. 115; *Pishchalnikov v. Russia*, Application no. 7025/04, *Judgment* ("[Pishchalnikov Judgment](#)"), 24 September 2009, para. 77.

³⁵ ECtHR, [Simeonovi Judgment](#), para. 119; *Ibrahim and Others v. the United Kingdom*, Application nos. 50541/08 and 3 others, *Judgment* [GC] ("[Ibrahim and Others Judgment](#)"), 13 September 2016, paras 272-273.

në mënyrë të nënkuptuar, nëpërmjet sjelljes së tij, nëse vërtetohet se mund të kishte parashikuar logjikisht se cilat do të ishin pasojat e sjelljes së vet.³⁶

19. Gjithashtu, sipas nenit 6(3)(e) të Konventës Evropiane, një person që nuk kupton ose nuk flet gjuhën që përdoret në gjykatë, ka të drejtën e ndihmës pa pagesë të një përkthyesi, kur procesi zhvillohet në një gjuhë të ndryshme nga gjuha e tij.³⁷

IV. DISKUTIM

20. Trupi Gjykses vëren se: (i) katër intervistat në fjalë të ZPS-së u kryen si intervista me të dyshuar sipas Ligjit dhe Rregullores;³⁸ (ii) dy intervistat e tjera si të dyshuar, u kryen si intervista me të dyshuar nga hetuesit e PSRK-së sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (“KPPK”);³⁹ dhe (iii) deklaratat dhe dëshmitë e tjera të të akuzuarve si dëshmitarë u kryen nga PSRK-ja, TPNJ-ja, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”) dhe para Gjykatës Themelore të Gjakovës dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.⁴⁰

21. Trupi Gjykses do të vlerësojë nëse: (i) intervistat e ZPS-së, intervistat e tjera të të akuzuarve si të dyshuar dhe deklaratat dhe dëshmitë e tyre si dëshmitarë u morën në përputhje me kornizën ligjore të DHS-së dhe/ose me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, sipas rregullës 138(2); (ii) intervistat e ZPS-së, intervistat e tjera të të akuzuarve si të dyshuar, deklaratat e dëshmitë të tyre si dëshmitarë dhe provat materiale shoqëruese të tjera përmbushin kriteret

³⁶ ECtHR, *Simeonovi Judgment*, para. 115; *Pishchalnikov Judgment*, para. 77.

³⁷ ECtHR, *Baytar v. Turkey*, Application no. 45440/04, *Judgment*, 14 October 2014, para. 49; *Hermi v. Italy*, Application no. 18114/02, *Judgment [GC]*, 18 October 2006, paras 69-70; *Kamasinski v. Austria*, Application no. 9783/82, *Judgment*, 19 December 1989, para. 74.

³⁸ Kërkesa, para. 4-21; Shtojca e Kërkesës, f. 2-3.

³⁹ Kërkesa, para. 22-29; Shtojca e Kërkesës, f. 3-4.

⁴⁰ Kërkesa, para. 30-89; Shtojca e Kërkesës, f. 4-12.

kumulative të rregullës 138(1) për pranimin e provave; dhe; (iii) ka kufizime për përdorimin e tyre kundër të bashkakuzuarve.

22. Trupi Gjykses vë në disa prova materiale shoqëruese ka materiale që duket se janë përsëritje të: (i) materialeve (ose përkthimeve të tyre) të paraqitura si pjesë e provave materiale shoqëruese të tjera;⁴¹ ose (ii) materialeve (ose përkthimeve të tyre) të paraqitura për pranim më parë dhe për të cilat Trupi Gjykses tashmë ka marrë vendim.⁴² Pranimi i versioneve përsëritëse të të njëjtit dokument është përgjithësisht i padëshirueshëm pasi nuk i shton realisht asgjë dokumentacionit të provave në proces. Por Trupi Gjykses është i vetëdijshëm edhe se mospranimi si prova i dokumenteve përsëritëse që lidhen me një deklaratë do të shkaktonte shpërndarjen e materialeve që kanë lidhje me një deklaratë. Trupi Gjykses është gjithashtu i vetëdijshëm se materialet (ose përkthimet e tyre), pranimi i të cilave

⁴¹ *Shih p.sh.* 071794-071839, f. 071820-071821, 071834 dhe IT-04-84 P00328, f. U016-2148, U016-2152 dhe IT-03-66 P49, f. 8, 12-13 dhe U003-8552-U003-8690, f. U003-8573-U003-8574; U003-8577-U003-8578; 076565-076705, f. 076588-076596 dhe 074440-074458A, f. 074440-074443, 074447; IT-04-84 P00328, f. U016-2102-U016-2143, U016-2149-U016-2186 dhe U003-8552-U003-8690, f. U003-8552-U003-8590, U003-8623-U003-8624 dhe IT-03-66 P49, f. 1-4, 11-13, 19, 28; IT-03-66 P49, f. 1-5, 9-11, 17-20, 25, 27-28 dhe U003-8552-U003-8690, f. U003-8580-U003-8590, U003-8554, U003-8561-U003-8562, U003-8566-U003-8567, U003-8571, U003-8575, U003-8611-U003-8612, U003-8619-U003-8620, U003-8623-U003-8624, U003-8630, U003-8646-U003-8647, U003-8660.

⁴² *Shih p.sh.* 071794-071839, f. 071817-071819 (pranuar si P00269), 071820-071821, 071834 (pranuar si P00270), 071836 (pranuar si P00292), 071837 (pranuar si P00544), 071839 (pranuar si 1D00029); 076565-076705, f. 076565-076566 (pranuar si P00158), 076580-076587 (pranuar si P00112 dhe P00113), 076588-076591 (pranuar si P00159), 076592-076595 (pranuar si P00161); 074440-074458A, f. 074440-074441 (pranuar si P00159), 074448-074449 (pranuar si P00300), 074450, 074451, 074453 (pranuar si P00189), 074455 (pranuar si P00158); IT-04-84 P00328, f. U016-2148-U016-2148 (pranuar si P00286), U016-2150-U016-2152 (pranuar si P00155 dhe P00270, f. U008-1614), U016-2133-U016-2134 (pranuar si P00271, f. U003-8566-U003-8567), U016-2142 (pranuar si P00271, f. U003-8571); IT-03-66 P49, f. 5-11 (pranuar si P00270, f. U008-1607-U008-1613), 12 (pranuar si P00155 dhe P00270, f. U008-1614), 13-14 (pranuar si P00270, f. U008-1615-U008-1616), 15 (pranuar si P00156 dhe P00270, f. U008-1617), 16-22 (pranuar si P00270, f. U008-1618-U008-1624), 25-30 (pranuar si P00270, f. U008-1627-U008-1632), 31 (pranuar si P00256 dhe P00270, f. U008-1633), 32 (pranuar si P00270, f. U008-1634); IT-03-66 P138 (pranuar si P00293); U003-8552-U003-8690, f. U003-8566-U003-8567; U003-8571-U003-8571; U003-8611-U003-8612; U003-8660-U003-8660 (pranuar si P00271); IT-03-66 P248 (refuzuar); 071764-071839, f. 071835 (refuzuar si U000-8992-U000-8992); 076565-076705, f. 076605-076612 (refuzuar si pjesë e 007789-008966), 076642 (refuzuar si SPOE00128571-00128954, f. 00128571), 076705 (refuzuar si 058755-058755); 074440-074458A, f. 074457-074458A (refuzuar si U008-1602-U008-1636, f. U008-1605-U008-1606); IT-03-66 P49, f. 19, 23, 33 (refuzuar si U008-1602-U008-1636, f. U008-1621, U008-1625, U008-1635); U003-8552-U003-8690, f. U003-8552-U003-8565, U003-8568-U003-8570, U003-8572-U003-8610, U003-8613-U003-8659, U003-8661-U003-8690 (refuzuar).

është refuzuar më parë, mund të pranohen si prova nëse Trupi Gjykses tani bindet se janë përmbushur kriteret e rregullës 138(1). Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të vlerësojë nëse provat materiale shoqëruese janë pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e deklaratave përkatëse dhe përmbushin kriteret e rregullës 138(1) dhe, nëse bindet që po, do t'i pranojë si prova, përfshirë edhe kur një provë materiale shoqëruese është përsëritje e një materiali të pranuar më parë si provë.

A. INTERVISTAT E ZPS-SË

1. Përputhshmëria me Ligjin dhe Rregulloren e intervistave të ZPS-së me të akuzuarit sipas rregullës 138(2)

(a) Intervista e ZPS-së me z. Thaçi e janarit 2020 ⁴³

i. Parashtrime

23. ZPS-ja parashtrohet se: (i) intervista e ZPS-së me z. Thaçi e janarit 2020 u krye nga ZPS-ja gjatë hetimit të saj në bazë të Ligjit dhe Rregullores dhe në përputhje me to;⁴⁴ dhe (ii) të drejtat e z. Thaçi u respektuan duke qenë se z. Thaçi u informua se po hetohej penalisht dhe se ekzistonin arsye për të besuar se ai ishte përfshirë në kryerjen e një veprë penale brenda juridiksionit të DHS-së, se kishte të drejtën për të heshtur, të drejtën për ndihmën pa pagesë të një përkthyesi dhe të drejtën për të pasur një avokat të pranishëm.⁴⁵ ZPS-ja parashtrohet se z. Thaçi konfirmoi që i kishte kuptuar këto të drejta dhe në mënyrë racionale hoqi dorë nga e drejta për të heshtur dhe për të pasur avokat të pranishëm gjatë marrjes në pyetje.⁴⁶

24. Mbrojtja e Thaçit kundërshton pranimin sipas rregullës 138(2)⁴⁷ të intervistës së ZPS-së të janarit 2020 dhe provave materiale shoqëruese. Konkretisht, Mbrojtja

⁴³ 071840-TR-ET Pjesët 1-9.

⁴⁴ Kërkesa, para. 2, 4.

⁴⁵ Kërkesa, para. 5-7.

⁴⁶ Kërkesa, para. 7.

⁴⁷ Përgjigja e Thaçit, para. 9.

e Thaçit parashtroi se, para se të vendoste të hiqte dorë nga të drejtat e tij, ZPS-ja nuk e informoi mjaftueshëm z. Thaçi për akuzat me të cilat mund të përballej në DHS dhe, për rrjedhojë, ai nuk mund të bënte zgjedhje të bazuar në informacion të plotë për heqjen dorë nga e drejta për të heshtur dhe për të pasur mbrojtës, gjë që ishte në shkelje të të drejtave të tij.⁴⁸ Mbrojtja e Thaçit argumenton se e drejta e një të dyshuari për t'u informuar për akuzat kundër tij është ngushtësisht e lidhur me aftësinë e tij për të bërë zgjedhje bazuar në informacion dhe vullnetarisht për heqjen dorë nga e drejta për mbrojtës dhe e drejta për të heshtur.⁴⁹ Duke qenë se z. Thaçi nuk u informua me hollësi për akuzat kundër tij, por iu dha vetëm informacion shumë i përgjithshëm se për çfarë akuzohej, ai nuk mund të bënte zgjedhje të bazuar në informacion të plotë për të hequr dorë nga e drejta për mbrojtës - kjo është shkelje e të drejtave të tij dhe bazë për përjashtimin e intervistës.⁵⁰ Mbrojtja e Thaçit parashtroi se faza e avancuar e hetimit në të cilën u krye intervista është veçanërisht relevante, pasi ZPS-ja duhet ta kishte informuar z. Thaçi shumë më hollësisht për akuzat kundër tij.⁵¹

25. Në kundërpërgjigje, ZPS-ja përsërit argumentet e saj se z. Thaçi u informua se dyshohej për kryerje krimesh brenda juridiksionit të DHS-së dhe se kishte të drejtën për mbrojtës dhe për të heshtur.⁵² Gjithashtu, ZPS-ja kundërpërgjigjet se z. Thaçi ishte informuar mjaftueshëm për akuzat kundër tij pasi, në kohën kur u krye intervista ende nuk ishte ngritur aktakuzë dhe, sikurse konstatoi Gjykata e Apelit “nuk ekziston një kriter i përgjithshëm apo standard për njoftimin e të dyshuarit për kohën, vendin dhe sjelljen konkrete për të cilën dyshohet”.⁵³

⁴⁸ Përgjigjja e Thaçit, para. 9.

⁴⁹ Përgjigjja e Thaçit, para 15.

⁵⁰ Përgjigjja e Thaçit, para. 18.

⁵¹ Përgjigjja e Thaçit, para. 19-22.

⁵² Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Thaçit, para. 4.

⁵³ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Thaçit, para. 5-7 që i referohet KSC-BC-2020-04, IA006-F00007, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit në lidhje Deklaratat e Mëparshme* (“Vendimi mbi Apelin në Çështjen Shala”), 5 maj 2023, para. 42.

ii. Vlerësimi i Trupit Gjykues

26. Trupi Gjykues vëren se gjatë intervistës së janarit 2020, z. Thaçi u informua nga ZPS-ja se: (i) ajo po hetonte pretendime për krime të rënda ndërkombëtare dhe ndërkufitare të kryera në Kosovë dhe në disa pjesë të Republikës së Shqipërisë mes viteve 1998 dhe 2000; dhe (ii) kishte arsye për të besuar se ai ishte përfshirë në kryerjen e një vepre penale brenda juridiksionit të DHS-së.⁵⁴ Në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes së Thaçit,⁵⁵ Trupi Gjykues vëren se në Ligj, Rregullore ose jurisprudencën e GJEDNJ-së nuk ka asnjë kriter formal konkret për mënyrën se si duhet të informohet i akuzuari për llojin dhe shkakun e akuzës kundër tij.⁵⁶ Nuk ekziston një kriter i përgjithshëm apo standard për njoftimin e të dyshuarit për kohën, vendin dhe sjelljen konkrete për të cilën dyshohet.⁵⁷ Trupi Gjykues vëren se Gjykata e Apelit ka konstatuar se “shkalla e hollësive që priten të jepen gjatë intervistimit të një të dyshuari është përgjithësisht më e ulët se ajo që kërkohet kur ndaj personit që merret në pyetje është ngritur aktakuzë”.⁵⁸

27. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se gjatë intervistës z. Thaçi u pyet për incidente konkrete, që i dha atij informacion të mëtejshëm për hetimin e ZPS-së. Trupi Gjykues vlerëson se, duke marrë parasysh se çështja ishte ende në fazë hetimi, pasi Aktakuza nuk ishte dorëzuar ende për konfirmim,⁵⁹ informimi në përgjithësi i z. Thaçi për llojin dhe shkakun e dyshimeve ose pretendimeve ndaj

⁵⁴ 071840-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshtat 10-12, 15-19.

⁵⁵ Përgjigjja e Thaçit, para. 9.

⁵⁶ Vendimi mbi Apelin në Çështjen Shala, para. 42. Shih gjithashtu më lart para. 17, poshtëshënimin 33.

⁵⁷ Vendimi mbi Apelin në Çështjen Shala, para. 42. Shih gjithashtu ECtHR, [Ibrahim and Others Judgment](#), para. 253; *Penev v. Bulgaria*, Application no. 20494/04, Judgment (“[Penev Judgment](#)”), 7 January 2010, paras 33; *Mattoccia v. Italy*, Application no. 23969/94, Judgment (“[Mattoccia Judgment](#)”), 25 July 2000, paras 59-60; *Imbrioscia v. Switzerland*, Application no. 13972/88, Judgment (“[Imbrioscia Judgment](#)”), 24 November 1993, para. 38.

⁵⁸ Vendimi mbi Apelin në Çështjen Shala, para. 43.

⁵⁹ F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 1-14. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED.

tij, ishte i mjaftueshëm që ai të merrte një vendim të bazuar në informacion lidhur me heqjen dorë nga të drejtat e tij.⁶⁰ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se z. Thaçi nuk u ankua gjatë intervistës kishte shumë pak informacion në lidhje me krimet për të cilat dyshohej.

28. Sa u përket të drejtave, Trupi Gjykses vëren se z. Thaçi u informua se: (i) intervista po incizohej;⁶¹ (ii) kishte të drejtën të heshte;⁶² (iii) kishte të drejtën të ndihmohej nga një avokat;⁶³ (iv) çdo deklaratë e bërë mund të përdorej si provë kundër tij në DHS;⁶⁴ dhe (v) kishte të drejtën të kishte një përkthyes.⁶⁵ Gjithashtu, atij iu dha një dokument me shkrim me të drejtat dhe detyrimet e tij.⁶⁶

29. Gjatë intervistës, z. Thaçi: (i) konfirmoi se dëshironte të intervistohej pa praninë e një avokati dhe se, në qoftë se do ta gjykonte të nevojshme, do të ushtronte të drejtën për të pasur të pranishëm një avokat;⁶⁷ (ii) konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat e tij;⁶⁸ (iii) u ndihmua nga një përkthyes;⁶⁹ (iv) konfirmoi se deklarata u dha vullnetarisht,⁷⁰ se nuk ishte kërcënuar apo detyruar që të paraqitej në intervistë⁷¹ dhe se nuk i ishte dhënë asnjë premtim, garanci apo nxitje për të dhënë dëshmi;⁷² (v) tha se intervista ishte “nxitim i panevojshëm” por nuk pati kundërshtime lidhur me mënyrën e zhvillimit të intervistës.⁷³ Gjithashtu, intervista u incizua dhe më pas u transkriptua, ndërsa në intervistën vijuese, të

⁶⁰ *Shih* ECtHR, *Ibrahim and Others Judgment*, para. 253; *Penev Judgment*, para. 33; *Mattoccia Judgment*, para. 60; *Imbrioscia Judgment*, para. 38.

⁶¹ 071840-TR-ET Pjesa 1, f. 1, rreshtat 7-10, f. 2, rreshtat 23-25.

⁶² 071840-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshtat 20-22.

⁶³ 071840-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 6-7.

⁶⁴ 071840-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshtat 15-16.

⁶⁵ 071840-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 13-16.

⁶⁶ 071793-071793-ET.

⁶⁷ 071840-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 8-12.

⁶⁸ 071840-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 18-20.

⁶⁹ 071840-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 15-16.

⁷⁰ 071840-TR-ET Pjesa 9, f. 7, rreshtat 8-10.

⁷¹ 071840-TR-ET Pjesa 9, f. 7, rreshtat 11-12.

⁷² 071840-TR-ET Pjesa 9, f. 7, rreshtat 14-16.

⁷³ 071840-TR-ET Pjesa 9, f. 7, rreshtat 17-19.

akuzuarit iu dha mundësia të sqaronte, plotësonte ose ndryshonte ndonjë gjë kishte thënë gjatë intervistës.⁷⁴

30. Trupi Gjykses konstaton se z. Thaçi u informua plotësisht për të drejtat e tij si i dyshuar dhe se heqja dorë prej së drejtës për t'u ndihmuar nga një avokat u bë vullnetarisht dhe në mënyrë të qartë, të vetëdijshme dhe racionale.⁷⁵

31. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të z. Thaçi sipas Ligjit dhe Rregullores.

(b) Intervista e ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020 ⁷⁶

i. Parashtrime

32. ZPS-ja parashtron se: (i) intervista e ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020 u krye gjatë hetimit të ZPS-së sipas Ligjit dhe Rregullores dhe në përputhje me to⁷⁷; dhe (ii) ashtu si edhe gjatë intervistës së ZPS-së të janarit 2020, edhe gjatë kësaj interviste të drejtat e z. Thaçi u respektuan.⁷⁸ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se gjatë kësaj interviste: (i) gjatë marrjes në pyetje, përfaqësuesi ligjor i z. Thaçi ishte i pranishëm përmes videolidhjes; (ii) përfaqësuesit ligjor iu dha një kopje e dokumentit me shkrim me të drejtat e z. Thaçi; (iii) z. Thaçi iu dha mundësia të sqaronte, plotësonte ose ndryshonte përgjigjet e tij aty ku e gjykonte të nevojshme; dhe (iv) z. Thaçi konfirmoi se nuk ishin përdorur kërcënime apo dhunë për t'i bërë presion që t'u përgjigjej pyetjeve.⁷⁹

33. Mbrojtja e Thaçit kundërshton pranimin e intervistës së ZPS-së të korrikut 2020 dhe përsërit argumentet e paraqitura në lidhje me intervistën e ZPS-së të

⁷⁴ 076563-TR-ET Pjesa 2, f. 2, rreshti 21 deri në f. 22, rreshti 16.

⁷⁵ *Shih* ECtHR, [Ibrahim and Others Judgment](#), para. 272.

⁷⁶ 076563-TR-ET Pjesët 1-21.

⁷⁷ Kërkesa, para. 2, 4.

⁷⁸ *Shih më lart* para. 23. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 9-12.

⁷⁹ Kërkesa, para. 9-12.

janarit 2020.⁸⁰ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit parashtroi se, në këtë fazë, kishte edhe më pak arsye për të mos e informuar me hollësi të mjaftueshme z. Thaçi për akuzat kundër tij, pasi ZPS-ja tashmë kishte dorëzuar Aktakuzën për konfirmim dhe kishte lëshuar një deklaratë për shtyp në lidhje me të.⁸¹

34. ZPS-ja përsërit kundërpërgjigjen e saj lidhur me intervistën e ZPS-së të janarit 2020.⁸² Gjithashtu, ZPS-ja kundërpërgjigjet se në kohën kur u krye intervista e ZPS-së e korrikut 2020, z. Thaçi dhe mbrojtësi i tij ishin të dy në dijeni të temave të trajtuara gjatë intervistës së ZPS-së të janarit 2020 dhe se kundër z. Thaçi ishte ngritur Aktakuzë, por mbrojtësi i z. Thaçi nuk kërkoi informacion të mëtejshëm, që kishte mundësinë ta kërkonte.⁸³

ii. Vendimi i Trupi Gjykses

35. Trupi Gjykses vëren se më 24 qershor 2020, ZPS-ja lëshoi një deklaratë për shtyp ku konfirmoi se u “paraqiti Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) një Aktakuzë me dhjetë pika për shqyrtim prej Gjykatës, ku Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi akuzohen për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krimesh lufte”. Aktakuza u dorëzua si konfidenciale dhe *ex parte* në bazë të rregullës 86(2). Në kohën kur u krye intervista e ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020, ajo ende nuk ishte konfirmuar dhe as ishte bërë publike. Gjatë intervistës së ZPS-së të korrikut 2020, z. Thaçi u informua sërish nga ZPS-ja se ekzistonin arsye për të besuar se ai ishte përfshirë në kryerjen e një veprë penale brenda juridiksionit të DHS-së.⁸⁴ Trupi Gjykses rikujton konstatimin e tij më lart në lidhje me intervistën e ZPS-së të janarit 2020, i cili vlen njëllor edhe për këtë

⁸⁰ Shih më lart para. 24. Shih gjithashtu Përgjigjen e Thaçit, para. 25-27, 29.

⁸¹ Përgjigja e Thaçit, para. 28.

⁸² Shih më lart para. 25. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Thaçit, para. 4-7.

⁸³ Kundërpërgjigja ndaj Përgjigjes së Thaçit, para. 7-8.

⁸⁴ 076563-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshtat 21-23.

deklaratë.⁸⁵ Qëndrimi i Trupit Gjykses është se dorëzimi nga ZPS-ja i Aktakuzës për konfirmim, si konfidenciale dhe *ex parte* në përputhje me rregullën 86(2), nuk i jepte z. Thaçi të drejtën të njoftohej për të gjithë informacionin dhe pretendimet e përfshira në të. Siç u përmend më lart, informacioni që duhet t'i jepet një të dyshuari në kuadër të intervistës me të si i dyshuar, ka për qëllim vetëm të sigurojë që ai të mund të ushtrojë në mënyrë të efektshme të drejtat e tij – në veçanti të drejtën për të heshtur dhe të drejtën për të mos inkriminuar veten – dhe të vendosë në bazë të informacionit për të hequr ose jo dorë nga ndonjë prej të drejtave. Gjithashtu, gjatë intervistës së ZPS-së të korrikut 2020, z. Thaçi dhe mbrojtësi i tij morën përsëri hollësi të mëtijshme për incidentet konkrete që po hetonte ZPS-ja dhe në lidhje me të cilat po intervistohesh z. Thaçi.⁸⁶ Trupi Gjykses vëren se as z. Thaçi, as mbrojtësi i tij, nuk kërkuar informacion shtesë nga ZPS-ja në lidhje me dyshimet kundër z. Thaçi, gjë që kishin mundësi ta bënin, po ta kishin gjykuar këtë të nevojshme për ushtrimin e drejtë dhe efektiv të të drejtave të z. Thaçi. Trupi Gjykses vlerëson se, duke qenë se Aktakuza ende nuk ishte konfirmuar dhe hetimet në çështje vazhdonin, si edhe se mbrojtësi i z. Thaçi që i pranishëm në intervistë, ishte e mjaftueshme që ZPS-ja ta informonte z. Thaçi në mënyrë të përgjithshme për llojin dhe shkakun e dyshimeve ose pretendimeve ndaj tij, që ai të merrte vendim të bazuar në informacion për heqjen dorë nga e drejta për të heshtur.⁸⁷

36. Sa i takon të drejtave të tij, Trupi Gjykses vëren se z. Thaçi u informua se: (i) intervista po incizohej;⁸⁸ (ii) kishte të drejtën të heshtte;⁸⁹ (iii) kishte të drejtën të ndihmohej nga një avokat dhe se, nëse nuk kishte mundësi ta paguante

⁸⁵ *Shih më lart*, para 26.

⁸⁶ 076563-TR-ET Pjesa 13, f. 7, rreshtat 20-25 deri në f. 8, rreshtat 1-9; 076563-TR-ET Pjesa 16, f. 9, rreshtat 18-19; 076563-TR-ET Pjesa 17, f. 2, 5-6.

⁸⁷ *Shih* ECtHR, [Ibrahim and Others Judgment](#), para. 253; [Penev Judgment](#), para. 33; [Mattoccia Judgment](#), para. 60; [Imbrioscia Judgment](#), para. 38. *Shih gjithashtu* ECtHR, [Ibrahim and Others Judgment](#), para. 272.

⁸⁸ 076563-TR-ET Pjesa 1, f. 1, rreshtat 7-10, f. 3, rreshtat 2-3.

⁸⁹ 076563-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshti 24 deri në f. 3, rreshti 1.

avokatin, do t'i jepej avokat pa pagesë;⁹⁰ (iv) çdo deklaratë e bërë mund të përdorej si provë kundër tij në DHS;⁹¹ dhe (v) kishte të drejtën të kishte përkthyes.⁹²

37. Gjatë intervistës, z. Thaçi: (i) u përfaqësua nga një avokat përmes videolidhjes;⁹³ (ii) konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat e tij;⁹⁴ (iii) u ndihmua nga një përkthyes;⁹⁵ (iv) konfirmoi se deklarata u dha vullnetarisht,⁹⁶ se nuk ishte kërcënuar apo detyruar që të paraqitej në intervistë⁹⁷ dhe se nuk i ishte dhënë asnjë premtim, garanci apo nxitje për të dhënë dëshmi;⁹⁸ dhe (v) përveç kundërshtimeve të shprehura nga avokati, ai nuk kishte kundërshtime për mënyrën e zhvillimit të intervistës.⁹⁹ Gjithashtu, intervista u incizua dhe më pas u transkriptua, dhe z. Thaçi iu dha mundësia të sqaronte, plotësonte ose ndryshonte çfarë kishte thënë gjatë intervistës.¹⁰⁰

38. Trupi Gjykses konstaton se z. Thaçi u informua plotësisht për të drejtat e tij si i dyshuar dhe u përfaqësua nga një mbrojtës gjatë intervistës. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se as z. Thaçi, as mbrojtësi, nuk ngritën ndonjë problem ose kundërshtim në lidhje me intervistën e mëhershme të ZPS-së të janarit 2020.

39. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të z. Thaçi sipas Ligjit dhe Rregullores.

⁹⁰ 076563-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 4-5.

⁹¹ 076563-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshtat 14-15.

⁹² 076563-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 14-16.

⁹³ 076563-TR-ET Pjesa 1, f. 1, rreshtat 14-15, f. 3, rreshtat 6-8.

⁹⁴ 076563-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 17-19.

⁹⁵ 076563-TR-ET Pjesa 1, f. 1, rreshtat 17-19.

⁹⁶ 076563-TR-ET Pjesa 21, f. 24, rreshtat 12-14.

⁹⁷ 076563-TR-ET Pjesa 21, f. 24, rreshtat 15-17.

⁹⁸ 076563-TR-ET Pjesa 21, f. 24, rreshtat 18-20.

⁹⁹ 076563-TR-ET Pjesa 21, f. 24, rreshtat 21-24.

¹⁰⁰ 076563-TR-ET Pjesa 21, f. 23, rreshti 21 deri në f. 24, rreshti 8.

(c) Intervista e ZPS-së me z. Selimi e nëntorit 2019 ¹⁰¹

i. Parashtrime

40. ZPS-ja parashtron se: (i) intervista e ZPS-së me z. Selimi e nëntorit 2019 u krye nga ZPS-ja gjatë hetimit të saj në bazë të Ligjit dhe Rregullores dhe në përputhje me to;¹⁰² dhe (ii) gjatë intervistës së ZPS-së të nëntorit 2019, të drejtat e z. Selimi u respektuan duke qenë se z. Selimi u informua se ndaj tij po kryhej hetim penal dhe se ekzistonin arsye për të besuar se ishte përfshirë në kryerjen e një vepre penale brenda juridiksionit të DHS-së, se kishte të drejtën për të heshtur, të drejtën për të pasur ndihmën pa pagesë të një përkthyesi dhe të drejtën për të pasur një përfaqësues ligjor të pranishëm.¹⁰³ ZPS-ja parashtron se z. Selimi konfirmoi se i kishte kuptuar këto të drejta dhe, në mënyrë racionale dhe vullnetarisht, hoqi dorë nga e drejta për të heshtur dhe për të pasur një përfaqësues ligjor të pranishëm.¹⁰⁴

41. Mbrojtja e Selimit kundërshton pranimin si provë të intervistës së ZPS-së të nëntorit 2019, me argumentin se ajo u kryer në shkelje të të drejtave të z. Selimi, konkretisht: (i) pa e informuar si duhet z. Selimi për statusin e tij si i dyshuar sipas rregullës 43; dhe (ii) në shkelje të të drejtave të z. Selimi për mbrojtës, për të heshtur dhe për t'u informuar për pasojat e dhënies së intervistës, dhe të së drejtës për të riaktivizuar ato të drejta.¹⁰⁵ Në veçanti, Mbrojtja e Selimit parashtron se ZPS-ja nuk e njoftoi z. Selimi se konsiderohej si i dyshuar e jo si dëshmitar, në veçanti sepse: (i) iu referua z. Selimi si "dëshmitar" në fillim dhe gjatë gjithë intervistës;¹⁰⁶ (ii) iu referua sërish z. Selimi si "dëshmitar" gjatë leximit të të drejtave të tij;¹⁰⁷ (iii) nuk e njoftoi në asnjë çast z. Selimi se ishte "i dyshuar" në kuptim të rregullës

¹⁰¹ 068933-TR-ET Pjesët 1-14.

¹⁰² Kërkesa, para. 2, 4.

¹⁰³ Kërkesa, para. 14-16.

¹⁰⁴ Kërkesa, para. 16.

¹⁰⁵ Përgjigjja e Selimit, para. 2.

¹⁰⁶ Përgjigjja e Selimit, para. 14, 19-20.

¹⁰⁷ Përgjigjja e Selimit, para. 14, 19.

2 dhe se ishte objekt i hetimi penal dhe/ose për pretendimet ndaj tij.¹⁰⁸ Duke qenë se z. Selimi nuk ishte plotësisht në dijeni për statusin e tij si “i dyshuar”, ai rrjedhimisht nuk hoqi dorë vullnetarisht dhe në mënyrë racionale nga të drejtat për mbrojtës dhe për të heshtur gjatë intervistës.¹⁰⁹ Mbrojtja e Selimit argumenton gjithashtu se, nëse Trupi Gjykses mendon se heqja dorë nga të drejtat u bë në mënyrë të qartë, ZPS-ja nuk ka demonstruar se ai u informua siç duhet për pasojat e heqjes dorë nga të drejtat, siç kërkohet në rregullën 43(3)¹¹⁰ dhe nuk e informoi atë gjatë intervistës për të drejtën e riaktivizimit të këtyre të drejtave, siç kërkohet në rregullën 43(4).¹¹¹ Së fundi, Mbrojtja e Selimit parashtron se z. Selimi nuk hoqi dorë vullnetarisht dhe në mënyrë racionale nga e drejta për të heshtur, pasi ai asnjëherë nuk konfirmoi heqjen dorë nga e drejta për të heshtur; në vend të kësaj, ZPS-ja vetëm supozoi se ai e kishte bërë këtë.¹¹²

42. ZPS-ja kundërpërgjigjet se argumentet e Mbrojtjes së Selimit janë të pabaza dhe argumenton se: (i) Mbrojtja e Selimit mundohet të gjejë gabim të paqenë duke pretenduar se z. Selimi nuk u informua se ishte “i dyshuar”, sikurse përcaktohet në rregullën 2, ndërkohë që ky kriter nuk ekziston;¹¹³ (ii) z. Selimi nuk shprehu asnjëherë se kishte paqartësi lidhur me statusin e tij ose heqjen dorë prej të drejtave të tij;¹¹⁴ (iii) informacioni që iu dha z. Selimi lidhur me aspektet për të cilat kishte interes ZPS-ja përputhej me kuadrin e hetimit në atë kohë dhe ajo nuk kishte detyrim të jepte informacion shtesë;¹¹⁵ dhe (iv) vërtetimi për heqjen dorë të z. Selimi prej të drejtave të tij përmbante informacionin se ai “mund t’i riaktivizonte këto të drejta dhe të kërkonte ndihmën e një avokati në çdo moment”.¹¹⁶

¹⁰⁸ Përgjigjja e Selimit, para. 15, 17-18, 22.

¹⁰⁹ Përgjigjja e Selimit, para. 26, 30, 37, 45-46.

¹¹⁰ Përgjigjja e Selimit, para. 38-39.

¹¹¹ Përgjigjja e Selimit, para. 40-42.

¹¹² Përgjigjja e Selimit, para. 44.

¹¹³ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Selimit, para. 2-3.

¹¹⁴ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Selimit, para. 3, 5-12.

¹¹⁵ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Selimit, para. 4.

¹¹⁶ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Selimit, para. 7.

ii. Vlerësimi i Trupit Gjykues

43. Trupi Gjykues vëren se gjatë intervistës së nëntorit 2019, z. Selimi u informua nga ZPS-ja se ekzistonin arsye për të besuar se ai ishte përfshirë në kryerjen e një veprë penale brenda juridiksionit të DHS-së.¹¹⁷ Pavarësisht se gjatë gjithë intervistës së nëntorit 2019 u përdor vazhdimisht fjala “i dyshuar”, Trupi Gjykues vlerëson se ai njoftim e informoi qartë z. Selimi se dyshohej për përfshirje në kryerjen e një krimi. Kjo theksohet më tej nga fakti se ZPS-ja i lexoi z. Selimi të drejtat e tij si i dyshuar.¹¹⁸ Trupi Gjykues mban parasysh vendimin *Sesay* tek i cili mbështetet Mbrojtja e Selimit,¹¹⁹ ku Dhoma Gjyqësore e Gjykatës Speciale për Sierra Leonen konstatoi se i akuzuari mund të mos e kishte të qartë statusin e tij në proces për shkak të disa garancive të marra nga hetuesit gjatë intervistës. Zotit Selimi nuk iu dhanë garanci të tilla gjatë intervistës së nëntorit 2019. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se z. Selimi ishte në dijeni të statusit të tij si i dyshuar në kohën e intervistës së nëntorit 2019 dhe të të drejtave që lidhen me atë status.

44. Sa u takon parashtrimeve se z. Selimi nuk u informua mjaftueshëm për akuzat kundër tij, Trupi Gjykues rikujton konstatimin e tij më lart se nuk ekziston ndonjë kriter konkret për mënyrën se si duhet të informohet i akuzuari për llojin dhe shkakun e akuzës kundër tij, ose se sa hollësi duhet t’i jepen një të dyshuari.¹²⁰ Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se z. Selimi nuk kërkoi më shumë konkretësi dhe gjatë gjithë intervistës atij iu përmendën vende konkrete dhe hollësi faktike relevante për incidentet përkatëse.¹²¹ Z. Selimi nuk ngriti ndonjë kundërshtim e as shprehu ndonjë vështirësi në trajtimin e tyre.

¹¹⁷ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshtat 15-19.

¹¹⁸ *Shih më poshtë* para. 45.

¹¹⁹ Përgjigjja e Selimit, para. 25, që i referohet SCSL, *Prosecutor v. Sesay et al.*, SCSL-04-15-T, Trial Chamber, [*Written Reasons – Decision on the Admissibility of Certain Prior Statements of the Accused Given to the Prosecution*](#), 30 June 2008, para. 46.

¹²⁰ *Shih më lart* para. 26.

¹²¹ *Shih* 068933-TR-ET.

45. Sa u takon të drejtave, Trupi Gjykses vëren se z. Selimi u informua se: (i) intervista po incizohej;¹²² (ii) kishte të drejtën të heshte;¹²³ (iii) kishte të drejtën të ndihmohej nga një avokat;¹²⁴ (iv) çdo deklaratë mund të përdorej si provë kundër tij në DHS;¹²⁵ dhe (v) kishte të drejtën për një përkthyes pa pagesë.¹²⁶ Gjithashtu, atij iu dha një dokument me shkrim me të drejtat dhe detyrimet e tij, ku përfshihej informacioni se mund të riaktivizonte të drejtën e përfaqësimit me avokat dhe të kërkonte ndihmën e një avokati në çdo moment.¹²⁷ Trupi Gjykses pajtohet me Mbrojtjen e Selimit se z. Selimi duhej të ishte informuar që në fillim të intervistës për të drejtën e anulimit të heqjes dorë nga përfaqësimi me mbrojtës. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se ky informacion iu dha z. Selimi me shkrim pasi intervista kishte filluar.¹²⁸ Trupi Gjykses nuk është bindur nga argumenti i Mbrojtjes së Selimit se njoftimi me vonesë i z. Selimi lidhur për të drejtën e riaktivizimit të përfaqësimit me mbrojtës, ndikoi në të kuptuarit e tij të së drejtës për riaktivizimin e së drejtës për të heshtur, pasi në Rregullore nuk ka ndonjë kriter tekstual që personi duhet të informohet shprehimisht për mundësinë e riaktivizimit të së drejtës për të heshtur. Heqja dorë prej z. Selimi nga e drejta për të heshtur duket qartë nga fakti se ai në asnjë moment nuk shprehu nevojën për t'u këshilluar me mbrojtës dhe nga fakti se, kur u informua për të drejtën e riaktivizimit të çdo pjese të së drejtës së tij, ai nuk shprehu dëshirën për ta bërë këtë. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se gjatë intervistës vijuese në shkurt 2020, z. Selimi nuk shprehu ndonjë kundërshtim për procesverbalin e intervistës së mëhershme mbi bazën se kishte hequr dorë nga të drejtat e tij pa pasur informacion.

¹²² 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 1, rreshtat 7-10, f. 2, rreshti 23.

¹²³ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshtat 20-22.

¹²⁴ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 6-7.

¹²⁵ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshtat 15-16, 23-25.

¹²⁶ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 13-15.

¹²⁷ *Shih* 068932-068932.

¹²⁸ 068933-TR-ET Pjesa 5, f. 1, që i referohet 068932-068932.

46. Trupi Gjykses vëren se gjatë intervistës z. Selimi konfirmoi se i kuptoi të drejtat e tij.¹²⁹ Siç u përmend, ai nuk gjykoi se prania e avokatit të tij ishte e nevojshme.¹³⁰ Trupi Gjykses është i mendimit se nuk ka tregues se z. Selimi ishte ndonjëherë i paqartë për statusin e tij si i dyshuar. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se z. Selimi: (i) u ndihmua nga një përkthyes;¹³¹ (ii) konfirmoi se deklaratën e dha vullnetarisht;¹³² (iii) konfirmoi se nuk ishte kërcënuar apo detyruar të paraqitej në intervistë¹³³ dhe se nuk i ishte dhënë asnjë premtim, garanci apo nxitje për të dhënë dëshmi;¹³⁴ dhe (iv) konfirmoi se nuk kishte kundërshtime për mënyrën e zhvillimit të intervistës.¹³⁵ Gjithashtu, intervista u incizua dhe më pas u transkriptua, dhe të akuzuarit iu dha mundësia të sqaronte, plotësonte, ose ndryshonte çfarë kishte thënë gjatë intervistës.¹³⁶

47. Trupi Gjykses konstaton se z. Selimi u informua plotësisht për të drejtat e tij si i dyshuar dhe se heqja dorë nga e drejta për avokat, ishte bërë vullnetarisht dhe në një mënyrë të qartë, të vetëdijshme dhe racionale.¹³⁷

48. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të z. Selimi sipas Ligjit dhe Rregullores.

(d) Intervista e ZPS-së me z. Selimi e shkurtit 2020¹³⁸

i. Parashtrime

49. ZPS-ja parashtron se: (i) intervista e ZPS-së me z. Selimi e shkurtit 2020 u krye nga ZPS-ja gjatë hetimit të saj në bazë të Ligjit dhe Rregullores dhe në përputhje

¹²⁹ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 8-11.

¹³⁰ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 11-12.

¹³¹ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 15-16.

¹³² 068933-TR-ET Pjesa 14, f. 29, rreshtat 15-17.

¹³³ 068933-TR-ET Pjesa 14, f. 29, rreshtat 18-20.

¹³⁴ 068933-TR-ET Pjesa 14, f. 29, rreshtat 21-23.

¹³⁵ 068933-TR-ET Pjesa 14, f. 29, rreshti 24 deri në f. 30, rreshti 1.

¹³⁶ 068933-TR-ET Pjesa 14, f. 28, rreshti 23 deri në f. 29, rreshti 3, f. 29, rreshtat 6-9.

¹³⁷ *Shih* ECtHR, [Ibrahim and Others Judgment](#), para. 272.

¹³⁸ 074459-TR-ET Pjesët 1-9.

me to;¹³⁹ dhe (ii) ashtu si në intervistën e ZPS-së të nëntorit 2019, të drejtat e z. Selimi u respektuan edhe gjatë intervistës së ZPS-së të shkurtit 2020, ku atij iu dha edhe një version me shkrim në gjuhën shqipe i të drejtave dhe detyrimeve për ta lexuar dhe nënshkruar dhe ku ai sërish, në vullnetarisht dhe në mënyrë racionale, hoqi dorë nga e drejta për të heshtur dhe për të pasur të pranishëm një përfaqësues ligjor.¹⁴⁰

50. Në lidhje me intervistën e ZPS-së të shkurtit 2020, Mbrojtja e Selimit përsërit kundërshtimet e paraqitura ndaj intervistës së ZPS-së të nëntorit 2019.¹⁴¹

51. ZPS-ja përsërit kundërpërgjigjen e saj për intervistën e ZPS-së të nëntorit 2019.¹⁴²

ii. Vlerësimi i Trupit Gjykues

52. Trupi Gjykues vëren se, gjatë intervistës së shkurtit 2020, z. Selimi u informua nga ZPS-ja se ekzistonin arsye për të besuar se ai ishte përfshirë në kryerjen e një veprë penale brenda juridiksionit të DHS-së.¹⁴³ Trupi Gjykues rikujton konstatimet e tij në lidhje me intervistën e ZPS-së me z. Selimi të nëntorit 2019 dhe, në veçanti, se ai i ka hedhur poshtë parashtrimet e z. Selimi se nuk ishte informuar qartë dhe mjaftueshëm: (i) se dyshohej për përfshirje në kryerjen e një krimi; dhe (ii) për akuzat kundër tij.¹⁴⁴ Trupi Gjykues arrin në përfundimin se këto konstatime vlejné njëlloj edhe për intervistën e ZPS-së me z. Selimi të shkurtit 2020.

53. Sa i takon të drejtave të tij, Trupi Gjykues vëren se z. Selimi u informua se: (i) intervista po incizohej;¹⁴⁵ (ii) kishte të drejtën të heshte;¹⁴⁶ (iii) kishte të drejtën të

¹³⁹ Kërkesa, para. 2, 4.

¹⁴⁰ *Shih më lart* para. 40. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 18-20.

¹⁴¹ *Shih më lart* para. 41. *Shih gjithashtu* Përgjigjen e Selimit, para. 2, 11-26, 38, 42.

¹⁴² *Shih më lart* para. 42. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Selimit, para. 2-12.

¹⁴³ 074459-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshtat 13-16.

¹⁴⁴ *Shih më lart* paragrafët 43-44.

¹⁴⁵ 074459-TR-ET Pjesa 1, f. 1, rreshtat 11-12, f. 2, rreshtat 19-20.

¹⁴⁶ 074459-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshtat 16-19.

ndihmohej nga një avokat;¹⁴⁷ (iv) çdo deklaratë e bërë mund të përdorej si provë kundër tij në DHS;¹⁴⁸ dhe (v) kishte të drejtën për përkthyes pa pagesë.¹⁴⁹ Gjithashtu, atij iu dha një dokument me shkrim me të drejtat dhe detyrimet e tij.¹⁵⁰

54. Gjatë intervistës, z. Selimi: (i) konfirmoi se i kuptonte të drejtat e tij;¹⁵¹ (ii) konfirmoi se e kuptonte se kishte të drejtën të kishte avokat dhe se zgjodhi të hiqte dorë nga kjo e drejtë;¹⁵² (iii) u ndihmua nga një përkthyes;¹⁵³ (iv) konfirmoi se deklaratën e kishte dhënë vullnetarisht,¹⁵⁴ se nuk ishte kërcënuar apo detyruar që të paraqitej në intervistë¹⁵⁵ dhe se nuk i ishte dhënë asnjë premtim, garanci apo nxitje për të dhënë dëshmi;¹⁵⁶ dhe (v) konfirmoi se nuk kishte kundërshtime lidhur me mënyrën e zhvillimit të intervistës.¹⁵⁷ Gjithashtu, intervista u incizua dhe më pas u transkriptua, dhe të akuzuarit iu dha mundësia të sqaronte, plotësonte ose ndryshonte çfarë kishte thënë gjatë intervistës.¹⁵⁸

55. Trupi Gjykues konstaton se z. Selimi u informua plotësisht për të drejtat e tij si i dyshuar dhe se heqja dorë prej të drejtës për të pasur avokat ishte bërë vullnetarisht dhe në një mënyrë të qartë, të vetëdijshme dhe racionale.¹⁵⁹

56. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues konstaton se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të z. Selimi sipas Ligjit dhe Rregullores.

¹⁴⁷ 074459-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshti 25 deri në f. 3, rreshti 2.

¹⁴⁸ 074459-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshtat 12-13.

¹⁴⁹ 074459-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 8-10.

¹⁵⁰ *Shih* 074439-074439.

¹⁵¹ 074459-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 12-14.

¹⁵² 074459-TR-ET Pjesa 1, f. 2, rreshti 25 deri në f. 3, rreshti 7.

¹⁵³ 074459-TR-ET Pjesa 1, f. 3, rreshtat 8-11.

¹⁵⁴ 074459-TR-ET Pjesa 9, f. 15, rreshtat 14-16.

¹⁵⁵ 074459-TR-ET Pjesa 9, f. 15, rreshtat 17-19.

¹⁵⁶ 074459-TR-ET Pjesa 9, f. 15, rreshtat 20-22.

¹⁵⁷ 074459-TR-ET Pjesa 9, f. 15, rreshtat 23-25.

¹⁵⁸ 074459-TR-ET Pjesa 9, f. 15, rreshtat 1-9.

¹⁵⁹ ECtHR, [Ibrahim and Others Judgment](#), para. 272.

(e) Përfundim

57. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të z. Thaçi ose të z. Selimi sipas Ligjit dhe Rregullores.

58. Rrjedhimisht, në vijim Trupi Gjykses do të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret kumulative për pranimin e provave (lidhja me lëndën, autenticiteti, vlera provuese dhe efekti dëmtues) të përcaktuara në rregullën 138(1) në lidhje me secilën intervistë të ZPS-së me të akuzuarit dhe provat materiale shoqëruese.

2. Pranueshmëria e intervistave të ZPS-së me të akuzuarit dhe e provave materiale shoqëruese sipas rregullës 138(1)

59. ZPS-ja parashtro se intervistat e ZPS-së: (i) janë relevante sepse kanë të bëjnë, ndër të tjera, me vendndodhjen e të akuzuarve gjatë periudhave përkatëse, rolet e tyre si udhëheqës në UÇK, përfshirë pjesëmarrjen e tyre në strukturën e dhe vendimmarrjen e organizatës dhe deklaratat e tyre për dijeninë dhe përfshirjen e tyre në arrestime, ndalime dhe keqtrajtime;¹⁶⁰ dhe (ii) janë autentike dhe në to mund të mbështetesh, sepse, në kohën e zhvillimit të intervistave, të akuzuarit ishin “të dyshuar”, u udhëzuan si të tillë dhe u informuan për të drejtat e tyre në mënyrë të qartë dhe të plotë.¹⁶¹ Për këto arsye, dhe për shkak se të akuzuarit i dhanë deklaratat pas heqjes dorë në mënyrë të vetëdijshme dhe racionale nga të drejtat e tyre, ZPS-ja argumenton se vlera provuese e intervistave të ZPS-së nuk zhbëhet nga ndonjë efekt dëmtues ndaj të akuzuarve. Krahës kësaj, ZPS-ja parashtro se provat materiale shoqëruese u përdorën në intervistat e ZPS-së dhe janë pjesë përbërëse e tyre.¹⁶² ZPS-ja argumenton se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë provat dhe Trupi Gjykses, i përbërë nga gjykatës

¹⁶⁰ Kërkesa, para. 95. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 8, 13, 17, 21, 90, 94.

¹⁶¹ Kërkesa, para. 96-99.

¹⁶² Kërkesa, para. 95.

profesionistë, do të mund të vlerësojë si duhet tërësinë e provave dhe t'u japë peshën e duhur atyre.¹⁶³

60. Parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me kriteret e rregullës 138(1) jepen në vijim, për secilën intervistë përkatëse të ZPS-së.

(a) Intervista e ZPS-së me z. Thaçi e janarit 2020

i. Parashtrime

61. ZPS-ja parashtron se, për arsyet e paraqitura më lart,¹⁶⁴ intervista e ZPS-së me z. Thaçi e janarit 2020¹⁶⁵ dhe provat materiale shoqëruese,¹⁶⁶ janë autentike, kanë lidhje me lëndën dhe kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.¹⁶⁷

62. Mbrojtja e Thaçit nuk bën parashtrime konkrete në lidhje me kriteret e rregullës 138(1) për pranimin e intervistës së ZPS-së me z. Thaçi të janarit 2020. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se përgjegjësinë për të vërtetuar plotësimin e kriterëve për pranimin si provë të një materiali, e ka pala që e paraqet atë, *d.m.th.*, në këtë rast, ZPS-ja.¹⁶⁸ Mbrojtja e Thaçit kundërshton pranimin e: (i) provave materiale shoqëruese 10, 12 dhe 14, pasi nuk u përmendën gjatë intervistës; (ii) provës materiale shoqëruese 2, pasi i mungon autenticiteti; (iii) provave materiale shoqëruese 3 deri 6, pasi datojnë ose lidhen me aspekte jashtë periudhës kohore që përfshin Aktakuza; dhe; (iv) provave materiale shoqëruese 3 deri 7, pasi z. Thaçi nuk kishte dijeni për ato prova materiale.¹⁶⁹ Mbrojtja e Thaçit kundërshton

¹⁶³ Kërkesa, para. 100-101.

¹⁶⁴ *Shih më lart* para. 59.

¹⁶⁵ 071840-TR-ET Pjesët 1-9.

¹⁶⁶ 071793-071793-ET; 071794-071839 (provat materiale shoqëruese 1-15).

¹⁶⁷ Kërkesa, para. 8, 90, 94-101.

¹⁶⁸ Vendimi i Parë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 9; KSC-BC-2020-07, F00334, Trial Panel II, *Vendim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore*, 29 shtator 2021, para. 11.

¹⁶⁹ Përgjigjja e Thaçit, para. 23.

në përgjithësi autenticitetin e komunikatave dhe mbështetshmërinë në to, dhe parashtrohet se, rrjedhimisht, nuk është e udhës të kërkojë pranimi i tyre si prova përmes Kërkesës, pasi z. Thaçi tha se nuk kishte dijeni për to dhe nuk konfirmoi autenticitetin e tyre dhe mbështetshmërinë në to.¹⁷⁰

63. ZPS-ja kundërpërgjigjet se: (i) provat materiale shoqëruese në fjalë u diskutuan gjatë intervistës; (ii) z. Thaçi vazhdimisht ofroi mendimin e tij për përmbajtjen e provave materiale, për të cilat tani ai pretendon se nuk ka dijeni, se nuk janë autentike ose se janë jashtë kuadrit kohor; dhe (iii) standardi përkatës është nëse provat materiale shoqëruese janë pjesë e “pandashme dhe e domosdoshme” e dokumentacionit të çështjes gjyqësore.¹⁷¹

ii. Vlerësimi i Trupit Gjyqësor

64. Trupi Gjyqësor vëren se, në intervistën e ZPS-së të janarit 2020, z. Thaçi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me: (i) anëtarësinë e tij në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”);¹⁷² (ii) përfshirjen dhe udhëheqjen prej tij të Drejtorisë Politike dhe për Informim të UÇK-së;¹⁷³ (iii) vendndodhjen e tij dhe të anëtarëve dhe udhëheqësve të tjerë të UÇK-së gjatë periudhës përkatëse;¹⁷⁴ (iv) lidhjet e tij me, ndër të tjerë, Adem Demaçin, Jakup Krasniqin, Ramë Bujën, Azem Sylën, Agim Çekun, Sylejman Selimin, Xhavit Halitin, Sokol Bashotën, Rexhep Selimin, Lahi Brahimajn, Kadri Veselin, Xheladin Gashin, Jashar Salihun dhe Bislim Zyrapin;¹⁷⁵ (v) anëtarësinë e tij në Shtabin e Përgjithshëm dhe funksionimin e tij;¹⁷⁶

¹⁷⁰ Përgjigjja e Thaçit, para. 24.

¹⁷¹ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Thaçit, para. 9-10, p. 4.

¹⁷² 071840-TR-ET Pjesa 4, f. 5-7.

¹⁷³ 071840-TR-ET Pjesa 4, f. 5-7.

¹⁷⁴ 071840-TR-ET Pjesa 4, f. 8-21, Pjesa 5, f. 3-17.

¹⁷⁵ 071840-TR-ET Pjesa 4, f. 8-9, 12-14, 16, Pjesa 5, f. 3.

¹⁷⁶ 071840-TR-ET Pjesa 4, f. 14-15, 18-21.

(vi) transportimin e armëve në Kosovë për UÇK-në;¹⁷⁷ (vii) masat disiplinore në UÇK;¹⁷⁸ (viii) policinë ushtarake të UÇK-së;¹⁷⁹ (ix) trajtimin e “bashkëpunëtorëve” nga UÇK-ja dhe Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së;¹⁸⁰ (x) dijeninë e tij për arrestimet dhe ndalimet dhe përfshirjen e tij në to;¹⁸¹ (xi) betejën e Gllogjanit më 24 mars 1998;¹⁸² dhe (xii) konferencën e Rambujesë.¹⁸³ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçi nuk kundërshtoi relevancën e intervistës së ZPS-së me z. Thaçi të janarit 2020. Trupi Gjykses është bindur se intervista e ZPS-së me z. Thaçi e janarit 2020 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

65. Trupi Gjykses rikujton konstatimet e tij më lart në lidhje me informacionin dhe garancitë që ZPS-ja i ofroi z. Thaçi në fillim dhe gjatë intervistës së janarit 2020.¹⁸⁴ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçi nuk kundërshtoi autenticitetin apo vlerën provuese të intervistës së ZPS-së me z. Thaçi të janarit 2020. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se intervista e ZPS-së me z. Thaçi e janarit 2020 është autentike në pamje të parë dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se kjo intervistë u dha nga z. Thaçi vullnetarisht dhe mbi bazën e informacionit. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë cilindo aspekt të intervistës së ZPS-së të janarit 2020, nëse ZPS-ja ia paraqet atë një apo më shumë dëshmitarëve gjatë gjykit. Mbrojtja gjithashtu mund të thërrasë dëshmitarë në gjykim për të kontestuar cilindo aspekt të kësaj interviste. Trupi Gjykses do ta vlerësojë këtë intervistë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave në gjykim, përfshirë provat konfirmuese. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e intervistës së ZPS-së me z. Thaçi e janarit 2020 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

¹⁷⁷ 071840-TR-ET Pjesa 4, f. 16-18.

¹⁷⁸ 071840-TR-ET Pjesa 5, f. 3-4.

¹⁷⁹ 071840-TR-ET Pjesa 7, f. 22-23.

¹⁸⁰ 071840-TR-ET Pjesa 5, f. 11-16, Pjesa 6, f. 6-15, Pjesa 7, f. 3-4.

¹⁸¹ 071840-TR-ET Pjesa 5, f. 5-6, Pjesa 6, f. 1-3, 21-22, Pjesa 7, f. 23-25, Pjesa 8, f. 12-14.

¹⁸² 071840-TR-ET Pjesa 4, f. 15.

¹⁸³ 071840-TR-ET Pjesa 4, f. 9.

¹⁸⁴ *Shih më lart* para. 26-29.

66. Në lidhje me provat materiale shoqëruese, Trupi Gjykses vëren se në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit,¹⁸⁵ që të gjitha, përfshirë provat materiale shoqëruese 10, 12 dhe 14, iu treguan z. Thaçi dhe u diskutuan me njëfarë hollësie gjatë intervistës.¹⁸⁶ Trupi Gjykses është bindur se provat materiale shoqëruese janë pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e intervistës së ZPS-së të janarit 2020. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se ato: (i) kanë lidhje me lëndën dhe ofrojnë kontekst relevant për dokumentin me shkrim në të cilin diskutohen; (ii) kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti; dhe (iii) kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre. Trupi Gjykses nuk është bindur nga argumentet e Mbrojtjes së Thaçit për provat materiale shoqëruese 2-7 duke qenë se: (i) prova materiale shoqëruese 2 ka emblemën e UÇK-së dhe, rrjedhimisht, në pamje të parë, duket të jetë autentike; dhe (ii) lidhja me lëndën dhe autenticiteti i provave materiale shoqëruese 3-7 nuk dëmtohen nga fakti se ato mbajnë data ose lidhen me aspekte jashtë juridiksionit kohor të Aktakuzës, dhe as nga mosdijenja e pretenduar e të akuzuarit për to, sepse ato përmbajnë komunikata që duket se janë lëshuar nga UÇK-ja dhe janë publikuar nga media të njohura.¹⁸⁷

67. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se intervista e ZPS-së me z. Thaçi e janarit 2020 dhe provat materiale shoqëruese të saj, kanë lidhje me lëndën, janë autentike në pamje të parë dhe kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre, dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

¹⁸⁵ Përgjigjja e Thaçit, para. 23-245.

¹⁸⁶ *Shih p.sh.* 071840-TR-ET Pjesa 1, f. 2-4 (071793-071793-ET), Pjesa 4, f. 5 (prova materiale shoqëruese 1), Pjesa 5, f. 1-4 (prova materiale shoqëruese 2), 11-18 (provat materiale shoqëruese 3-6), Pjesa 6, f. 5-8 (provat materiale shoqëruese 7-9), 12-13 (prova materiale shoqëruese 10), 15 (prova materiale shoqëruese 11), Pjesa 7, f. 2-5 (provat materiale shoqëruese 12-13), 10 (prova materiale shoqëruese 14), 21 (prova materiale shoqëruese 15).

¹⁸⁷ *Shih* F01596, Trupi Gjykses, *Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore* ("Vendimi i Dytë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore"), 9 qershor 2023, konfidencial dhe *ex parte*, para. 73 (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua po të njëjtën ditë (F01596/CONF/RED)).

(b) Intervista e ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020

i. Parashtrime

68. ZPS-ja parashtron se, për arsyet e paraqitura më lart,¹⁸⁸ intervista e ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020¹⁸⁹ dhe provat materiale shoqëruese¹⁹⁰ janë autentike, kanë lidhje me lëndën dhe vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.¹⁹¹

69. Mbrojtja e Thaçit nuk bën parashtrime konkrete në lidhje me kriteret e rregullës 138(1) për pranimin si provë të intervistës së ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020. Sidoqoftë, Mbrojtja e Thaçit kundërshton autenticitetin e saj dhe, për rrjedhojë, pranueshmërinë e provave materiale 16, 19-25.¹⁹²

70. Mbrojtja e Krasniqit përgjigjet se tri prova materiale shoqëruese – komunikata e datës 23 shtator 1998, pamja e fotografuar nga ekrani e një postimi në *Facebook* dhe artikulli i gazetës që flet për të – nuk përmbushin asnjë standard pranueshmërie dhe nuk duhet të pranohen si prova.¹⁹³

71. Edhe Mbrojtja e Veselit kundërshton pranimin e komunikatës së datës 23 shtator 1998, pasi parashtron se asaj i mungon autenticiteti dhe mbështetshmëria dhe se ajo duhet të paraqitet për pranim përmes një dëshmitari që mund të dëshmojë për vërtetësinë e përmbajtjes së saj.¹⁹⁴

¹⁸⁸ *Shih më lart* para. 59.

¹⁸⁹ 076563-TR-ET Pjesët 1-21.

¹⁹⁰ 076565-076705 (provat materiale shoqëruese 16-54); 076565-076565-ET (përkthimi në anglishte i faqes së parë të provës materiale shoqëruese 16); 076603-076603-ET (përkthimi në anglishte i faqes së parë të provës materiale shoqëruese 30); 076630-076630-ET (përkthimi në anglishte i provës materiale shoqëruese 39); 076642-076642-ET (përkthimi në anglishte i provës materiale shoqëruese 42).

¹⁹¹ Kërkesa, para. 13, 90, 94-101.

¹⁹² Përgjigjja e Thaçit, para. 30, që i referohet 076565-076705, f. 076565-076566 (prova materiale shoqëruese 16), 076576-076591 (provat materiale shoqëruese 19-25).

¹⁹³ Përgjigjja e Krasniqit, para. 75(d)-(f), që i referohet 076565-076565-ET (faqja e parë e provës materiale shoqëruese 16); 076565-076705, f. 076596-076599 (provat materiale shoqëruese 27-28).

¹⁹⁴ Përgjigjja e Veselit, para. 29-34, që i referohet 076565-076565-ET (faqja e parë e provës materiale shoqëruese 16).

72. ZPS-ja kundërpërgjigjet se pretendimi i Mbrojtjes se këto prova materiale shoqëruese nuk janë autentike nuk përlligj përjashtimin e tyre, pasi standardi përkatës kërkon që ato të jenë pjesë “e pandashme dhe e domosdoshme” e dokumentacionit të çështjes.¹⁹⁵ ZPS-ja parashtron se Mbrojtja e Krasniqit dhe Mbrojtja e Veselit nuk japin arsye të mjaftueshme se pse nuk duhet të pranohen provat materiale shoqëruese në fjalë.¹⁹⁶

ii. Vlerësimi i Trupit Gjykues

73. Trupi Gjykues vëren se në intervistën e ZPS-së të korrikut 2020, z. Thaçi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) anëtarësinë e tij në UÇK;¹⁹⁷ (ii) lëvizjet e tij brenda dhe jashtë Kosovës;¹⁹⁸ (iii) rolin e tij si udhëheqës i Drejtorisë për Informim të UÇK-së;¹⁹⁹ (iv) strukturat komanduese, hierarkinë dhe bazat e UÇK-së;²⁰⁰ (v) lidhjet e tij me, ndër të tjerë, Bislim Zyrapin, Rexhep Selimin, Sabit Gecin, Sylejman Selimin, Kadri Veselin, Agim Çekun dhe Azem Sylën;²⁰¹ (vi) Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së dhe funksionimin e tij;²⁰² (vii) arrestimin dhe ndalimin e disa personave;²⁰³ dhe (viii) funksionet dhe rolin e tij politik në bisedimet dhe nënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë.²⁰⁴ Trupi Gjykues gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçit nuk kundërshtoi relevancën e intervistës së ZPS-së me z. Thaçi të korrikut 2020.

¹⁹⁵ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Thaçit, para. 9-10, p. 4.

¹⁹⁶ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 15-18; Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Veselit, para. 6.

¹⁹⁷ 076563-TR-ET Pjesa 2, f. 9-15, Pjesa 5, f. 3, Pjesa 12, f. 3-6.

¹⁹⁸ 076563-TR-ET Pjesa 10, f. 12, Pjesa 16, f. 10-12.

¹⁹⁹ 076563-TR-ET Pjesa 5, f. 3, Pjesa 8, f. 7.

²⁰⁰ 076563-TR-ET Pjesa 2, f. 9-11, Pjesa 3, f. 1, 12-30, Pjesa 12, f. 6.

²⁰¹ 076563-TR-ET Pjesa 2, f. 19, Pjesa 3, f. 3, 12, Pjesa 4, f. 15-18, Pjesa 6, f. 6, Pjesa 7, f. 7, Pjesa 21, f. 14.

²⁰² 076563-TR-ET Pjesa 4, f. 17, Pjesa 7, f. 11-12, Pjesa 9, f. 14, Pjesa 15, f. 11.

²⁰³ 076563-TR-ET Pjesa 13, f. 7, Pjesa 16, f. 9-11, Pjesa 17, f. 2, 5-6.

²⁰⁴ 076563-TR-ET Pjesa 12, f. 10, Pjesa 13, f. 3.

Trupi Gjykses është bindur se intervista e ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

74. Trupi Gjykses rikujton konstatimet e tij më lart në lidhje me informacionin dhe garancitë që ZPS-ja i dha z. Thaçi në fillim dhe gjatë intervistës së korrikut 2020.²⁰⁵ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçit nuk e kundërshtoi autenticitetin ose vlerën provuese të intervistës së ZPS-së me z. Thaçi të korrikut 2020. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se intervista e ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020 është autentike në pamje të parë dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë cilindo aspekt të intervistës së ZPS-së të korrikut 2020, në rast se ZPS-ja ia paraqet këtë intervistë një apo më shumë dëshmitarëve gjatë gjykimit. Mbrojtja gjithashtu mund të thërrasë dëshmitarë në gjykim për të kontestuar cilindo aspekt të kësaj interviste. Trupi Gjykses do ta vlerësojë këtë intervistë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave në gjykim, përfshirë provat konfirmuese. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e intervistës së ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

75. Në lidhje me provat materiale shoqëruese, Trupi Gjykses vëren se ato iu treguan z. Thaçi dhe u diskutuan me njëfarë hollësie gjatë intervistës.²⁰⁶ Trupi Gjykses është bindur se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së

²⁰⁵ *Shih më lart* para. 35-37.

²⁰⁶ *Shih p.sh.* 076563-TR-ET Pjesa 4, f. 5-15 (prova materiale shoqëruese 16, f. 1), Pjesa 6, f. 6-8 (prova materiale shoqëruese 17), 12-13 (prova materiale shoqëruese 18), Pjesa 7, f. 1-5 (provat materiale shoqëruese 19-20), 7 (prova materiale shoqëruese 21), 10 (prova materiale shoqëruese 22), 12 (prova materiale shoqëruese 23), 17 (prova materiale shoqëruese 24), Pjesa 8, f. 1-3 (provat materiale shoqëruese 24-26), 5-12 (provat materiale shoqëruese 27-28), Pjesa 9, f. 2 (prova materiale shoqëruese 29), 3-10 (prova materiale shoqëruese 30), 12-13 (prova materiale shoqëruese 31), Pjesa 11, f. 8 (prova materiale shoqëruese 32), 11 (prova materiale shoqëruese 33), Pjesa 12, f. 11 (prova materiale shoqëruese 34), Pjesa 13, f. 2, 4, 7 (prova materiale shoqëruese 36), Pjesa 14, f. 4 (prova materiale shoqëruese 35), Pjesa 15, f. 4-5 (prova materiale shoqëruese 37), 7-9 (prova materiale shoqëruese 38), Pjesa 16, f. 11-12 (prova materiale shoqëruese 39), Pjesa 17, f. 7 (prova materiale shoqëruese 40), Pjesa 18, f. 6-7 (prova materiale shoqëruese 41), Pjesa 19, f. 3 (prova materiale shoqëruese 42), Pjesa 20, f. 8-26 (provat materiale shoqëruese 43-51), Pjesa 21, f. 4 (prova materiale shoqëruese 52), 7 (prova materiale shoqëruese 53), 14 (prova materiale shoqëruese 54).

Krasniqit,²⁰⁷ provat materiale shoqëruese janë pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e intervistës së ZPS-së të korrikut 2020. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se ato: (i) kanë lidhje me lëndën dhe ofrojnë kontekst relevant për dokumentin me shkrim në të cilin diskutohen; (ii) në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes,²⁰⁸ kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti; dhe (iii) kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre. Trupin Gjykses nuk e bindin argumentet e Mbrojtjes për provat materiale shoqëruese 16, 19-25, 27-28, duke qenë se: (i) prova materiale shoqëruese 16 përmban një deklaratë e cila ka datë dhe duket se është lëshuar nga Drejtoria e Policisë Ushtarake të UÇK-së dhe është publikuar në gazetën *Zëri i Kosovës* dhe, rrjedhimisht, ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti; (ii) provat materiale shoqëruese 19-20 kanë data, duket se janë nënshkruar nga z. Thaçi dhe, rrjedhimisht, kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti; (iii) provat materiale shoqëruese 21-23 përmbajnë dekrete të cilat duket se janë lëshuar nga Qeveria e Kosovës dhe janë bërë publike nga *Radio Kosova e Lirë* dhe, rrjedhimisht, kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti; (iv) provat materiale shoqëruese 24-25 përfshijnë komunikata të cilat duket se janë lëshuar nga UÇK-ja dhe bërë publike nga *Zëri i Kosovës* dhe, rrjedhimisht, kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti; dhe (v) provat materiale shoqëruese 27-28, që përbëhen nga një postim në faqen e z. Krasniqi në *Facebook* dhe një artikull gazete, me datë, ku komentohet në lidhje me të, duket se janë autentike në pamje të parë. Për të njëjtat arsye, Trupi Gjykses gjithashtu nuk është bindur se lidhja me lëndën dhe autenticiteti i provave materiale shoqëruese që iu treguan z. Thaçi dhe u diskutuan prej tij gjatë intervistës së ZPS-së të korrikut 2020, cenohen nga mungesa e pretenduar e dijenisë së të akuzuarit për to. Ky është një faktor që do të vlerësohet nga Trupi Gjykses kur të vendosë çfarë peshe dhe vlere provuese mund t'u jepet këtyre materialeve dhe nëse mund të nxirret përfundimi se i

²⁰⁷ Përgjigjja e Krasniqit, para. 75(d)-(f).

²⁰⁸ Përgjigjja e Thaçit, para. 30, Përgjigjja e Veselit, para. 29-34, Përgjigjja e Krasniqit, para. 75(d)-(f).

akuzuari kishte dijeni për përmbajtjen e tyre, përkundër pretendimit të tij se nuk dinte gjë për to.

76. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se intervista e ZPS-së me z. Thaçi e korrikut 2020 dhe provat materiale shoqëruese kanë lidhje me lëndën, janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

(c) Intervista e ZPS-së me z. Selimi e nëntorit 2019

i. Parashtrime

77. ZPS-ja parashtron se, për arsyet e paraqitura më lart,²⁰⁹ intervista e ZPS-së me z. Selimi e nëntorit 2019²¹⁰ dhe prova materiale shoqëruese e saj,²¹¹ janë autentike, kanë lidhje me lëndën dhe kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.²¹²

78. Mbrojtja e Selimit nuk bën parashtrime konkrete në lidhje me kriteret e rregullës 138(1) për pranimin e intervistës së ZPS-së me z. Selimi të nëntorit 2019 dhe provës materiale shoqëruese të saj.

ii. Vlerësimi i Trupit Gjykses

79. Trupi Gjykses vëren se në intervistën e ZPS-së të nëntorit 2019, z. Selimi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) anëtarësinë e tij në UÇK;²¹³ (ii) përfshirjen e tij në Degën Operative të UÇK-

²⁰⁹ *Shih më lart* para. 59.

²¹⁰ 068933-TR-ET Pjesët 1-14.

²¹¹ 068932-068932-ET.

²¹² Kërkesa, para. 17, 90, 94-101.

²¹³ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 4-6.

së dhe udhëheqjen e saj;²¹⁴ (iii) lidhjet e tij, ndër të tjerë, me Sylejman Selimin, Azem Sylën, Jakup Krasniqin dhe Bislim Zyrapin;²¹⁵ (iv) anëtarësinë dhe detyrat e tij në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, si dhe funksionimin e Shtabit;²¹⁶ (v) transportimin e armëve në Kosovë;²¹⁷ (vi) sistemimin e rekrutëve të rinj të UÇK-së;²¹⁸ (vii) komunikimet ndërmjet Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe anëtarëve të UÇK-së;²¹⁹ (viii) rolin e Drenocit si bazë furnizimi;²²⁰ (ix) detyrën e tij për ngritjen, strukturimin dhe organizimin e njësive operative;²²¹ (x) krijimin e zonave operative;²²² (xi) policinë ushtarake të UÇK-së;²²³ (xii) betejën e Rahovecit;²²⁴ (xiii) rolin e tij si ministër i rendit publik në Qeverinë e Përkohshme;²²⁵ (xiv) përcaktimin, trajtimin dhe masat ndëshkimore kundër të ashtuquajturve “bashkëpunëtorë”;²²⁶ (xv) “luftën speciale”;²²⁷ dhe (xvi) dijeninë e tij dhe të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për vendet e ndalimit.²²⁸ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Selimit nuk kundërshtoi relevancën e intervistës së ZPS-së me z. Selimi të nëntorit 2019. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se intervista e ZPS-së me z. Selimi të nëntorit 2019 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

80. Trupi Gjykses rikujton konstatimet e tij më lart lidhur me informacionin dhe garancitë që ZPS-ja i dha z. Selimi në fillim dhe gjatë intervistës së nëntorit 2019.²²⁹ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Selimit nuk kundërshtoi

²¹⁴ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 14.

²¹⁵ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 8, 13-15. Pjesa 2, f. 8, Pjesa 6, f. 6, Pjesa 10, f. 1-2.

²¹⁶ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 12, 15, 20, Pjesa 3, f. 1-3, 7-8, 19-20, Pjesa 5, f. 4-15, Pjesa 9, f. 12-15.

²¹⁷ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 12-13.

²¹⁸ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 12, 20, Pjesa 3, f. 12.

²¹⁹ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 13, Pjesa 10, f. 1.

²²⁰ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 19.

²²¹ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 20.

²²² 068933-TR-ET Pjesa 3, f. 14, Pjesa 6, f. 5-6.

²²³ 068933-TR-ET Pjesa 3, f. 2-4, 12-13, Pjesa 12, f. 2-3.

²²⁴ 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 23, Pjesa 9, f. 12-15.

²²⁵ 068933-TR-ET Pjesa 6, f. 17.

²²⁶ 068933-TR-ET Pjesa 11, f. 19-22.

²²⁷ 068933-TR-ET Pjesa 11, f. 17-18, Pjesa 12, f. 9-13.

²²⁸ 068933-TR-ET Pjesa 14, f. 2-4.

²²⁹ *Shih më lart* para. 35-37.

autenticitetin apo vlerën provuese të intervistës së ZPS-së me z. Selimi të nëntorit 2019. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se intervista e ZPS-së me z. Selimi e nëntorit 2019 është autentike në pamje të parë dhe ka vlerë provuese. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë cilindo aspekt të intervistës së ZPS-së të nëntorit 2019, në rast se ZPS-ja ia paraqet këtë intervistë një apo më shumë dëshmitarëve gjatë gjykit. Gjithashtu, Mbrojtja mund të thërrasë dëshmitarë në gjykim për të kontestuar cilindo aspekt të kësaj interviste. Trupi Gjykses do ta vlerësojë intervistën duke mbajtur parasysh tërësinë e provave në gjykim, përfshirë provat konfirmuese. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e intervistës së ZPS-së me z. Selimi e nëntorit 2019 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

81. Në lidhje me provën materiale shoqëruese, Trupi Gjykses vëren se ajo përbëhet nga dokumenti i të drejtave dhe detyrimeve që iu lexuan z. Selimi në fillim të intervistës dhe vërtetimi i heqjes dorë nga e drejta për avokat.²³⁰ Trupi Gjykses është bindur se prova materiale shoqëruese është pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e intervistës së ZPS-së të nëntorit 2019. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se ajo: (i) ka lidhje me lëndën dhe ofron kontekst relevant për dokumentin me shkrim në të cilin diskutohet; (ii) ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti; dhe (iii) ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

82. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se intervista e ZPS-së me z. Selimi e nëntorit 2019 dhe prova materiale shoqëruese kanë lidhje me lëndën dhe janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

²³⁰ *Shih* 068933-TR-ET Pjesa 1, f. 2-3.

(d) Intervista e ZPS-së me z. Selimi e shkurtit 2020

i. Parashtrime

83. ZPS-ja parashtron se, për arsyet e paraqitura më lart,²³¹ intervista e ZPS-së me z. Selimi e shkurtit 2020²³² dhe provat materiale shoqëruese,²³³ janë autentike, kanë lidhje me lëndën dhe kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.²³⁴

84. Mbrojtja e Selimit nuk bën parashtrime konkretisht për kriteret e rregullës 138(1) në lidhje me pranimin e intervistës së ZPS-së me z. Selimi të shkurtit 2020 dhe provave materiale shoqëruese.

85. Mbrojtja e Krasniqit përgjigjet se dy provat materiale shoqëruese u përmendën vetëm shkurtimisht në intervistën e z. Selimi dhe, rrjedhimisht, duhet të paraqiten përmes një dëshmitari që mund të dëshmojë për saktësinë e tyre.²³⁵

86. ZPS-ja kundërpërgjigjet se Mbrojtja e Krasniqit nuk jep arsye të mjaftueshme pse nuk duhen pranuar provat materiale shoqëruese në fjalë.²³⁶

ii. Vlerësimi i Trupit Gjykses

87. Trupi Gjykses vëren se në intervistën e ZPS-së të shkurtit 2020, z. Selimi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) anëtarësinë dhe rolin e tij në UÇK;²³⁷ (ii) Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, anëtarët e tij, komunikimet, mbledhjet, konsultimet dhe proceset e marrjes së

²³¹ *Shih më lart* para. 59.

²³² 074459-TR-ET Pjesët 1-9.

²³³ 074439-074439-ET; 074440-074458A (provat materiale shoqëruese 1-9).

²³⁴ Kërkesa, para. 21, 90, 94-101.

²³⁵ Përgjigjja e Krasniqit, para. 75(g)-(h), që i referohet 074440-074458A, f. 074450-074453 (prova materiale shoqëruese 6), 074458-074459 (prova materiale shoqëruese 9).

²³⁶ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 15, 19-20.

²³⁷ 074459-TR-ET Pjesa 2, f. 2-3.

vendimeve;²³⁸ (iii) emërimin e komandantëve;²³⁹ (iv) raportet e tij me Sylejman Selimin dhe marrëdhëniet ndërmjet disa anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së;²⁴⁰ (v) lëvizjet e tij dhe të anëtarëve të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së brenda dhe jashtë Kosovës;²⁴¹ (vi) operacionin “Shigjeta”;²⁴² (vii) blerjen e armëve nga anëtarë të UÇK-së;²⁴³ (viii) konferencën e Rambujesë;²⁴⁴ (ix) shndërrimin e UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe krijimin e Qeverisë së Përkohshme;²⁴⁵ (x) Shërbimin Informativ të Kosovës (“SHIK”) dhe Zbulim-Kundërzbulimin (“ZKZ/G2”);²⁴⁶ (xi) incidentet në Qirez dhe Baicë;²⁴⁷ dhe (xii) Likocin e qendra të tjera ndalimi.²⁴⁸ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Selimit nuk kundërshtoi relevancën e intervistës së ZPS-së me z. Selimi të shkurtit 2020. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se intervista e ZPS-së me z. Selimi e shkurtit 2020 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

88. Trupi Gjykses rikujton konstatimet e tij më lart lidhur me informacionin dhe garancitë që ZPS-ja i dha z. Selimi në fillim dhe gjatë intervistës së shkurtit 2020.²⁴⁹ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Selimit nuk kundërshtoi relevancën dhe vlerën provuese të intervistës së ZPS-së me z. Selimi të shkurtit 2020. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se intervista e ZPS-së me z. Selimi e shkurtit 2020 është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë cilindo aspekt të intervistës së ZPS-së të shkurtit 2020, në rast se ZPS-ja ia paraqet atë një apo më shumë dëshmitarëve gjatë gjykimit. Mbrojtja gjithashtu mund të thërrasë

²³⁸ 074459-TR-ET Pjesa 2, f. 2-5, 10-13, Pjesa 3, f. 5-6, Pjesa 5, f. 10, Pjesa 6, f. 13.

²³⁹ 074459-TR-ET Pjesa 2, f. 4-6.

²⁴⁰ 074459-TR-ET Pjesa 1, f. 6, Pjesa 5, f. 1.

²⁴¹ 074459-TR-ET Pjesa 3, f. 1-2, Pjesa 5, f. 1, 7, Pjesa 8, f. 1-4.

²⁴² 074459-TR-ET Pjesa 5, f. 17-18.

²⁴³ 074459-TR-ET Pjesa 5, f. 27.

²⁴⁴ 074459-TR-ET Pjesa 5, f. 10-12.

²⁴⁵ 074459-TR-ET Pjesa 5, f. 13-14, Pjesa 6, f. 3.

²⁴⁶ 074459-TR-ET Pjesa 6, f. 4-6.

²⁴⁷ 074459-TR-ET Pjesa 7, f. 2-18.

²⁴⁸ 074459-TR-ET Pjesa 8, f. 4-12.

²⁴⁹ *Shih më lart* para. 35-37.

dëshmitarë në gjykim për të kontestuar cilindo aspekt të kësaj interviste. Trupi Gjykses do ta vlerësojë këtë intervistë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave në gjykim, përfshirë provat konfirmuese. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e intervistës së ZPS-së me z. Selimi, e shkurtit 2020 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

89. Në lidhje me provat materiale shoqëruese, Trupi Gjykses vëren se ato iu treguan z. Selimi dhe u diskutuan me njëfarë hollësie gjatë intervistës.²⁵⁰ Trupi Gjykses është bindur se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit,²⁵¹ provat materiale shoqëruese janë pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e intervistës së ZPS-së të shkurtit 2020. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se ato: (i) kanë lidhje me lëndën dhe ofrojnë kontekst relevant për dokumentin me shkrim në të cilin diskutohen; (ii) në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes së Krasniqit,²⁵² kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti; dhe (iii) kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre. Trupin Gjykses nuk e bindin argumentet e Mbrojtjes së Krasniqit për provat materiale shoqëruese 6 dhe 9 duke qenë se: (i) relevanca e provës materiale shoqëruese 6 nuk cenohet nga fakti se ajo u përmend vetëm shkurtimisht në intervistën e ZPS-së të shkurtit 2020, apo nga fakti se z. Selimi vuri në dyshim saktësinë e saj, pasi ajo është një fragment i nxjerrë nga një libër për luftën me autor z. Krasniqi dhe ajo iu tregua z. Selimi gjatë intervistës dhe ai komentoi mbi të; dhe (ii) prova materiale shoqëruese 9 duket se është autentike dhe relevanca e saj nuk cenohet nga fakti se u përmend vetëm shkurtimisht nga z. Selimi në intervistën e ZPS-së të shkurtit 2020, pasi ajo është një intervistë me z. Krasniqi me datë dhe e botuar nga *Koha Ditore*, e cila iu

²⁵⁰ *Shih p.sh.* 074459-TR-ET Pjesa 1, f. 2-3 (074439-074439-ET), Pjesa 3, f. 10 (prova materiale shoqëruese 1), 16 (prova materiale shoqëruese 2), 20 (provat materiale shoqëruese 3-4), Pjesa 5, f. 22 (prova materiale shoqëruese 5), Pjesa 6, f. 10-13 (prova materiale shoqëruese 6), Pjesa 7, f. 14-16 (prova materiale shoqëruese 7), 21-22 (prova materiale shoqëruese 8), Pjesa 8, f. 13-20 (prova materiale shoqëruese 9).

²⁵¹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 75(g)-(h).

²⁵² Përgjigjja e Krasniqit, para. 75(g)-(h).

tregua z. Selimi gjatë intervistës dhe ai komentoi mbi të. Këto janë aspekte që Trupi Gjykses mund t'i marrë parasysh në vlerësimin e peshës dhe/ose të vlerës provuese që mund t'u jepet këtyre materialeve.

90. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se intervista e ZPS-së me z. Selimi e shkurtit 2020 dhe provat materiale shoqëruese kanë lidhje me lëndën dhe janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

(e) Përfundim

91. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se intervistat e ZPS-së me z. Thaçi dhe z. Selimi dhe provat materiale shoqëruese kanë lidhje me lëndën dhe janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

B. INTERVISTAT E TJERA SI TË DYSHUAR

1. Përputhshmëria e intervistave të tjera të të akuzuarve si të dyshuar me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, sipas rregullës 138(2)

(a) Intervista e PSRK-së me z. Thaçi e vitit 2016²⁵³

i. Parashtrime

92. ZPS-ja parashtron se më 6 maj 2016 PSRK-ja kreu një intervistë me z. Thaçi si i dyshuar.²⁵⁴ ZPS-ja parashtron se intervista e PSRK-së me z. Thaçi e majit 2016

²⁵³ 051716-051719-ET.

²⁵⁴ Kërkesa, para. 22.

ishite në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.²⁵⁵ Në veçanti, ZPS-ja parashtroi se të drejtat e z. Thaçi u respektuan pasi ai: (i) u informua për hetimin penal kundër tij dhe se kishte arsye të besohesh se ai ishte përfshirë në kryerjen e një krimi lufte kundër popullatës civile sipas neneve 142 dhe 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("KPRSFJ"); (ii) u informua për të drejtën për të heshtur, për mbrojtës dhe përkthyes dhe për të drejtën e mosinkriminimit të vetes; (iii) u informua se çdo deklaratë e bërë mund të përdorej si provë kundër tij në gjykim; dhe (iv) u informua zyrtarisht për të drejtat e tij sipas nenit 125(3) dhe 152(3) të KPPK-së.²⁵⁶ ZPS-ja parashtroi se: (i) z. Thaçi konfirmoi se i kishte kuptuar këto të drejta dhe se nuk dëshironte të kishte avokat; dhe (ii) atij iu lexua procesverbali i intervistës dhe ai e nënshkroi atë.²⁵⁷

93. Mbrojtja e Thaçit nuk kundërshton pranimin si provë të intervistës së PSRK-së të majit 2016.²⁵⁸

ii. Vlerësimi i Trupit Gjykses

94. Trupi Gjykses vëren se, në fillim të intervistës së PSRK-së të majit 2016, z. Thaçi u informua nga PSRK-ja se kundër tij ishte paraqitur një çështje penale në lidhje me veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile.²⁵⁹

95. Sa u përket të drejtave, Trupi Gjykses vëren se z. Thaçi u informua se: (i) intervista po regjistrohej me shkrim në mungesë të pajisjeve teknike për incizimin e saj në audio dhe video; (ii) ai kishte të drejtën të heshtte dhe të mos u përgjigjej pyetjeve; (iii) ai kishte të drejtën për të mos inkriminuar veten; (iv) çdo deklaratë e bërë mund të përdorej si provë në gjykatë; (v) ai kishte të drejtën për

²⁵⁵ Kërkesa, para. 90.

²⁵⁶ Kërkesa, para. 22-23.

²⁵⁷ Kërkesa, para. 23-25.

²⁵⁸ Përgjigjja e Thaçit, para. 34.

²⁵⁹ 051716-051719-ET, f. 1.

të pasur përkthyes; (vi) ai kishte të drejtën për t'u ndihmuar nga një avokat; dhe (vii) nëse nuk e kuptonte ndonjë pyetje, mund të kërkonte që ajo të bëhej ndryshe.²⁶⁰

96. Gjatë intervistës, z. Thaçi: (i) konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat e tij;²⁶¹ (ii) konfirmoi se e kuptonte veprën penale për të cilën akuzohej;²⁶² (iii) konfirmoi se e kuptonte se kishte të drejtën për avokat dhe u përgjigj se do të paraqiste mbrojtje; iu përgjigj pyetjeve që iu bënë dhe deklaroi se në këtë fazë të procedurës penale nuk dëshironte të angazhonte avokat për mbrojtjen e tij;²⁶³ dhe (iv) konfirmoi se procesverbali i intervistës iu lexua me zë dhe se e kishte nënshkruar atë pa asnjë vërejtje.²⁶⁴

97. Trupi Gjykses konstaton se z. Thaçi u informua plotësisht për të drejtat e tij si i dyshuar dhe hoqi dorë vullnetarisht dhe në mënyrë të qartë, të vetëdijshme dhe racionale nga e drejta për avokat. Trupi Gjykses është bindur se ai hoqi dorë nga të gjitha të drejtat e tjera në mënyrë racionale dhe të bazuar në informacion.

98. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses nuk konstaton shkelje të të drejtave të z. Thaçi sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

(b) Intervista e PSRK-së me z. Krasniqi e dhjetorit 2013²⁶⁵

i. Parashtrime

99. ZPS-ja parashtron se më 20 dhjetor 2013, PSRK-ja kreu intervistë me z. Krasniqi si i dyshuar.²⁶⁶ ZPS-ja parashtron se intervista e PSRK-së me z. Krasniqi e dhjetorit 2013 ishte në përputhje me standardet e ndërkombëtare të të drejtave

²⁶⁰ 051716-051719-ET, f. 2.

²⁶¹ 051716-051719-ET, f. 2.

²⁶² 051716-051719-ET, f. 3.

²⁶³ 051716-051719-ET, f. 3.

²⁶⁴ 051716-051719-ET, f. 4.

²⁶⁵ SITF00364476-00364497; 031024-05-TR-ET Pjesa 1; 031024-05.

²⁶⁶ Kërkesa, para. 27.

të njeriut.²⁶⁷ Në veçanti, ZPS-ja parashtron se të drejtat e z. Krasniqi u respektuan pasi: (i) atij iu lexuan të drejtat sipas nenit 125(3) të KPPK-së; (ii) intervista u incizua në audio dhe video në përputhje me nenin 152(5) të KPPK-së; (iii) ai informua për të drejtat për të heshtur, për mbrojtës dhe përkthyes dhe për privilegjin e mosinkriminimit të vetes; dhe (iv)) ai u informua zyrtarisht për të drejtat e tij sipas nenit 125(3) dhe 152(3) të KPPK-së.²⁶⁸ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se z. Krasniqi hoqi dorë vullnetarisht dhe në mënyrë racionale nga e drejta për të heshtur dhe ushtroi të drejtën për të pasur një avokat të pranishëm.²⁶⁹

100. Mbrojtja e Krasniqit kundërshton pranimin të deklaratave të mëhershme të akuzuarit në përgjithësi, me argumentin se janë të papranueshme në mungesë të një dispozite që i bën shprehimisht të pranueshme.²⁷⁰ Gjithashtu, Mbrojtja e Krasniqit argumenton se, duke qenë se pranimi i deklaratave të mëhershme të një të akuzuari cenon të drejtat themelore të tij për mosinkriminim të vetes dhe përfaqësim juridik, ato nuk duhet të pranohen pasi venë në dyshim mbështetshmërinë në ato deklarata dhe do të dëmtonin rëndë integritetin e procesit, në shkelje të rregullës 138(1)-(2).²⁷¹ Mbrojtja e Krasniqit argumenton gjithashtu se të njëjtat parime vlejnë edhe kur cenimi i të drejtave bëhet nga një subjekt tjetër përveç DHSK-së.²⁷²

101. ZPS-ja kundërpërgjigjet se Mbrojtja e Krasniqit nuk ka demonstruar se intervista e PSRK-së e dhjetorit 2013 nuk duhet pranuar si provë, pasi atij iu akorduan të drejtat si i dyshuar. Gjithashtu, z. Krasniqi pati përkthyes, u përfaqësua nga një mbrojtës, e nënshkroi deklaratën dhe vuri inicialet në çdo faqe.²⁷³

²⁶⁷ Kërkesa, para. 90.

²⁶⁸ Kërkesa, para. 28.

²⁶⁹ Kërkesa, para. 28-29.

²⁷⁰ Përgjigjja e Krasniqit, para. 22.

²⁷¹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 22-25, 27.

²⁷² Përgjigjja e Krasniqit, para. 26.

²⁷³ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 13.

ii. Vlerësimi i Trupit Gjykses

102. Trupi Gjykses vëren se në fillim të intervistës së PSRK-së të dhjetorit 2013, z. Krasniqi u informua nga PSRK-ja se ndaj tij kishte një çështje penale në lidhje me veprën penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile.²⁷⁴

103. Sa u përket të drejtave të tij, Trupi Gjykses vëren se z. Krasniqi u informua se: (i) intervista po incizohej;²⁷⁵ (ii) kishte të drejtën të heshte dhe të mos u përgjigjej pyetjeve;²⁷⁶ (iii) kishte të drejtën për të mos inkriminuar veten;²⁷⁷ (iv) çdo deklaratë e bërë mund të përdorej si provë në gjykatë;²⁷⁸ (v) kishte të drejtën për të pasur përkthyes;²⁷⁹ (vi) kishte të drejtën për t'u ndihmuar nga një avokat;²⁸⁰ dhe (vii) nëse nuk e kuptonte ndonjë pyetje, mund të kërkonte që ajo të bëhej ndryshe.²⁸¹

104. Gjatë intervistës, z. Krasniqi: (i) konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat e tij;²⁸² (ii) atij iu lexuan akuzat dhe konfirmoi se i kuptonte ato;²⁸³ (iii) kishte një përkthyes të pranishëm;²⁸⁴ (iv) u ndihmua nga një avokat mbrojtës;²⁸⁵ (v) konfirmoi se nuk dëshironte të ushtronte të drejtën për të heshtur, por u përgjigj se dëshironte të jepte deklaratë dhe të ndihmonte drejtësinë;²⁸⁶ dhe (vi) konfirmoi se përkthyesi ia lexoi procesverbalin në gjuhën shqipe dhe konfirmoi se “gjithçka është e saktë”.²⁸⁷

²⁷⁴ SITF00364476-00364497, f. 2.

²⁷⁵ SITF00364476-00364497, f. 1.

²⁷⁶ SITF00364476-00364497, f. 1-2.

²⁷⁷ SITF00364476-00364497, f. 1.

²⁷⁸ SITF00364476-00364497, f. 1-2.

²⁷⁹ SITF00364476-00364497, f. 2.

²⁸⁰ SITF00364476-00364497, f. 2.

²⁸¹ SITF00364476-00364497, f. 2.

²⁸² SITF00364476-00364497, f. 2.

²⁸³ SITF00364476-00364497, f. 2-3.

²⁸⁴ SITF00364476-00364497, f. 3.

²⁸⁵ SITF00364476-00364497, f. 3.

²⁸⁶ SITF00364476-00364497, f. 3.

²⁸⁷ SITF00364476-00364497, f. 7.

105. Trupi Gjykses konstaton se z. Krasniqi u informua plotësisht për të drejtat e tij si i dyshuar dhe u përfaqësua nga një mbrojtës gjatë intervistës. Trupi Gjykses është bindur se ai hoqi dorë nga e drejta për të heshtur dhe e drejta e mosinkriminimit të vetes mbi bazën e informacionit dhe në mënyrë racionale dhe pati ndihmën e mbrojtësit gjatë gjithë intervistës.

106. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të z. Krasniqi në bazë të standardeve të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

(c) Përfundim

107. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se intervistat e tjera të z. Thaçi dhe z. Krasniqi si të dyshuar u kryen në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

108. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses në vijim do të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret kumulative për pranimin e provave (lidhja me lëndën, autenticiteti, vlera provuese dhe efekti dëmtues) sipas rregullës 138(1) në lidhje me secilën prej intervistave të tjera si të dyshuar dhe provat materiale shoqëruese.

2. Pranueshmëria e intervistave të tjera të të akuzuarve si të dyshuar dhe e provave materiale shoqëruese sipas rregullës 138(1)

109. ZPS-ja parashtro se intervistat e tjera të të akuzuarve si të dyshuar përfshijnë prova të mbledhura në procese penale dhe hetime para dhe pas themelimit të DHS-së.²⁸⁸ ZPS-ja parashtro se intervistat e tjera të të akuzuarve si të dyshuar: (i) kanë lidhje me lëndën pasi kanë të bëjnë, ndër të tjera, me pozitën dhe përfshirjen e të akuzuarve në UÇK, strukturën organizative, vendndodhjen e të akuzuarve gjatë periudhës që përfshin Aktakuza dhe dijeninë e tyre për arrestimet

²⁸⁸ Kërkesa, para. 102.

dhe ndalimet e civilëve;²⁸⁹ (ii) janë autentike dhe në to mund të mbështetesh, pasi në kohën kur u kryen intervistat, të akuzuarit ishin “të dyshuar” dhe u njoftuan dhe informuan për të drejtat e tyre në fillim të çdo interviste;²⁹⁰ (iii) kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve, pasi deklaratat u dhanë nga të akuzuarit pasi ata hoqën dorë në mënyrë të vetëdijshme dhe racionale nga të drejtat e tyre, dhe, në rastin e z. Krasniqi, në prani të mbrojtësit.²⁹¹ Gjithashtu, ZPS-ja parashtrohet se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë provat dhe Trupi Gjyqësor, i përbërë nga gjykatës profesionistë, në përfundim të procesit gjyqësor do të mund të vlerësojë siç duhet tërësinë e provave të paraqitura dhe t’u japë peshën e duhur intervistave të tjera të të akuzuarve si të dyshuar.²⁹²

110. Më poshtë përshkruhen kundërshtimet e Mbrojtjes në lidhje me secilin material të propozuar.

(a) Intervista e PSRK-së me z. Thaçi e majit 2016

i. Parashtrime

111. ZPS-ja parashtrohet se, për arsyet e paraqitura më lart,²⁹³ intervista e PSRK-së me z. Thaçi e majit 2016,²⁹⁴ është autentike, ka lidhje me lëndën dhe ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.²⁹⁵

112. Trupi Gjyqësor rikujton se Mbrojtja e Thaçit nuk kundërshton pranimin si provë të intervistës së PSRK-së të majit 2016.²⁹⁶

²⁸⁹ Kërkesa, para. 103. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 26, 29.

²⁹⁰ Kërkesa, para. 104-106.

²⁹¹ Kërkesa, para. 107-108.

²⁹² Kërkesa, para. 108.

²⁹³ *Shih më lart* para. 109.

²⁹⁴ 051716-051719-ET.

²⁹⁵ Kërkesa, para. 26, 103-108.

²⁹⁶ *Shih më lart* para. 93. *Shih gjithashtu* Përgjigjen e Thaçit, para. 34.

ii. Vlerësimi i Trupit Gjykses

113. Trupi Gjykses vëren se, në intervistën e tij të majit 2016 me PSRK-në, z. Thaçi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet sa i takon pretendimeve në lidhje me, ndër të tjera: (i) rolin e tij në UÇK; (ii) Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, (iii) lëshimin e komunikatave të UÇK-së; dhe (iv) lëvizjet e tij brenda Kosovës.²⁹⁷ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçit nuk kundërshtoi relevancën e intervistës së majit 2016 të PSRK-së me z. Thaçi. Trupi Gjykses është bindur se intervista e PSRK-së me z. Thaçi e majit 2016 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

114. Trupi Gjykses rikujton konstatimet e tij më lart në lidhje me informacionin dhe garancitë që iu dhanë z. Thaçi në fillim dhe gjatë intervistës së PSRK-së të majit 2016.²⁹⁸ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçit nuk kundërshton autenticitetin apo vlerën provuese të intervistës së PSRK-së me z. Thaçi të majit 2016. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se intervista e PSRK-së me z. Thaçi e majit 2016 është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë cilindo aspekt të intervistës së PSRK-së të majit 2016, nëse ZPS-ja ia paraqet këtë intervistë një apo më shumë dëshmitarëve gjatë gjykimit. Gjithashtu, Mbrojtja mund të thërrasë dëshmitarë në gjykim për të kontestuar cilindo aspekt të kësaj interviste. Trupi Gjykses do ta vlerësojë këtë intervistë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave në gjykim, përfshirë provat konfirmuese. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e intervistës së PSRK-së me z. Thaçi e majit 2016 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

115. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se intervista e PSRK-së me z. Thaçi e majit 2016, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë

²⁹⁷ 051716-051719-ET, f. 3-4.

²⁹⁸ *Shih më lart* para. 94-96.

autentike, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

(b) Intervista e PSRK-së me z. Krasniqi e dhjetorit 2013

i. Parashtrime

116. ZPS-ja parashtron se, për arsyet e paraqitura më lart,²⁹⁹ intervista e PSRK-së me z. Krasniqi e dhjetorit 2013,³⁰⁰ është autentike, ka lidhje me lëndën dhe ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.³⁰¹

117. Mbrojtja e Krasniqit kundërshton pranimin e intervistës së PSRK-së të dhjetorit 2013 dhe kundërshton mbështetshmërinë dhe autenticitetin e kësaj interviste mbi bazën se: (i) z. Krasniqi kishte mundësi të kufizuar ta shqyrtonte procesverbalin dhe të bënte ndryshime, pasi deklarata e tij ishte në anglishte, gjuhë që ai nuk e flet;³⁰² (ii) deklarata ka të bëjë vetëm me aspekte të pakontestuar ose për të cilat z. Krasniqi konfirmoi se nuk kishte dijeni;³⁰³ (iii) përmbajtja e deklaratës është e ngjashme me disa pjesë të provave të W02652-shit, që Trupi Gjykses i përjashtoi kohët e fundit me arsyetimin se ngjarjet me të cilat kanë lidhje nuk pretendohet se ishin pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët ("NKP") dhe nuk janë prova të sulmit të përhapur gjerësisht ose sistematik ndaj kundërshtarëve apo të konfliktit të armatosur sipas Aktakuzës;³⁰⁴ dhe (iv) ndonëse z. Krasniqi iu akorduan të drejtat e personit të dyshuar, akuzat për të cilat u njoftua atëherë ishin krejt të ndryshme nga ato me të cilat përballet tani dhe, rrjedhimisht, heqja dorë

²⁹⁹ *Shih më lart* para. 109.

³⁰⁰ SITF00364476-00364497; 031024-05-TR-ET Pjesa 1; 031024-05.

³⁰¹ Kërkesa, para. 29, 103-108.

³⁰² Përgjigjja e Krasniqit, para. 46.

³⁰³ Përgjigjja e Krasniqit, para. 47.

³⁰⁴ Përgjigjja e Krasniqit, para. 48, që i referohet Transkriptit të seancës, 17 prill 2023, f. 2863, rreshti 13 deri në f. 2866, rreshti 8.

prej tij nga e drejta për të heshtur nuk mund të trajtohet si e bazuar në informacion.³⁰⁵

118. ZPS-ja kundërpërgjigjet se Mbrojtja e Krasniqit nuk përmend se në intervistën e PSRK-së të dhjetorit 2013 jepet informacion për një sërë aspektesh relevante, si vendndodhja e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, mbledhjet në të cilat mori pjesë ai, pozitat e Sylejman Selimit në UÇK dhe pozita e tij në raport me z. Krasniqi.³⁰⁶

ii. Vlerësimi i Trupit Gjykues

119. Trupi Gjykues vëren se në intervistën e PSRK-së të dhjetorit 2013, z. Krasniqi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me: (i) rolin e tij në UÇK;³⁰⁷ (ii) strukturën e UÇK-së;³⁰⁸ (iii) lidhjet e tij me anëtarë të tjerë të UÇK-së, si Sylejman Selimi;³⁰⁹ (iv) lëvizjet e tij brenda dhe jashtë Kosovës;³¹⁰ (v) bisedimet e Rambujesë;³¹¹ dhe (vi) dijeninë e tij për arrestimet dhe ndalimet, si ato në Likoc.³¹² Trupi Gjykues është bindur se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit,³¹³ intervista e PSRK-së me z. Krasniqi e dhjetorit 2013 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

120. Trupi Gjykues rikujton konstatimet e tij më lart në lidhje me informacionin dhe garancitë që iu dhanë z. Krasniqi në fillim dhe gjatë intervistës së PSRK-së të dhjetorit 2013.³¹⁴ Në veçanti, Trupi Gjykues vëren se z. Krasniqi kishte përkthyes të pranishëm, konfirmoi se përkthyesi ia lexoi procesverbalin e intervistës në

³⁰⁵ Përgjigjja e Krasniqit, para. 49.

³⁰⁶ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 13.

³⁰⁷ SITF00364476-00364497, f. 3.

³⁰⁸ SITF00364476-00364497, f. 4.

³⁰⁹ SITF00364476-00364497, f. 4-6.

³¹⁰ SITF00364476-00364497, f. 3-4.

³¹¹ SITF00364476-00364497, f. 3.

³¹² SITF00364476-00364497, f. 3-6.

³¹³ Përgjigjja e Krasniqit, para. 47-48.

³¹⁴ *Shih më lart* para. 94-96.

gjuhën shqipe dhe se “gjithçka është e saktë”.³¹⁵ Kjo kundërshton pretendimin e z. Krasniqi se ai pati mundësi të kufizuar ta shqyrtonte procesverbalin dhe të sugjeronte ndryshime në të. Gjithashtu, Trupin Gjykues nuk e bind argumenti i Mbrojtjes së Krasniqit se heqja dorë prej z. Krasniqi nga e drejta për të heshtur nuk mund të trajtohet se u bazua në informacion, pasi akuzat për të cilat u njoftua atëherë ishin të ndryshme nga ato me të cilat përballet tani. Në lidhje me këtë, që heqja dorë nga e drejta për të heshtur të konsiderohet e bazuar në informacion, Trupi Gjykues është i mendimit se informacioni dhe garancitë që i jepen të dyshuarit kanë lidhje domosdoshmërisht me akuzat kundër të dyshuarit në atë kohë dhe jo me ato që mund të ngrihen kundër tij në të ardhmen, sepse autoriteti i ndjekjes penale vetëm për ato kishte dijeni në kohën e intervistës.³¹⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se z. Krasniqi hoqi dorë vullnetarisht dhe në mënyrë racionale nga e drejta për të heshtur mbi bazën e informacionit dhe garancive që iu dhanë në fillim dhe gjatë intervistës së PSRK-së të dhjetorit 2013 dhe ushtroi të drejtën për të pasur një avokat të pranishëm.³¹⁷ Për këto arsye, Trupi Gjykues është bindur se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit,³¹⁸ intervista e PSRK-së me z. Krasniqi e dhjetorit 2013 është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë cilindo aspekt të intervistës së PSRK-së të dhjetorit 2013, nëse ZPS-ja ia paraqet atë një apo më shumë dëshmitarëve gjatë gjyqimit. Mbrojtja gjithashtu mund të thërrasë dëshmitarë në gjykim për të kontestuar cilindo aspekt të kësaj interviste. Trupi Gjykues do ta vlerësojë intervistën duke mbajtur parasysh tërësinë e provave në gjykim, përfshirë provat konfirmuese. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se vlera provuese e intervistës së PSRK-së me z. Krasniqi e dhjetorit 2013 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

³¹⁵ SITF00364476-00364497, f. 3, 7.

³¹⁶ *Shih më lart* para. 17, 26 dhe referencat e cituara në to.

³¹⁷ SITF00364476-00364497, f. 3.

³¹⁸ Përgjigjja e Krasniqit, para. 46-49.

121. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se intervista e PSRK-së me z. Krasniqi e dhjetorit 2013, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

(c) Përfundim

122. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se intervistat e tjera të z. Thaçi dhe z. Krasniqi si të dyshuar kanë lidhje me lëndën dhe janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

C. DEKLARATAT DHE DËSHMITË SI DËSHMITARË TË TË AKUZUARVE

123. ZPS-ja parashttron se deklaratat dhe dëshmitë e të akuzuarve si dëshmitarë përfshijnë prova të mbledhura në procese penale dhe hetime para dhe pas themelimit të DHS-së.³¹⁹ ZPS-ja parashttron se deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitarë të të akuzuarve: (i) kanë lidhje me lëndën, pasi kanë të bëjnë, ndër të tjera, me pozitat dhe përfshirjen e të akuzuarve në UÇK, strukturën organizative, vendndodhjen e të akuzuarve gjatë periudhave që përfshin Aktakuza, politikën e UÇK-së lidhur me trajtimin e “bashkëpunëtorëve” dhe dijeninë e të akuzuarve për arrestimet, ndalimet dhe keqtrajtimet e përfshirjen e tyre në to;³²⁰ (ii) janë autentike dhe me vlerë provuese, pasi u dhanë vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u morën në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;³²¹ dhe (iii) për arsyet e lartpërmendura, vlera provuese e tyre

³¹⁹ Kërkesa, para. 109.

³²⁰ Kërkesa, para. 110. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 32, 36, 38, 40, 44, 47, 50, 53, 57, 61, 63, 66, 69, 75, 77, 81, 83, 85, 87, 89.

³²¹ Kërkesa, para. 111-115. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 2, 31-35, 37, 39, 41-43, 45-46, 48-49, 51-52, 54-56, 58-60, 62-65, 67-68, 70-74, 76, 78-80, 82, 84, 86, 88.

nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre, Mbrojtja do të ketë mundësinë t'i kundërshtojë këto prova dhe, në përfundim të gjykit, Trupi Gjykses, i përbërë nga gjykatës profesionistë, do të mund të vlerësojë si duhet tërësinë e provave të paraqitura dhe t'u japë atyre peshën e duhur.³²² Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se në deklaratat dhe dëshmitë në fjalë u përdorën prova materiale shoqëruese, të cilat janë pjesë përbërëse e tyre.³²³

1. Deklaratat si dëshmitar të Thaçit

(a) Parashtrime

124. ZPS-ja kërkon pranimin si prova të këtyre deklaratave të mëhershme të z. Thaçi si dëshmitar: (i) intervistës dhënë PSRK-së më 8 nëntor 2011³²⁴ në hetimin ndaj *Arben Krasniqit dhe të tjerëve*; (ii) intervistës dhënë PSRK-së më 3 korrik 2018³²⁵ në hetimin ndaj *NN dhe të tjerëve*; dhe (iii) shënimeve të hetuesit nga një deklaratë dhënë TPNJ-së më 5 maj 2004³²⁶ ("deklaratat e Thaçit si dëshmitar").³²⁷ ZPS-ja parashtron se për arsyet e paraqitura më lart,³²⁸ deklaratat e Thaçit si dëshmitar janë autentike, kanë lidhje me lëndën dhe kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.³²⁹

125. Mbrojtja e Thaçit kundërshton pranimin e "deklaratës" dhënë TPNJ-së në maj 2004, me argumentin se ajo nuk mund të cilësohet si deklaratë, por si shënime të hetuesit që intervistoi z. Thaçi dhe, rrjedhimisht, pranimi i këtij dokumenti mund të rrezikojë drejtësinë e procesit.³³⁰ Konkretisht, Mbrojtja e Thaçit parashtron se:

³²² Kërkesa, para. 115-116.

³²³ Kërkesa, para. 110.

³²⁴ SITF00009007-00009016 ("deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011").

³²⁵ SPOE00213717-SPOE00213719-ET ("deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018").

³²⁶ U008-1957-U008-1967 ("deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2004").

³²⁷ Kërkesa, para. 31-36, 70-75. *Shih gjithashtu* Shtojcën e Kërkesës, materialet 9-10, 22.

³²⁸ *Shih më lart* para. 123.

³²⁹ Kërkesa, para. 110-116.

³³⁰ Përgjigjja e Thaçit, para. 31-33.

(i) nuk ka asnjë mënyrë për të ditur nëse shënimet pasqyrojnë në mënyrë të plotë çka tha z. Thaçi; (ii) ato përmbajnë një shënim në lidhje me lirim nga përgjegjësia, ku thuhet “këto shënime nuk synojnë të pasqyrojnë në mënyrë të plotë intervistën ose përmbajtjen e saj në kohën kur u zhvillua, por janë një përmbledhje e pikave relevante më të rëndësishme të saj” dhe “këto shënime u përpiluan në bazë të kujtesës sime për intervistën;” dhe (iii) në intervistën e ZPS-së të korrikut 2020, z. Thaçi vuri në dukje se shënimet nuk përfaqësonin intervistën e tij të plotë dhe u distancua prej tyre.³³¹ Mbrojtja e Thaçit nuk kundërshton pranimin e deklaratave si dëshmitar të dhëna për PSRK-në.³³²

126. ZPS-ja kundërpërgjigjet nuk ishte e nevojshme që intervista e Thaçit dhënë TPNJ-së në vitin 2004 të incizohej, sepse z. Thaçi u intervistua si dëshmitar dhe jo si i dyshuar dhe intervista përfundoi në më pak se katër orë dhe shënimet e hollësishme të hetuesit u rishikuan dhe ndryshuan nga z. Thaçi aty ku ishte e nevojshme.³³³

(b) Vlerësimi i Trupit Gjykses

i. Deklarata e Thaçit si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011

127. Trupi Gjykses vëren se, në deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011, z. Thaçi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendimet që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me: (i) rolin e tij në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në vitin 1999;³³⁴ dhe (ii) lëvizjet e tij në Kosovë dhe Shqipëri afërsisht nga shkurti deri në prill 1999, si dhe informacione për anëtarë dhe udhëheqës të tjerë të UÇK-së me të cilët ishte takuar ose kishte udhëtuar.³³⁵

³³¹ Përgjigjja e Thaçit, para. 31.

³³² Përgjigjja e Thaçit, para. 34.

³³³ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Thaçit, para. 11.

³³⁴ SITF00009007-00009016, f. 2.

³³⁵ SITF00009007-00009016, f. 2-4.

128. Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja e Thaçit nuk ka kundërshtuar relevancën e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011 dhe, rrjedhimisht, Trupi Gjykues është bindur se përmbajtja e saj ka vërtet lidhje me akuzat në Aktakuzë.

129. Trupi Gjykues vëren se para marrjes në pyetje, prokurori publik e informoi z. Thaçi për detyrimin që të thoshte të vërtetën dhe se nuk ishte i detyruar t'u përgjigjej pyetjeve të caktuara "kur ka gjasa se me këtë [ai] do ta vinte veten ose ndonjë të afërm të ngushtë para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale". Z. Thaçi u përgjigj se i kuptonte të drejtat e tij.³³⁶ Trupi Gjykues gjithashtu vëren se asgjë nuk sugjeron se gjatë intervistës statusi i z. Thaçi duhet të kishte ndryshuar në atë të një të dyshuari. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se në kohën kur PSRK-ja i mori deklaratë z. Thaçi si dëshmitar në nëntor 2011, ai nuk kishte të drejtën e garancive mbrojtëse që i jepen një të dyshuari. Trupi Gjykues është i mendimit se një person që intervistohet si dëshmitar nuk gëzon të njëjtat garanci mbrojtëse të procesit ligjor të rregullt si ato që i jepen një të dyshuari, në qoftë se në kohën e intervistës nuk konsiderohet ose trajtohet si i dyshuar, pavarësisht nëse më vonë bëhet i dyshuar ose i akuzuar.³³⁷ Nga kjo rrjedh se, për pranimin si provë në një proces gjyqësor të mëvonshëm të deklaratës që një person e ka dhënë si dëshmitar, zakonisht nuk është e nevojshme që atij t'i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari. Trupi Gjykues është i vetëdijshëm se mund të ketë përjashtime nga ky parim, si në rastin e veprimeve të pandershme nga autoritetet dhe/ose situatave ku përgjigjet e personit të intervistuar përmbajnë tregues të qartë për përfshirjen e tij në kryerjen e një krimi, që duhet të kishte çuar në rishikimin e statusit të personit nga autoriteti intervistues. Trupi Gjykues është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e

³³⁶ SITF00009007-00009016, f. 1.

³³⁷ *Shih* ECtHR, [Ibrahim and Others Judgment](#), para. 270; *Schmid-Laffer v. Switzerland*, Application no. 41269/08, [Judgement](#), 16 June 2015, paras 29, 39.

njeriut. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011 ka datë dhe nënshkrimet e prokurorit publik të PSRK-së, procesmbajtëses, përkthyesit dhe z. Thaçi.³³⁸ Trupi Gjykues gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçit nuk kundërshtoi autenticitetin apo vlerën provuese të deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011, është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Gjithashtu, Trupi Gjykues vë në dukje se: (i) Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011, ndër to dhe përgjigjen e z. Thaçi ndaj pyetjes 27 të korrigjuar në intervistën e ZPS-së të korrikut 2020, si dhe të marrë në pyetje cilindo dëshmitar të cilit mund t'i bëhen pyetje për këto deklarata,³³⁹ dhe (ii) deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011 do të vlerësohet më pas nga Trupi Gjykues, duke mbajtur parasysh tërësinë e provave dhe duke i kushtuar vëmendje ekzistencës ose mungesës së çfarëdo konfirmimi në lidhje me cilindo aspekt juridikisht thelbësor të dokumentit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

130. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues konstaton se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në nëntor 2011, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

³³⁸ SITF00009007-00009016, f. 1, 5.

³³⁹ *Shih* Përgjigjen e Thaçit, para. 34, që i referohet 076563-TR-ET Pjesa 18, f. 6-12.

ii. Deklarata si dëshmitar e Thaçit dhënë PSRK-së në korrik 2018

131. Trupi Gjykses vëren se, në deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018, z. Thaçi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) lidhjet e tij me Ramiz Lladrovci dhe Milaim Zekën; dhe (ii) shantazhin që i kishte bërë Lladrovci “në lidhje me rastin e vrasjes apo rënies” së viktimës në fjalë.³⁴⁰ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçit nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018.³⁴¹ Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

132. Trupi Gjykses vëren se para fillimit të intervistës, z. Thaçi u informua për të drejtat dhe detyrimet e tij sipas neneve 125 dhe 129 të KPPK-së dhe se “si dëshmitar ai nuk ka detyrimin t’u përgjigjet pyetjeve konkrete kur ka gjasa se me këtë e vë veten ose ndonjë të afërm të ngushtë para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale”, dhe ai konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat e tij.³⁴² Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklarate dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një dëshmitar që nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t’i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.³⁴³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018 ka datë dhe është nënshkruar nga prokurori i shtetit,

³⁴⁰ SPOE00213717-SPOE00213719-ET, f. 2-3.

³⁴¹ Përgjigja e Thaçit, para. 34.

³⁴² SPOE00213717-SPOE00213719-ET, f. 2.

³⁴³ *Shih më lart* para. 129.

procesmbajtësja dhe z. Thaçi.³⁴⁴ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçit nuk kundërshtoi autenticitetin apo vlerën provuese të deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018 është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë cilindo aspekt të deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018, që ZPS-ja do t'ia paraqesë ndonjë dëshmitari, si dhe të thërrasë dëshmitarë në gjykim për të kontestuar cilindo aspekt të këtij dokumenti për të cilin ka kundërshtime. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se do të vlerësojë peshën dhe vlerën provuese të këtij dokumenti duke mbajtur parasysh tërësinë e provave dhe çdo element konfirmues që mund të jetë pjesë e atij dokumenti. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

133. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar e Thaçit dhënë PSRK-së në korrik 2018, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

iii. Deklarata si dëshmitar e Thaçit dhënë TPNJ-së në maj 2004

134. Trupi Gjykses vëren se, në deklaratën e tij si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2004, z. Thaçi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendimet që kanë të bëjnë me: (i) anëtarësinë e tij në UÇK që nga krijimi i saj në vitin 1992;³⁴⁵ (ii) lidhjet e tij me Jakup Krasniqin, Fatmir Limajn, Ismet Jasharin, Sahit Jasharin, Fehmi Lladrovcin, Jakup Lladrovcin, Haxhi Shalën, Shukri Bujën

³⁴⁴ SPOE00213717-SPOE00213719, f. 1-3.

³⁴⁵ U008-1957-U008-1967, f. 2-10.

dhe Bislim Zyrapin;³⁴⁶ (iii) Shtabin e Përgjithshëm dhe sistemin e komunikimit, strukturën komanduese dhe bazat e tij;³⁴⁷ (iv) përgjegjësinë operative të tij kur udhëtonte për në Kosovë;³⁴⁸ (v) policinë ushtarake të UÇK-së;³⁴⁹ (vi) trajtimin e “bashkëpunëtorëve”;³⁵⁰ (vii) dijeninë për arrestimet dhe ndalimet dhe përfshirjen e tij në to;³⁵¹ (viii) betejën e Gllogjanit më 24 mars 1998.³⁵² Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçit nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2004. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2004 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

135. Trupi Gjykses vëren se përpara fillimit të intervistës, z. Thaçi u informua se ishte aty si dëshmitar dhe se deklarata e tij do të incizohej; ai konfirmoi se e kuptoi këtë dhe pranoi të kryhej intervista.³⁵³ Trupi Gjykses vëren se për shkak të një defekti teknik, intervista nuk u incizua në audio dhe shënimet e hetuesit janë i vetmi dokument i ruajtur prej saj.³⁵⁴ Sipas Trupit Gjykses, z. Thaçi pati mundësinë t’i shikonte ato shënime dhe dha sqarime dhe shpjegime me shkrim, të cilat u përfshinë në dokument.³⁵⁵ Trupi Gjykses gjithashtu vlerëson se z. Thaçi: (i) mbështeti tekstin e deklaratës së tij;³⁵⁶ (ii) konfirmoi se mori pjesë në intervistë me kërkesë të Zyrës së Prokurorit të TPNJ-së (“ZP”) dhe se nuk i ishte bërë presion e as i ishte dhënë ndonjë premtim apo stimul për t’iu përgjigjur pyetjeve;³⁵⁷ (iii) konfirmoi se ishte informuar se deklarata e tij mund t’u jepej organeve të rendit dhe ligjit dhe/ose autoriteteve gjyqësore, dhe u pajtua që deklarata t’u jepej

³⁴⁶ U008-1957-U008-1967, f. 2, 7-8.

³⁴⁷ U008-1957-U008-1967, f. 2-3, 6.

³⁴⁸ U008-1957-U008-1967, f. 2.

³⁴⁹ U008-1957-U008-1967, f. 4.

³⁵⁰ U008-1957-U008-1967, f. 7.

³⁵¹ U008-1957-U008-1967, f. 4-5, 7.

³⁵² U008-1957-U008-1967, f. 8.

³⁵³ U008-1957-U008-1967, f. 1-2.

³⁵⁴ U008-1957-U008-1967, f. 1.

³⁵⁵ U008-1957-U008-1967, f. 10-11.

³⁵⁶ U008-1957-U008-1967, f. 11.

³⁵⁷ U008-1957-U008-1967, f. 10.

atyre autoriteteve sipas diskrecionit të Zyrës së Prokurorit të TPNJ-së,³⁵⁸ dhe (iv) në intervistën e ZPS-së të janarit 2020, konfirmoi se i kishte dhënë TPNJ-së deklaratë si dëshmitar në maj 2004.³⁵⁹ Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklarate dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një dëshmitar që nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t'i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.³⁶⁰ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2004 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses vëren se, në rastet e mëpasshme, z. Thaçi nuk shprehu ndonjë kundërshtim të bazuar në vetinkriminim lidhur me këtë deklaratë. Gjithashtu, siç u vu në dukje më lart, në kohën kur u krye intervista, atij iu bë e qartë se deklarata mund t'u jepej organeve të tjera të rendit dhe të ligjit dhe/ose autoriteteve gjyqësore dhe ai u pajtua me këtë. Rrjedhimisht, për të duhet të ketë qenë e qartë se po pajtohej me mundësinë që një autoritet tjetër nga ai që po e intervistonte mund ta konsideronte inkriminues informacionin e dhënë prej tij. Nuk ka prova se prokurori i TPNJ-së veproi në mënyrë të pandershme dhe nga procesverbali i intervistës nuk del se përgjigjet e z. Thaçi bënë që prokurori ta rishikonte qëndrimin e tij lidhur me statusin e Thaçit si dëshmitar e jo si i dyshuar. Trupi Gjykses është gjithashtu i mendimit se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit,³⁶¹ shënimet e hetuesit dokumentojnë saktë atë që tha z. Thaçi gjatë intervistës, pasi z. Thaçi iu dha mundësia t'i shikonte shënimet dhe ai bëri komente me shkrim që u përfshinë në dokument. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se deklarata e Thaçit si

³⁵⁸ U008-1957-U008-1967, f. 11.

³⁵⁹ 071840-TR-ET Pjesa 6, f. 8-9, Pjesa 7, f. 2.

³⁶⁰ *Shih më lart* para. 129. *Shih më poshtë* para. 159-160, 194.

³⁶¹ Përgjigjja e Thaçit, para. 31-33.

dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2004 është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar cilindo aspekt të deklaratës si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2004 të cilin që ajo e konteston, dhe të verifikojë përmbajtjen e deklaratës me çdo dëshmitar që do të jetë i aftë të dëshmojë në lidhje me të. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2004 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe rrëzon argumentin e Mbrojtjes së Thaçit se pranimi i deklaratës si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2004 mund të cenojë drejtësinë e procesit.

136. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar e Thaçit dhënë TPNJ-së në maj 2004 ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

(c) Përfundim

137. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se deklaratat e Thaçit si dëshmitar kanë lidhje me lëndën dhe janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

2. Deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Selimit

(a) Parashtrime

138. ZPS-ja kërkon pranimin si prova të këtyre deklaratave ose dëshmimeve si dëshmitar të z. Selimi: (i) intervistës me PSRK-në të datës 27 shtator 2011;³⁶²

³⁶² SITF00009289-00009298 ("deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011").

(ii) intervistës me PSRK-në të datës 3 qershor 2013;³⁶³ (iii) intervistës me PSRK-në të datës 13 tetor 2016;³⁶⁴ (iv) intervistës me PSRK-në të datës 22 maj 2018;³⁶⁵ (v) dëshmisë në gjykimin e PSRK-së të datës 15 janar 2018;³⁶⁶ (vi) deklaratës për TPNJ-në të datës 2 prill 2004;³⁶⁷ dhe (vii) dëshmisë në gjykimin e TPNJ-së të dhënë në datat 27-31 maj 2005 në çështjen gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*,³⁶⁸ dhe provave materiale shoqëruese³⁶⁹ (“deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Selimit”).³⁷⁰ ZPS-ja parashtrohet se, për arsye të paraqitura më lart,³⁷¹ deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Selimit janë autentike, kanë lidhje me lëndën dhe kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.³⁷²

139. Mbrojtja e Selimit kundërshton pranimin e deklaratave dhe dëshmimeve si dëshmitar të Selimit, duke theksuar se z. Selimi nuk u njoftua në asnjë moment se ishte i dyshuar.³⁷³ Mbrojtja e Selimit parashtrohet se deklaratat si dëshmitar që i janë dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme duhet të pranohen vetëm nëse atij iu bënë paralajmërimet që i duhen bërë një personi të dyshuar para se të vazhdohej me intervistën.³⁷⁴ Mbrojtja e Selimit argumenton se kjo nuk u bë në asnjë prej deklaratave dhe dëshmimeve si dëshmitar të Selimit, pasi: (i) gjatë intervistës së 27 shtatorit 2011 me PSRK-në, z. Selimi nuk u informua për të drejtën për të pasur avokat apo për të drejtën për të heshtur, dhe atij iu dhanë udhëzime të paqarta

³⁶³ SITF00371392-00371396 (“deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2013”).

³⁶⁴ SPOE00067168-SPOE00067174-ET (“deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në tetor 2016”).

³⁶⁵ SPOE00213583-SPOE00213586 (“deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në maj 2018”).

³⁶⁶ SPOE00068075-SPOE00068087-ET (“dëshmia e janarit 2018 në procesin gjyqësor të PSRK-së”).

³⁶⁷ T000-2344-T000-2345 (“deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në prill 2004”).

³⁶⁸ IT-03-66 T6583-T6589; IT-03-66 T6590-T6679; IT-03-66 T6680-T6699; IT-03-66 20050527; IT-03-66 20050530 Pjesët 1-3; IT-03-66 20050531 (“dëshmia e majit 2005 në procesin gjyqësor të TPNJ-së”).

³⁶⁹ IT-03-66 P1.7; IT-03-66 P24; IT-03-66 P248.

³⁷⁰ Kërkesa, para. 45-57, 64-66, 76-77, 82-83. *Shih gjithashtu* Shtojcën e Kërkesës, materialet 14-17, 20, 23, 25-26.

³⁷¹ *Shih më lart* para. 123.

³⁷² Kërkesa, para. 110-116.

³⁷³ Përgjigjja e Selimit, para. 49.

³⁷⁴ Përgjigjja e Selimit, para. 50-53 që i referohen ICTY, [Halilović Trial Decision](#), para. 21; *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-T, Trial Chamber III, Decision on the Admission into Evidence of Slobodan Praljak's Evidence in the Case of Naletelic and Marinovic (“[Prlić et al. Trial Decision](#)”), 5 September 2007, para. 22.

lidhur me të drejtën për të mos iu përgjigjur pyetjeve;³⁷⁵ (ii) gjatë intervistave të PSRK-së të 3 qershorit 2013, 13 tetorit 2016 dhe 22 majit 2018, z. Selimi u informua për të drejtën për të pasur mbrojtës, por iu tha se e drejta për mbrojtës ishte relevante vetëm nëse ai besonte se i duhej ndihma e mbrojtësit për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe ai u informua gjithashtu për detyrimin për të dhënë dëshmi;³⁷⁶ (iii) gjatë dhënies së deklaratës së TPNJ-së të 2 prillit 2004, megjithëse mbrojtësi i tij ishte i pranishëm, z. Selimi nuk u informua për të drejtën për të heshtur apo për të drejtën për mbrojtës;³⁷⁷ dhe (iv) gjatë dëshmisë së datës 15 janar 2018 në Gjykatën Themelore të Gjakovës dhe dëshmisë në TPNJ më 27, 30-31 maj 2005, z. Selimi nuk u njoftua për të drejtën për mbrojtës dhe të drejtën për të heshtur.³⁷⁸

(b) Vlerësimi i Trupit Gjykues

i. Deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë PSRK-së në shtator 2011

140. Trupi Gjykues vëren se, në deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011, z. Selimi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) strukturën e UÇK-së;³⁷⁹ (ii) rolin e tij dhe rolet e të tjerëve në UÇK;³⁸⁰ (iii) kodin e tij "10" të radiolidhjes;³⁸¹ (iv) zonat operative dhe bazat e UÇK-së;³⁸² (v) operacionin "Shigjeta";³⁸³ (vi) raportet e tij me Sylejman Selimin dhe Agim Çekun;³⁸⁴ dhe (vii) vendndodhjen e tij dhe vendndodhjen e udhëheqësve të tjerë të UÇK-së.³⁸⁵ Trupi Gjykues gjithashtu vëren se Mbrojtja e

³⁷⁵ Përgjigjja e Selimit, para. 54.

³⁷⁶ Përgjigjja e Selimit, para. 55.

³⁷⁷ Përgjigjja e Selimit, para. 56.

³⁷⁸ Përgjigjja e Selimit, para. 57.

³⁷⁹ SITF00009289-00009298, f. 2-3.

³⁸⁰ SITF00009289-00009298, f. 2-3.

³⁸¹ SITF00009289-00009298, f. 1.

³⁸² SITF00009289-00009298, f. 3-5.

³⁸³ SITF00371392-00371396, f. 4.

³⁸⁴ SITF00009289-00009298, f. 3-4.

³⁸⁵ SITF00009289-00009298, f. 2-5.

Selimit nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës si dëshmitar të Selimit dhënë PSRK-së në shtator 2011. Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

141. Trupi Gjykses vëren se, para marrjes në pyetje, prokurori publik e informoi z. Selimi për detyrimin për të thënë të vërtetën dhe se nuk kishte nevojë t'u përgjigjej pyetjeve konkrete "kur ka gjasa se me këtë [ai] e vë veten ose ndonjë të afërm të ngushtë para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale", dhe z. Selimi deklaroi se i kishte kuptuar të drejtat e tij.³⁸⁶ Trupin Gjykses nuk e bind argumenti i Mbrojtjes së Selimit deklaratat si dëshmitar që i janë dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme duhet të pranohen vetëm nëse atij iu bënë paralajmërimet që i duhen bërë një personi të dyshuar para se të vazhdohej me intervistën.³⁸⁷ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklarate dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një dëshmitar që nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t'i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.³⁸⁸ Trupi Gjykses është bindur se nuk ka tregues se PSRK-ja veproi në mënyrë të pandershme ose të paarsyeshme kur e trajtoi z. Selimi si dëshmitar dhe jo si të dyshuar. Trupi Gjykses është i mendimit se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011 ka datë dhe është nënshkruar nga prokurori publik i PSRK-së, procesmbajtësja, përkthyesi, hetuesi dhe z. Selimi.³⁸⁹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së

³⁸⁶ SITF00009289-00009298, f. 1. *Shih gjithashtu* Nenin 162 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës të miratuar nga UNMIK-u në vitin 2003.

³⁸⁷ Përgjigjja e Selimit, para. 50-53.

³⁸⁸ *Shih më lart* para. 129.

³⁸⁹ SITF00009289-00009298, f. 1, 5.

në shtator 2011, është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011 dhe/ose të verifikojë cilindo aspekt të deklaratës që e konteston. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

142. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues konstaton se deklarata e Selimit si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

ii. Deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë PSRK-së në qershor 2013

143. Trupi Gjykues vëren se, në deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2013, z. Selimi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) rolet dhe veprimtaritë e tij në UÇK;³⁹⁰ (ii) lëvizjet e tij brenda Kosovës;³⁹¹ (iii) policinë ushtarake;³⁹² (iv) lidhjet e tij me Sylejman Selimin dhe Sabit Gecin;³⁹³ dhe (v) zonat operative të UÇK-së.³⁹⁴ Trupi Gjykues gjithashtu vëren se Mbrojtja e Selimit nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës që Selimi i dha si dëshmitar PSRK-së në qershor 2013. Trupi Gjykues është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2013 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

144. Trupi Gjykues vëren se, para fillimit të intervistës, z. Selimi: (i) u informua për të drejtat dhe detyrimet e tij sipas nenit 125 të KPPK-së, përfshirë të drejtën

³⁹⁰ SITF00371392-00371396, f. 2.

³⁹¹ SITF00371392-00371396, f. 2-5.

³⁹² SITF00371392-00371396, f. 3.

³⁹³ SITF00371392-00371396, f. 3-5.

³⁹⁴ SITF00371392-00371396, f. 2-5.

për të mos inkriminuar veten; (ii) konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat dhe detyrimet e tij; dhe (iii) theksoi se nuk dëshironte të ushtronte të drejtën që të përjashtohet nga detyrimi për të dëshmuar për shkak të lidhjes familjare me një prej të akuzuarve, Sylejman Selimin.³⁹⁵ Trupi Gjykses është i mendimit se z. Selimi hoqi dorë shprehimisht nga e drejta për të heshtur, sepse ai u informua dhe paralajmërua në mënyrën e duhur për këtë të drejtë para fillimit të intervistës. Trupin Gjykses nuk e bind argumenti i Mbrojtjes së Selimit se deklarata që i është dhënë si dëshmitar autoriteteve hetimore të mëparshme mund të pranohet si provë në një proces penal të mëvonshëm vetëm nëse personit iu bënë paralajmërimet që i duhen bërë një të dyshuari para se dëshmitari të jepte dëshmi.³⁹⁶ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklarate dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një dëshmitar që nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t'i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.³⁹⁷ Kjo do të kërkonte faktikisht njëfarë shikimi retrospektiv në pikëpamjet e palëve të treta, që nuk mund të pritët prej autoriteteve hetimore. Ato mund të veprojnë vetëm mbi bazën e informacionit që zotërojnë dhe Trupi Gjykses nuk do të përpiqet të hamendësojë për pikëpamjet e tyre, kur nuk ka tregues se autoritetet hetimore vepruan në mënyrë të pandershme ose të paarsyeshme në atë rast. Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2013 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2013 ka datë dhe është nënshkruar nga prokurori publik i PSRK-së, procesmbajtësja, përkthyesi

³⁹⁵ SITF00371392-00371396, f. 2.

³⁹⁶ Përgjigjja e Selimit, para. 50-53, 55.

³⁹⁷ *Shih më lart* para. 129.

dhe z. Selimi.³⁹⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2013, është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2013, të cilën Trupi Gjykses do ta vlerësojë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2013 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

145. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2013, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

iii. Deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë PSRK-së në tetor 2016

146. Trupi Gjykses vëren se, në deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në tetor 2016, z. Selimi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) strukturën e UÇK-së dhe zonat operative të saj;³⁹⁹ (ii) rolet dhe detyrat në kuadër të UÇK-së, përfshirë ato si shef i Drejtorisë Operative;⁴⁰⁰ (iii) Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së dhe gjykatën ushtarake të saj;⁴⁰¹ (iv) rolet e udhëheqësve të tjerë të UÇK-së;⁴⁰² (v) lidhjet e tij me Fatmir Limajn dhe Bislim Zyrapin;⁴⁰³ dhe (vi) çfarë dinte për vrasjet e Ramiz Hoxhës dhe Selman Binishit.⁴⁰⁴ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Selimit nuk

³⁹⁸ SITF00371392-00371396, f. 1, 5.

³⁹⁹ SPOE00067168-SPOE00067174-ET, f. 3-4.

⁴⁰⁰ SPOE00067168-SPOE00067174-ET, f. 2-7.

⁴⁰¹ SPOE00067168-SPOE00067174-ET, f. 3-6.

⁴⁰² SPOE00067168-SPOE00067174-ET, f. 3-7.

⁴⁰³ SPOE00067168-SPOE00067174-ET, f. 4-5.

⁴⁰⁴ SPOE00067168-SPOE00067174-ET, f. 5-6.

kundërshtoi relevancën e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në tetor 2016. Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në tetor 2016 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

147. Trupi Gjykses vëren se, para fillimit të intervistës, z. Selimi u informua për të drejtat dhe detyrimet e tij sipas neneve 125 dhe 129 të KPPK-së dhe se “si dëshmitar nuk ka detyrimin t’u përgjigjet pyetjeve konkrete kur ka gjasa se me këtë e vë veten ose ndonjë të afërm të ngushtë para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale”, dhe konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat dhe detyrimet e tij si dëshmitar.⁴⁰⁵ Trupin Gjykses nuk e bind argumenti i Mbrojtjes së Selimit se një deklaratë si dëshmitar dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme mund të pranohet si provë në një proces penal të mëvonshëm vetëm nëse personit iu bënë paralajmërimet që duhet t’i bëhen një të dyshuari, para se dëshmitari të japë dëshmi.⁴⁰⁶ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklarate dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një dëshmitar që nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t’i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.⁴⁰⁷ Trupi Gjykses është i mendimit se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në tetor 2016 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në tetor 2016 ka datë dhe është nënshkruar nga prokurori publik i PSRK-së, procesmbajtësja dhe z. Selimi.⁴⁰⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në tetor 2016 është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja do të ketë

⁴⁰⁵ SPOE00067168-SPOE00067174-ET, f. 2.

⁴⁰⁶ Përgjigjja e Selimit, para. 50-53.

⁴⁰⁷ *Shih më lart* para. 129.

⁴⁰⁸ SPOE00067168-SPOE00067174-ET, f. 1-7.

mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në tetor 2016, të cilën Trupi Gjykses më pas do ta vlerësojë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në tetor 2016 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

148. Për arsytet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë PSRK-së në tetor 2016, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

iv. Deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë PSRK-së në maj 2018

149. Trupi Gjykses vëren se, në deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në maj 2018, z. Selimi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) lidhjet e tij me Ramiz Lladrovcin;⁴⁰⁹ (ii) nëse kishte dijeni për letrat që Ramiz Lladrovci i kishte dërguar të akuzuarit Hashim Thaçi;⁴¹⁰ (iii) miqësinë e tij me Fehmi Lladrovcin deri në vdekjen e tij në shtator 1998;⁴¹¹ (iv) nëse e njohte viktimën e kësaj çështjeje;⁴¹² dhe (v) mohimin se kishte dijeni për vendndodhjen e viktimës.⁴¹³ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Selimit nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në maj 2018. Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në maj 2018 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

150. Trupi Gjykses vëren se para fillimit të intervistës, z. Selimi u informua për të drejtat dhe detyrimet e tij sipas neneve 125 dhe 129 të KPPK-së dhe se “si

⁴⁰⁹ SPOE00213583-SPOE00213586-ET, f. 3-4.

⁴¹⁰ SPOE00213583-SPOE00213586-ET, f. 3.

⁴¹¹ SPOE00213583-SPOE00213586-ET, f. 3.

⁴¹² SPOE00213583-SPOE00213586-ET, f. 2-3.

⁴¹³ SPOE00213583-SPOE00213586-ET, f. 2-3.

dëshmitar nuk ka detyrimin t'u përgjigjet pyetjeve konkrete kur ka gjasa se me këtë e vë veten ose ndonjë të afërm të ngushtë para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale", dhe ai konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat dhe detyrimet e tij si dëshmitar.⁴¹⁴ Trupin Gjykses nuk e bind argumenti i Mbrojtjes së Selimit se një deklaratë dhënë si dëshmitar autoriteteve hetimore të mëparshme në një proces penal të mëparshëm mund të pranohet si provë në një proces të penal të mëvonshëm vetëm nëse personit iu bënë paralajmërimet që duhet t'i bëhen një të dyshuari para se dëshmitari të jepte dëshmi.⁴¹⁵ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklarate dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një dëshmitar që nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t'i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.⁴¹⁶ Trupi Gjykses është i mendimit se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në maj 2018 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar e majit 2018 për PSRK-në ka datë dhe është nënshkruar nga prokurori i shtetit, procesmbajtësja, dy rreshterët hetues dhe z. Selimi.⁴¹⁷ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në maj 2018 është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në maj 2018, të cilën Trupi Gjykses më pas do ta vlerësojë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlера provuese e

⁴¹⁴ SPOE00213583-SPOE00213586-ET, f. 2.

⁴¹⁵ Përgjigjja e Selimit, para. 50-53.

⁴¹⁶ *Shih më lart* para. 129.

⁴¹⁷ SPOE00213583-SPOE00213586-ET, f. 1-4.

deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në maj 2018 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

151. Për arsytet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë PSRK-së në maj 2018, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

v. Dëshmia e Selimit e janarit 2018 në gjykimin e PSRK-së

152. Trupi Gjykses vëren se, në janar 2018, në gjykimin e PSRK-së, z. Selimi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) rolin dhe detyrat e tij në kuadër të UÇK-së, veçanërisht si shef i Degës Operative;⁴¹⁸ (ii) zonat operative të UÇK-së;⁴¹⁹ (iii) strukturimin dhe riorganizimin e njësive të UÇK-së;⁴²⁰ (iv) rolin e anëtarëve dhe udhëheqësve të tjerë të UÇK-së;⁴²¹ (v) funksionet e Shtabit të Përgjithshëm;⁴²² (vi) policinë ushtarake të UÇK-së;⁴²³ (vii) çfarë dinte në lidhje me pretendimet për vrasjet e Selman Binishit dhe Ramiz Hoxhës;⁴²⁴ dhe (vi) arrestimin e dy anëtarëve të LDK-së.⁴²⁵ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Selimit nuk kundërshtoi relevancën e dëshmisë së tij të janarit 2018 në gjykimin e PSRK-së. Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e janarit 2018 në gjykimin e PSRK-së ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

153. Trupi Gjykses vëren se, para fillimit të intervistës, z. Selimi “u informua nga gjykata se ka detyrimin të tregojë të vërtetën dhe se dhënia e dëshmisë së rreme

⁴¹⁸ SPOE00068075-SPOE00068087-ET, f. 2.

⁴¹⁹ SPOE00068075-SPOE00068087-ET, f. 2.

⁴²⁰ SPOE00068075-SPOE00068087-ET, f. 2-3.

⁴²¹ SPOE00068075-SPOE00068087-ET, f. 6, 9.

⁴²² SPOE00068075-SPOE00068087-ET, f. 2, 5.

⁴²³ SPOE00068075-SPOE00068087-ET, f. 12.

⁴²⁴ SPOE00068075-SPOE00068087-ET, f. 7.

⁴²⁵ SPOE00068075-SPOE00068087-ET, f. 2-7, 11.

përbën vepër penale, se mund të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve nëse beson se me këtë mund ta vinte veten ose një të afërm të ngushtë të tij para një turpi të rëndë, dëmi të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale.”⁴²⁶ Trupin Gjykues nuk e bind argumenti i Mbrojtjes së Selimit se një deklaratë që u ishte dhënë si dëshmitar autoriteteve hetimore të mëparshme në një proces penal të mëparshëm mund të pranohet si provë në kuadër të një procesi të penal të mëvonshëm vetëm në qoftë se personit i ishin bërë paralajmërimet e nevojshme që i bëhen një të dyshuari, para se të jepte dëshmi.⁴²⁷ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklarate dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një dëshmitar që nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t'i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.⁴²⁸ Trupi Gjykues është i mendimit se dëshmia e janarit 2018 në gjykimin e PSRK-së u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se dëshmia e janarit 2018 në gjykimin e PSRK-së ka datë dhe përbëhet nga transkriptet e seancave të mbajtura në procesin penal para Gjykatës Themelore në Gjakovë.⁴²⁹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se dëshmia e janarit 2018 në gjykimin e PSRK-së është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykues vë në dukje se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar dëshminë e janarit 2018 në gjykimin e PSRK-së, të cilën Trupi Gjykues më pas do ta vlerësojë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se vlера provuese e dëshmisë së janarit 2018 në gjykimin e PSRK-së nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

⁴²⁶ SPOE00068075-SPOE00068087-ET, f. 2.

⁴²⁷ Përgjigjja e Selimit, para. 50-53.

⁴²⁸ *Shih më lart* para. 129.

⁴²⁹ SPOE00068075-SPOE00068087-ET, f. 1-13.

154. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e Selimit e janarit 2018 në gjykimin e PSRK-së ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

vi. Deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë TPNJ-së në prill 2004

155. Trupi Gjykses vëren se, në deklaratën e tij si dëshmitar dhënë TPNJ-së në prill 2004, z. Selimi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) ngjarjet që lidhen me konfliktin në Kosovë;⁴³⁰ (ii) rolin e tij në UÇK;⁴³¹ (iii) rekrutimin prej tij të anëtarëve të tjerë të UÇK-së;⁴³² (iv) strukturën, sistemin e komunikimit dhe zonat operative të UÇK-së;⁴³³ (v) Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së;⁴³⁴ (vi) rolet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Bislim Zyrapit, Lahi Brahimajt, Ramë Bujës, Azem Sylës, Agim Çekut, Sylejman Selimit, Fatmir Limajt, Shukri Bujës dhe Haxhi Shalës;⁴³⁵ (vii) vendet e ndalimit që përdorte UÇK-ja dhe dijeninë e z. Selimi për to;⁴³⁶ dhe (viii) udhëtimet e tij brenda Kosovës.⁴³⁷ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Selimit nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës së Selimit si dëshmitar dhënë TPNJ-së në prill 2004. Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në prill 2004 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

⁴³⁰ T000-2344-T000-2345, f. 2-8.

⁴³¹ T000-2344-T000-2345, f. 2, 30-31, 36.

⁴³² T000-2344-T000-2345, f. 12, 24.

⁴³³ T000-2344-T000-2345, p. 5, 14-15, 17-22, 26, 35, 38-43.

⁴³⁴ T000-2344-T000-2345, f. 49-53.

⁴³⁵ T000-2344-T000-2345, f. 50-53, 86-96.

⁴³⁶ T000-2344-T000-2345, f. 81-86.

⁴³⁷ T000-2344-T000-2345, f. 27.

156. Trupi Gjykses vëren se z. Selimi: (i) u informua se po intervistohet si dëshmitar;⁴³⁸ (ii) kishte të pranishëm përfaqësuesin e vet ligjor;⁴³⁹ dhe (iii) në fund të intervistës u pyet nëse donte t'i shtonte ndonjë gjë deklaratës së tij, që ai e refuzoi.⁴⁴⁰ Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklarate dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një dëshmitar që nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t'i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.⁴⁴¹ Trupi Gjykses konstaton se nuk ka tregues se prokurori i TPNJ-së veproi në mënyrë të pandershme apo të paarsyeshme kur vendosi ta trajtonte z. Selimi si dëshmitar e jo si të dyshuar në ato rrethana. Trupi Gjykses është i mendimit se deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në prill 2004 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në prill 2004 ka datë dhe përbëhet nga një kopje e vërtetuar e transkriptit të intervistës me TPNJ-në të incizuar në audio, të zhvilluar nga Zyra e Prokurorit të Mekanizmit Përmbysës Ndërkombëtar për Tribunalët Penalë ("MPNTP").⁴⁴² Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar e prillit 2004 për TPNJ-në është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar deklaratën si dëshmitar dhënë TPNJ-së në prill 2004, të cilën Trupi Gjykses më pas do ta vlerësojë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë TPNJ-së në prill 2004 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

⁴³⁸ T000-2344-T000-2345, f. 1, 3. *Shih gjithashtu* IT-03-66 T6680-T6699, f. 7.

⁴³⁹ T000-2344-T000-2345, f. 1-2.

⁴⁴⁰ T000-2344-T000-2345, f. 98-99.

⁴⁴¹ *Shih më lart* para. 129.

⁴⁴² T000-2344-T000-2345, f. 1, 99.

157. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar e Selimit dhënë TPNJ-së në prill 2004 ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

vii. Dëshmia e Selimit e majit 2005 në gjykimin e TPNJ-së

158. Trupi Gjykses vëren se, në maj 2005 në gjykimin e TPNJ-së, z. Selimi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) ngjarje që lidhen me konfliktin në Kosovë;⁴⁴³ (ii) rolin dhe detyrat e tij në kuadër të UÇK-së;⁴⁴⁴ (iii) strukturën e UÇK-së dhe zonat operative të saj, veçanërisht në zonën operative të Drenicës, dhe formimin e brigadave;⁴⁴⁵ (iv) Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së;⁴⁴⁶ (v) lidhjet e tij me anëtarë të tjerë të UÇK-së, në veçanti me Fatmir Limajn, Sylejman Selimin dhe Xhavit Halitin;⁴⁴⁷ dhe (vi) ndalimet e kryera nga UÇK-ja.⁴⁴⁸ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Selimit nuk kundërshtoi relevancën e dëshmisë së tij të majit 2005 në gjykimin e TPNJ-së. Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e majit 2005 në gjykimin e TPNJ-së ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

159. Trupi Gjykses vëren se, para se të fillonte dhënien e dëshmisë, z. Selimi iu kërkua të lexonte me zë betimin e shtypur në kartelën që iu dha dhe, pas kësaj, deklaroi solemnisht se “do të thoshte të vërtetën, gjithë të vërtetën dhe asgjë tjetër përveç së vërtetës”.⁴⁴⁹ Trupi Gjykses vëren se z. Selimi nuk u informua shprehimisht se kishte të drejtën për mbrojtës ose se gëzonte të drejtën për të mos

⁴⁴³ IT-03-66 T6590-T6679, f. 2-6, 42.

⁴⁴⁴ IT-03-66 T6583-T6589, f. 3; IT-03-66 T6590-T6679, f. 6-7.

⁴⁴⁵ IT-03-66 T6590-T6679, f. 2-3, 6, 12-13; 60-64, 84-86; IT-03-66 T6680-T6699, f. 8-9, 12.

⁴⁴⁶ IT-03-66 T6583-T6589, f. 2, 6; IT-03-66 T6590-T6679, f. 6; IT-03-66 T6680-T6699, f. 8.

⁴⁴⁷ IT-03-66 T6583-T6589, f. 2, 4; IT-03-66 T6590-T6679, f. 2; IT-03-66 T6680-T6699, f. 2-3, 14-16.

⁴⁴⁸ IT-03-66 T6590-T6679, f. 43.

⁴⁴⁹ IT-03-66 T6583-T6589, f. 1.

inkriminuar veten. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e tij të mëhershëm në lidhje me tërësinë e paralajmërimeve që duhet t'i bëhen një të dyshuari, e të cilat nuk janë të zbatueshme në të njëjtën mënyrë për individin që pyetet si dëshmitar.⁴⁵⁰ Trupi Gjykses vëren se, sipas kornizës ligjore të TPNJ-së, as prokurori i TPNJ-së dhe as vetë Tribunali nuk kishin detyrimin ta informonin z. Selimi për të drejtën e mosinkriminimit të vetes.⁴⁵¹ Në vend të kësaj, rregulla 90(E) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave e TPNJ-së përcaktonte zbatimin e një procedure të veçantë në qoftë se dhe kur dëshmitari refuzonte t'u përgjigjej pyetjeve me arsyetimin se kjo mund ta inkriminonte. TPNJ-ja ka dhënë këtë shpjegim në lidhje me qëllimin e kësaj dispozite:

Imuniteti nga ndjekja penale, garantuar sipas rregullës 90(E) të Rregullores ndalon në mënyrë të qartë përdorimin e drejtpërdrejtë të mëvonshëm të deklaratave vetinkriminuese që dëshmitari ka qenë i detyruar t'i japë sipas kësaj dispozite, në procese penale përpos atyre që kanë të bëjnë me dëshmi të rreme. Rrjedhimisht, në rastet kur i akuzuari ose apeluesi detyrohen të bëjnë deklaratave vetinkriminuese sipas rregullës 90(E) të Rregullores, prokurorisë i ndalohet të mbështetet drejtpërdrejt në ato deklaratave në çështjen gjyqësore të vetë të akuzuarit ose apeluesit.⁴⁵²

Gjithashtu, TPNJ-ja ka bërë të qartë se kjo dispozitë nuk kishte, dhe as nuk synonte të kishte, efekt jashtë juridiksionit përkatës.⁴⁵³ Garancitë kundër vetinkriminimit të dëshmitarit sipas rregullës 90(E), vlenin vetëm *para* TPNJ-së dhe nuk ishin të detyrueshme të zbatoheshin prej autoriteteve shtetërore.⁴⁵⁴ Më fjalë të tjera, paralajmërimet lidhur me vetinkriminimin të bëra në TPNJ, në të gjitha rastet, kishin efekt vetëm në atë gjykatë. Duke përdorur të njëjtën logjikë në kah të kundërt, TPNJ-ja bëri gjithashtu të qartë se një dëshmi e marrë me detyrim në një

⁴⁵⁰ *Shih më lart* para. 129.

⁴⁵¹ *Shih* rregullën 90(E) të RRPP-së së TPNJ-së, krahasuar *p.sh.* me fjalinë e dytë të rregullës 151(1).

⁴⁵² ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-AR73.11, Appeals Chamber, [Decision on Appeal against the Decision on the Accused's Motion to Subpoena Zdravko Tolimir](#), 13 November 2013, para. 43.

⁴⁵³ *Shih p.sh. Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-T, Decision on Prosecution Motion for an Advance Ruling on the Scope of Permissible Cross Examination ("[Perišić Decision](#)"), 12 June 2009, para. 21.

⁴⁵⁴ *Shih p.sh. Perišić Decision*, para. 21.

gjykatë shtetërore, nuk e bënte atë patjetër të papranueshme në TPNJ (ose në një gjykatë tjetër vendore) për këtë arsye.⁴⁵⁵

160. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses ka mbajtur parasysh jurisprudencën së cilës i është referuar Mbrojtja e Selimit dhe Mbrojtja e Krasniqit në Përgjigjet e tyre.⁴⁵⁶ Trupi Gjykses nuk është bindur se vendimet në çështjen gjyqësore *Halilović* dhe *Prlić dhe të tjerët*, të cilave u referohet Mbrojtja e Krasniqit dhe Selimit, përbëjnë precedentë që kanë zbatim në zgjidhjen e kësaj pike. Së pari, dhomat gjyqësore në fjalë morën në shqyrtim deklaratat ose dëshmi të mëhershme që buronin nga i njëjti institucion (TPNJ), të cilat u kërkuan të pranoheshin si prova. Transkripti i dëshmisë së Slobodan Praljakut, që ai kishte dhënë si dëshmitar i Mbrojtjes në çështjen gjyqësore *Naletilić*, u paraqit kundër tij në gjykimin *Prlić dhe të tjerët*; procesverbali i intervistës që z. Halilović i dha prokurorit të TPNJ-së më pas u paraqit po nga ai prokuror në procesin kundër tij. Rrjedhimisht, në të dy rastet, pala që kërkoi pranimin e tyre kishte qenë në gjendje të garantonte të drejtat e personit në deklaratat e të cilit kërkonte të mbështetej. Kjo është në përputhje me jurisprudencën e TPNJ-së të përshkruar më lart, që e bën të qartë se mbrojtja kundër mosinkriminimit të vetes, e garantuar me Rregulloren e TPNJ-së, vlen dhe ka efekt vetëm në atë gjykatë. Edhe vetëm nga ky këndvështrim, çështja aktuale është krejtësisht e ndryshme. Deklaratat, pranimi i të cilave kundërshtohet, u paraqitën në TPNJ, d.m.th. në një juridiksion gjyqësor tjetër, jo në DHSK apo nga ZPS-ja. ZPS-ja nuk u përfshi në krijimin e këtyre dokumenteve dhe nuk mund të kishte asnjë lloj ndikimi në mbrojtjen e të drejtave të personave në fjalë. Së dyti, këto çështje janë gjithashtu materialisht të ndryshme. Në çështjen *Halilović*,

⁴⁵⁵ ICTY, *Prosecutor v. Mladić*, IT-09-92-R75bis.1, Trial Chamber I, [Second Decision on Request for Assistance from the Court of Bosnia and Herzegovina Pursuant to Rule 75 bis](#), 21 December 2011, para. 10.

⁴⁵⁶ Përgjigjja e Selimit, para. 50-51, që i referohen ICTY, [Halilović Trial Decision](#), para. 21; [Prlić et al. Trial Decision](#), paras 20-22. Përgjigjja e Krasniqit, para. 25, që i referohet ICTY, *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-AR73.2, Appeals Chamber, Decision on Interlocutory Appeal Concerning Admission of Record of Interview of the Accused from the Bar Table ("[Halilović Appeal Decision](#)"), 19 August 2005, para. 15; [Prlić et al. Trial Decision](#), para. 14.

procesverballi i intervistës që kundërshtohet u dha në kohën kur z. Halilović ishte nën akuzë nga Zyra e Prokurorit të TPNJ-së dhe mbahej në paraburgim nga TPNJ-ja. Këto rrethana nuk ekzistojnë në çështjen aktuale. Gjithashtu, duhet theksuar se Dhoma e Apelit e TPNJ-së shfuqizoi vendimin e Dhomës Gjyqësore për pranimin e procesverballit të intervistës që z. Halilović i dha prokurorit të TPNJ-së bazuar në rrethana që nuk kanë lidhje me çështjen aktuale, konkretisht: ekzistenca e nxitjes për të akuzuarin dhe premtimit të prokurorit për “marrëveshje” me të, si dhe mungesa efektshmërisë së mbrojtësit që e kishte përfaqësuar z. Halilović gjatë atyre intervistave.⁴⁵⁷ Sa i takon rastit të z. Praljak, ai u thirr nga Mbrojtja për të dëshmuar në çështjen *Naletiliq dhe Martinović* dhe u mor në pyetje nga prokurori i TPNJ-së, i cili, për rrjedhojë, mundi të siguronte dëshmi inkriminuese prej tij, të cilën më vonë kërkoi ta paraqiste si provë në kuadër të ndjekjes penale të z. Praljak. Edhe në këtë rast, rrethanat janë materialisht të ndryshme nga çështja aktuale, ku ZPS-ja nuk kishte asnjë rol në marrjen e provave inkriminuese nga të akuzuarit nga deklaratat dhe dokumentet në fjalë. Së fundi, Trupi Gjyqësor vëren se Mbrojtja nuk përmend ndonjë precedent apo parim sipas të cilit Trupi Gjyqësor duhet t’u miratojë të akuzuarve të drejtat për të heshtur dhe/ose për të mos inkriminuar veten, jo vetëm me efekt prapaveprues (sipas vendimit në çështjen *Prliq dhe të tjerët* të përmendur më lart), por edhe me efekt jashtëjurisdiksional. Gjithashtu, Trupi Gjyqësor arrin në përfundimin se TPNJ-ja veprroi në përputhje të plotë me kornizën ligjore të saj dhe se nuk ka asnjë tregues se, duke bërë këtë, shkeli të drejtat themelore të personave në fjalë.⁴⁵⁸ Faktikisht, dokumentacioni sugjeron se të gjitha

⁴⁵⁷ [Halilović Appeal Decision](#), me të cilin u rrëzua vendimi: ICTY, *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-T, Trial Chamber, [Decision on Admission into Evidence of Interview of the Accused](#), 20 June 2005.

⁴⁵⁸ ICTY, *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-T, Trial Chamber II, [Decision on Motion to Set Aside Confidential Subpoena to give Evidence](#), 7 June 2002, para. 31; *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-T, Trial Chamber II, [Order on the Standards Governing the Admission of Evidence](#), 15 February 2002, para. 9. *Shih gjithashtu* International Criminal Tribunal for Rwanda (“ICTR”), *Prosecutor v. Bizimungu et al.*, ICTR-99-50-T, Trial Chamber II, [Decision on Prosper Muginarez’s Second Motion to Dismiss Indictment for Violation of Right to Trial Without Undue Delay – Articles 19 and 20\(4\)\(c\) of the Statute of the Tribunal](#), 29 May 2007, paras 19-21; Special Tribunal for Lebanon (“STL”), *In the matter of El Sayed*, CH/PTH/2010/005, Pre-Trial Judge, [Order Relating to the Jurisdiction of the Tribunal to Rule on the](#)

deklaratat që të akuzuarit i dhanë TPNJ-së, u dhanë lirisht dhe në mënyrë vullnetare.

161. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e majit 2005 në gjykimin e TPNJ-së u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe, rrjedhimisht, u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se, si dëshmitar, z. Selimi kishte të drejtën të kundërshtonte të jepte çfarëdo deklarate me të cilën mund të vetinkriminohej, sipas rregullës 90(E) të Rregullores së TPNJ-së. Ndonëse nuk mund të konsiderohet se përbën heqje dorë prej z. Selimi nga e drejta për të heshtur dhe/ose nga e drejta e mosinkriminimit të vetes në procesin aktual, kjo tregon se çfarëdo shqetësimi që mund të ketë pasur ai në atë kohë për rrezikun e inkriminimit të vetes (nëse ka pasur), nuk ishte i tillë që ta bënte të kërkonte masë ndreqëse nga TPNJ-ja. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se kur iu tregua më pas përmbajtja e dëshmisë së tij, z. Selimi nuk ngriti ndonjë kundërshtim se i ishin shkelur të drejtat.⁴⁵⁹ Gjithashtu, Trupi Gjykses nuk ka asnjë të dhënë se z. Selimi u ndie nën presion ose i shtrënguar t'u përgjigjej pyetjeve, të cilave përndryshe do të kishte zgjedhur të mos u përgjigjej. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se dëshmia e majit 2005 në gjykimin e TPNJ-së ka datë dhe përbëhet nga transkripti i tri seancave gjyqësore në gjykimin *Limaj dhe të tjerët* në TPNJ.⁴⁶⁰ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e majit 2005 në gjykimin e TPNJ-së është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar dëshminë e majit 2005 në gjykimin e TPNJ-së, të cilën Trupi Gjykses do ta vlerësojë më pas duke mbajtur parasysh tërësinë e provave. Rrjedhimisht,

[Application by Mr El Sayed Dated 17 March 2010 and Whether Mr El Sayed has Standing before the Tribunal](#), 17 September 2010, para. 46.

⁴⁵⁹ Trupi Gjykses thekson se gjatë intervistës së ZPS-së të nëntorit 2019, z. Selimi iu treguan dy pjesë të dëshmisë së tij të majit 2005 në procesin gjyqësor të TPNJ-së (068933-TR-ET Pjesa 8, f. 18 dhe 068933-TR-ET Pjesa 13, f. 11).

⁴⁶⁰ IT-03-66 T6583-T6589; IT-03-66 T6590-T6679; T6680-T6699.

Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e dëshmisë së majit 2005 në gjykimin e TPNJ-së nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

162. Sa u takon provave materiale shoqëruese, Trupi Gjykses vëren se ato iu treguan z. Selimi dhe u diskutuan me njëfarë hollësie gjatë dëshmisë së tij në gjykim.⁴⁶¹ Trupi Gjykses është bindur se ato janë pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e dëshmisë së majit 2005 në gjykimin e TPNJ-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se ato: (i) kanë lidhje me lëndën dhe ofrojnë kontekst relevant për dokumentin me shkrim në të cilin diskutohen; (ii) kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti; dhe (iii) kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

163. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se: (i) dëshmia e majit 2005 e Selimit në gjykimin e TPNJ-së u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; dhe (ii) dëshmia e majit 2005 e Selimit në gjykimin e TPNJ-së dhe provat materiale shoqëruese kanë lidhje me lëndën, janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

(c) Përfundim

164. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se: (i) deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Selimit, u morën në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; dhe (ii) deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Selimit e provat materiale shoqëruese kanë lidhje me lëndën dhe janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

⁴⁶¹ *Shih p.sh.* IT-03-66 T6590-T6679, f. 16-17 (IT-03-66 P1.7), 88-90 (IT-03-66 P24); IT-03-66 T6680-T6699, f. 1-4 (IT-03-66 P248).

3. Dëshmia dhe deklaratat si dëshmitar të Veselit

(a) Parashtrime

165. ZPS-ja kërkon pranimin si prova të këtyre deklaratave dhe dëshmime të mëhershme të z. Veseli si dëshmitar: (i) intervistave të PSRK-së të datave 13 shtator 2010 dhe 3 maj 2011;⁴⁶² (ii) intervistës së PSRK-së të datës 26 shtator 2011;⁴⁶³ (iii) intervistës së PSRK-së të datës 9 korrik 2018;⁴⁶⁴ (iv) dëshmisë së 20 qershorit 2012 para Gjykatës Supreme të Kosovës në gjykimin të EULEX-it;⁴⁶⁵ dhe (v) deklaratës së datës 18 nëntor 2003 dhënë UNMIK-ut⁴⁶⁶ (“dëshmia dhe deklaratat si dëshmitar të Veselit”).⁴⁶⁷ ZPS-ja parashtron se për arsyet e përmendura më lart,⁴⁶⁸ dëshmia dhe deklaratat si dëshmitar të Veselit, janë autentike dhe kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.⁴⁶⁹

166. Mbrojtja e Veselit nuk kundërshton pranimin si prova të deklaratave dhe dëshmisë së Veselit si dëshmitar.⁴⁷⁰

(b) Vlerësimi i Trupit Gjykses

i. Deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë PSRK-së më 2010/2011

167. Trupi Gjykses vëren se në deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në 2010/2011, z. Veseli dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) pozitat e mbajtura prej tij në UÇK dhe në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës (“QPK”);⁴⁷¹ (ii) udhëheqjen prej tij të SHIK-ut,

⁴⁶² SITF00398137-SITF00398157 (“deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së me transkriptet e intervistave të viteve 2010/2011”).

⁴⁶³ SITF00009124-00009133 (“deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011”).

⁴⁶⁴ SPOE00213660-SPOE00213662-ET (“deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018”).

⁴⁶⁵ SITF00398181-00398216 (“dëshmia e qershorit 2012 në procesin gjyqësor të EULEX-it”).

⁴⁶⁶ SITF00253817-00253819 (“deklarata si dëshmitar dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003”).

⁴⁶⁷ Kërkesa, para. 37-44, 62-63, 88-89. *Shih gjithashtu* Shtojcën e Kërkesës, materialet 11-13, 19, 31.

⁴⁶⁸ *Shih më lart* para. 123.

⁴⁶⁹ Kërkesa, para. 110-116.

⁴⁷⁰ Përgjigjja e Veselit, para. 3.

⁴⁷¹ SITF00398137-SITF00398157, f. 2-3.

organizimin dhe rolin e tij në mbledhjen e informatave për “armikun”;⁴⁷² dhe (iii) strategjitë për zbulimin e “bashkëpunëtorëve”.⁴⁷³ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Veselit nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së më 2010/2011. Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së më 2010/2011 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

168. Trupi Gjykses vëren se, para fillimit të intervistës, z. Veseli u informua se ishte aty si dëshmitar, se duhet të tregonte të vërtetën, se nuk kishte nevojë t’u përgjigjej pyetjeve që do ta bënin objekt të ndjekjes penale dhe ai konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat dhe detyrimet e tij.⁴⁷⁴ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së më 2010/2011 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm, dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së më 2010/2011 ka datë dhe përbëhet nga transkriptet e dy intervistave të PSRK-së me z. Veseli.⁴⁷⁵ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e Veselit nuk kundërshtoi autenticitetin apo vlerën provuese të deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së më 2010/2011. Nuk ka asnjë tregues për ndonjë veprim të pandershëm apo të paarsyeshëm nga autoritetet në trajtimin e tij si dëshmitar e jo si i dyshuar në rrethanat e asaj kohe. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së më 2010/2011, është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar cilindo aspekt të deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së më 2010/2011 që e konteston, dhe t’u bëjë pyetje për këto aspekte dëshmitarëve të thirrur prej ZPS-së që mund të dëshmojnë për to. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses

⁴⁷² SITF00398137-SITF00398157, f. 2-4, 6-12.

⁴⁷³ SITF00398137-SITF00398157, f. 10.

⁴⁷⁴ SITF00398137-SITF00398157, f. 1, 2, 5.

⁴⁷⁵ SITF00398137-SITF00398157, f. 1, 5.

konstaton se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së më 2010/2011 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

169. Për arsytet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë PSRK-së më 2010/2011, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

ii. Deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë PSRK-së në shtator 2011

170. Trupi Gjykses vëren se, në deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011, z. Veseli dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) anëtarësinë e tij në UÇK;⁴⁷⁶ (ii) pozitën e tij në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së;⁴⁷⁷ (iii) lëvizjet e tij brenda dhe jashtë Kosovës;⁴⁷⁸ (iv) ndërveprimet me anëtarë të tjerë të UÇK-së, si me Fatmir Limajn dhe Bislim Zyrapin;⁴⁷⁹ (v) operacionin “Shigjeta”;⁴⁸⁰ dhe (vi) ndërveprimet mes Fatmir Limajt, Azem Sylës, Jakup Krasniqit, Hashim Thaçit, Xhavit Halitit, Bislim Zyrapit, Agim Çekut dhe Ramë Bujës.⁴⁸¹ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Veselit nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011. Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

171. Trupi Gjykses vëren se para fillimit të intervistës, z. Veseli u informua se ishte aty si dëshmitar, se duhej të tregonte të vërtetën, se nuk kishte nevojë t’u përgjigjej pyetjeve që do ta bënin objekt të ndjekjes penale dhe ai konfirmoi se i kishte

⁴⁷⁶ SITF00009124-00009133, f. 2.

⁴⁷⁷ SITF00009124-00009133, f. 2.

⁴⁷⁸ SITF00009124-00009133, f. 2-5.

⁴⁷⁹ SITF00009124-00009133, f. 3-5.

⁴⁸⁰ SITF00009124-00009133, f. 4.

⁴⁸¹ SITF00009124-00009133, f. 3-5.

kuptuar të drejtat dhe detyrimet e tij.⁴⁸² Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011 ka datë dhe është nënshkruar nga prokurori publik i PSRK-së, procesmbajtësja, përkthyesi dhe z. Veseli.⁴⁸³ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Veselit nuk kundërshtoi autenticitetin apo vlerën provuese të deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011 është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar cilindo aspekt të deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011 që ajo e konteston, si dhe t'u bëjë pyetje në lidhje me to dëshmitarëve të thirrur prej ZPS-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në shtator 2011 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

172. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë PSRK-së në shtator 2011, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

iii. Deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë PSRK-së në korrik 2018

173. Trupi Gjykses vëren se, në deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018, z. Veseli dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me

⁴⁸² SITF00009124-00009133, f. 1.

⁴⁸³ SITF00009124-00009133, f. 1-5.

pretendime, ndër të tjera, për: (i) lidhjen e tij me Fehmi Lladrovcin; (ii) nëse kishte dijeni për tentativën e Ramiz Lladrovcit për të kontaktuar Hashim Thaçin; (iii) nëse e njihte viktimën në këtë çështje; dhe (iv) nëse z. Veseli kishte dijeni për vendndodhjen e viktimës.⁴⁸⁴ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Veselit nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018. Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

174. Trupi Gjykses vëren se para fillimit të intervistës, z. Veseli u informua për të drejtat dhe detyrimet e tij sipas neneve 125 dhe 129 të KPPK-së dhe se “si dëshmitar ai nuk ka detyrimin t’u përgjigjet pyetjeve konkrete kur ka gjasa se me këtë e vë veten ose ndonjë të afërm të ngushtë para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale” dhe konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat e tij.⁴⁸⁵ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018 ka datë dhe është nënshkruar nga prokurori i shtetit, procesmbajtësja, rreshteri hetues dhe z. Veseli.⁴⁸⁶ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Veselit nuk kundërshtoi autenticitetin apo vlerën provuese të deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018, është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë në gjykim cilindo aspekt të deklaratës dhe të paraqesë prova në lidhje me ato

⁴⁸⁴ SPOE00213660-SPOE00213662-ET, f. 2-3.

⁴⁸⁵ SPOE00213660-SPOE00213662-ET, f. 2.

⁴⁸⁶ SPOE00213660-SPOE00213662-ET, f. 1-3.

aspekte. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në korrik 2018 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

175. Për arsytet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë PSRK-së në korrik 2018, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

iv. Dëshmia e Veselit e qershorit 2012 në gjykimin të EULEX-it

176. Trupi Gjykses vëren se në qershor 2012, në gjykimin të EULEX-it, z. Veseli dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) pozitat dhe detyrat e tij në UÇK;⁴⁸⁷ (ii) udhëheqjen prej tij të ZKZ/G2-shit dhe SHIK-ut, si dhe shkallën e organizimit të SHIK-ut dhe rekrutimin e anëtarëve të tij;⁴⁸⁸ dhe (iii) strukturat komanduese në kuadër të UÇK-së.⁴⁸⁹ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Veselit nuk kundërshtoi relevancën e dëshmisë së qershorit 2012 në gjykimin të EULEX-it. Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e qershorit 2012 në gjykimin të EULEX-it ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

177. Trupi Gjykses vëren se, para fillimit të intervistës, z. Veseli u informua për detyrimin për të thënë të vërtetën dhe se nuk kishte nevojë t'u përgjigjej pyetjeve konkrete "kur ka gjasa se me këtë [ai] e vë veten ose ndonjë të afërm të ngushtë para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale", dhe z. Selimi bëri betimin përkatës.⁴⁹⁰ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se dëshmia e qershorit 2012 në gjykimin të EULEX-it u dha vullnetarisht, pa

⁴⁸⁷ SITF00398181-00398216, f. 6.

⁴⁸⁸ SITF00398181-00398216, f. 3-12, 28-31.

⁴⁸⁹ SITF00398181-00398216, f. 9.

⁴⁹⁰ SITF00398181-00398216, f. 3.

shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se dëshmia e qershorit 2012 në gjykimin të EULEX-it ka datë dhe përbëhet nga transkripti i seancës së mbajtur para Gjykatës Supreme të Kosovës në kuadër të procesit gjyqësor të EULEX-it.⁴⁹¹ Trupi Gjykues gjithashtu vëren se Mbrojtja e Veselit nuk kundërshtoi autenticitetin apo vlerën provuese të dëshmisë së qershorit 2012 në gjykimin të EULEX-it. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se dëshmia e qershorit 2012 në gjykimin të EULEX-it, është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë në gjykim cilindo aspekt të dëshmisë dhe të paraqesë prova në lidhje me ato aspekte. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se vlera provuese e dëshmisë së qershorit 2012 në gjykimin të EULEX-it nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

178. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues konstaton se dëshmia e Veselit e qershorit 2012 në gjykimin të EULEX-it, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

v. Deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003

179. Trupi Gjykues vëren se, në deklaratën si dëshmitar dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003, z. Veseli dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) ngjarje në lidhje me konfliktin në Kosovë;⁴⁹² (ii) rolin dhe detyrat e tij në kuadër të UÇK-së;⁴⁹³ (iii) lëvizjet e tij brenda dhe jashtë

⁴⁹¹ SITF00398181-00398216, f. 1-36.

⁴⁹² SITF00253817-00253819, f. 1-3.

⁴⁹³ SITF00253817-00253819, f. 1-2.

Kosovës,⁴⁹⁴ dhe (iv) lidhjen e tij me Sabit Gecin.⁴⁹⁵ Trupi Gjykues gjithashtu vëren se Mbrojtja e Veselit nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës si dëshmitar dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003. Trupi Gjykues është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

180. Trupi Gjykues vëren se para intervistës, z. Veseli u informua se kishte “detyrimin të jepte të dhënat e sakta personale të [tij], me sa ka dijeni” dhe se ishte “i lirë të mos thotë asgjë dhe se gjithçka që [do të thotë] mund dhe do të përdoret si provë”, dhe ai u pajtua me këto.⁴⁹⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues është i mendimit se deklarata si dëshmitar dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003 ka datë dhe është nënshkruar nga hetuesi dhe z. Veseli.⁴⁹⁷ Trupi Gjykues gjithashtu vëren se Mbrojtja e Veselit nuk kundërshtoi autenticitetin apo vlerën provuese të deklaratës si dëshmitar dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se deklarata si dëshmitar dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003, është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të kundërshtojë në gjykim cilindo aspekt të deklaratës dhe të paraqesë prova në lidhje me ato aspekte. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

181. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues konstaton se deklarata si dëshmitar e Veselit dhënë UNMIK-ut në nëntor 2003 ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës

⁴⁹⁴ SITF00253817-00253819, f. 1-2.

⁴⁹⁵ SITF00253817-00253819, f. 2-3.

⁴⁹⁶ SITF00253817-00253819, f. 1.

⁴⁹⁷ SITF00253817-00253819, f. 1-3.

ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

(c) Përfundim

182. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia dhe deklaratat si dëshmitar të Veselit kanë lidhje me lëndën dhe janë në pamje të parë autentike, u morën në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

4. Deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Krasniqit

(a) Parashtrime

183. ZPS-ja kërkon pranimin si prova të këtyre deklaratave dhe dëshmive të mëparshme të z. Krasniqi si dëshmitar: (i) intervistës së PSRK-së të datës 13 qershor 2018;⁴⁹⁸ (ii) dëshmisë së datës 2 shkurt 2018 para Gjykatës Themelore në Gjakovë në gjykimin e PSRK-së;⁴⁹⁹ (iii) deklaratës dhënë TPNJ-së më 23 dhe 24 maj 2007⁵⁰⁰ dhe provave materiale shoqëruese;⁵⁰¹ (iv) dëshmisë që dha nga 10 deri më 15 shkurt 2005 në gjykimin *Limaj dhe të tjerët* në TPNJ,⁵⁰² dhe provave materiale shoqëruese⁵⁰³; (v) dëshmisë që dha nga 29 deri 31 maj 2007 në gjykimin

⁴⁹⁸ SPOE00213595-SPOE00213597-ET ("deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2018").

⁴⁹⁹ SPOE00068088-SPOE00068094-ET ("dëshmia e shkurtit 2018 në procesin gjyqësor të PSRK-së").

⁵⁰⁰ IT-04-84 P00328, f. 1-9 ("deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007").

⁵⁰¹ IT-04-84 P00328, f. 10-94 (provat materiale shoqëruese 1-19).

⁵⁰² IT-03-66 T3285-T3365; IT-03-66 T3366-T3447; IT-03-66 T3448-T3540 (f. 1-46); IT-03-66 10 shkurt 2005 Jakup KRASNIQI Pjesët 1-3; IT-03-66 14 shkurt 2005 Jakup KRASNIQI Pjesët 1-3; IT-03-66 15 shkurt 2005 Jakup KRASNIQI Pjesët 1-2 ("dëshmia e shkurtit 2005 në procesin gjyqësor të TPNJ-së").

⁵⁰³ IT-03-66 P1.5; IT-03-66 P49; IT-03-66 P138; IT-03-66 P139; IT-03-66 P140; IT-03-66 P147; IT-03-66 P148; IT-03-66 P150.

*Haradinaj dhe të tjerët në TPNJ,*⁵⁰⁴ dhe provave materiale shoqëruese⁵⁰⁵ (“deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Krasniqit”).⁵⁰⁶ ZPS-ja parashtron se për arsyet e përmendura më lart,⁵⁰⁷ deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Krasniqit, janë autentike, kanë lidhje me lëndën dhe kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.⁵⁰⁸

184. Mbrojtja e Krasniqit kundërshton pranimin si prova të deklaratave dhe dëshmive si dëshmitar të Krasniqit, mbi bazën se të drejtat e z. Krasniqi nuk ishin mbrojtur mjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, efekti dëmtues i pranimin të tyre zhbën çdo vlerë provuese dhe ato duhet të përjashtohen në bazë të rregullës 138(1)-(2) dhe/ose nenit 55 të Kushtetutës.⁵⁰⁹ Konkretisht, Mbrojtja e Krasniqit parashtron se deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Krasniqit u morën në shkelje të të drejtave të z. Krasniqi dhe duhet të përjashtohen pasi: (i) dëshmia e shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së nuk u dha vullnetarisht, por z. Krasniqi u detyrua me ligj të dëshmonte dhe nuk u informua për të drejtën e mosinkriminimit të vetes, të drejtën për të mos iu përgjigjur pyetjeve dhe të drejtën për të kërkuar përfaqësim juridik;⁵¹⁰ (ii) kur i dha deklaratë TPNJ-së në maj 2007, z. Krasniqi nuk u informua për të drejtën për të kërkuar përfaqësim juridik ose për të drejtën e mosinkriminimit të vetes dhe ai shprehimisht nuk e dha pëlqimin që ajo deklaratë t’u jepej organeve të tjera të rendit dhe ligjit; gjithashtu, deklarata nuk pasqyron fjalë për fjalë gjithë sa u tha;⁵¹¹ (iii) gjatë dëshmisë së majit 2007 në TPNJ, z. Krasniqi nuk u informua për të drejtën për të kërkuar përfaqësim juridik apo për

⁵⁰⁴ IT-04-84bis P00064; IT-04-84bis P00063 Konfidencial; IT-04-84 T5000-T5086 të paredaktuara Pjesët 1-3 Konfidenciale; IT-04-84 T5087-T5185 Pjesët 1-2 Konfidenciale; IT-04-84 29 maj 2007 Jakup KRASNIQI Pjesët 1-2; IT-04-84 30 maj 2007 Jakup KRASNIQI Pjesët 1-3; IT-04-84 31 maj 2007 Jakup KRASNIQI Pjesët 1-2 (“dëshmia e majit 2007 në procesin gjyqësor të TPNJ-së”).

⁵⁰⁵ U003-8552-U003-8690; IT-04-84 D00037.

⁵⁰⁶ Kërkesa, para. 58-61, 67-69, 78-81, 84-87. *Shih gjithashtu* Shtojcën e Kërkesës, materialet 18, 21, 24, 27-30.

⁵⁰⁷ *Shih më lart* para. 123.

⁵⁰⁸ Kërkesa, para. 110-116.

⁵⁰⁹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 27, 37-39.

⁵¹⁰ Përgjigjja e Krasniqit, para. 29-31.

⁵¹¹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 32-34.

të drejtën e mosinkriminimit të vetes;⁵¹² dhe (iv) Mbrojtja konteston autenticitetin e deklaratës dhënë PSRK-së në shkurt 2018, pasi “pajisja e incizimit kishte humbur” dhe deklarata ekziston vetëm si transkript, dhe parashtron se informimi i z. Krasniqi për të drejtën e mosinkriminimit të vetes nuk ishte në përputhje me kriteret e kornizës ligjore të DHS-së dhe dëshmia u dha për aspekte mbi të cilat bazohen tani akuzat kundër z. Krasniqi dhe, për këtë arsye, atij duhej t’i ishin akorduar të drejtat e personit të dyshuar.⁵¹³ Gjithashtu, Mbrojtja e Krasniqit parashtron se intervista e PSRK-së e qershorit 2018 duhet të përjashtohet për shkak të vlerës së ulët provuese, pasi ajo zgjat vetëm 19 minuta, përbëhet nga vetëm shtatë pyetje, përmbajtja e saj nuk kontestohet, është shfajësuese dhe nuk i shton asgjë provave dhe argumenteve të ZPS-së.⁵¹⁴ Mbrojtja e Krasniqit gjithashtu kundërshton pranueshmërinë e një prove materiale shoqëruese – një interviste me z. Krasniqi të publikuar në gazetën “Der Spiegel” më 6 korrik 1998 – me pretendimin se dyshon në saktësinë e dokumentit.⁵¹⁵

185. Mbrojtja e Veselit kundërshton pranimin si provë materiale të një komunikate të botuar më 13 maj 1998 në gazetën “Koha Ditore” – si provë shoqëruese e deklaratës si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007 - me pretendimin se i mungon autenticiteti dhe mbështetshmëria dhe se duhet të paraqitet përmes një dëshmitari që mund të dëshmojë për vërtetësinë e përmbajtjes së saj.⁵¹⁶

186. ZPS-ja kundërpërgjigjet se argumentet e Mbrojtjes së Krasniqit bazohen në pretendimin e gabuar se, në kohën kur u morën këto deklarata, ai duhej të gëzonte të drejtat e një personi të dyshuar, por duke qenë se në atë kohë nuk ishte i dyshuar, nuk i kishte ato të drejta.⁵¹⁷ ZPS-ja parashtron se nuk ka asnjë pengesë për pranimin e deklaratave që u morën në përputhje me të drejtat e z. Krasniqi në

⁵¹² Përgjigjja e Krasniqit, para. 35.

⁵¹³ Përgjigjja e Krasniqit, para. 40-42.

⁵¹⁴ Përgjigjja e Krasniqit, para. 43.

⁵¹⁵ Përgjigjja e Krasniqit, para. 75(i).

⁵¹⁶ Përgjigjja e Veselit, para. 29-30, 35-37, që i referohen IT-04-84 P00328, f. 58-60.

⁵¹⁷ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 3, 6.

atë kohë.⁵¹⁸ ZPS-ja argumenton se, ndonëse deklarata që z. Krasniqi i dha TPNJ-së nuk përmban njohjen e së drejtës për të mos inkriminuar veten si dëshmitar, kjo ishte sepse Rregullorja e Procedurës dhe e Provave e TPNJ-së nuk e kërkonte informimin për këtë të drejtë.⁵¹⁹ ZPS-ja gjithashtu parashtrohet se: (i) z. Krasniqi shpjegoi arsyet për mosparaqitjen vullnetarisht për të dhënë dëshmi në TPNJ në vitin 2005 dhe nuk shprehu shqetësime në lidhje me mosinkriminimin e vetes;⁵²⁰ (ii) z. Krasniqi më pas e konfirmoi dëshminë që dha në TPNJ në vitin 2005;⁵²¹ (iii) argumenti i Mbrojtjes së Krasniqit se deklarata që z. Krasniqi i dha TPNJ-së nuk duhet të pranohet sepse nuk transkripti i saj nuk është bërë fjalë për fjalë, është i pathemeltë;⁵²² dhe (iv) intervistat e PSRK-së të 2 shkurtit 2018 dhe 13 qershorit 2018 duhet të pranohen pasi kanë vlerë provuese dhe z. Krasniqi iu akorduan të drejta të plota në përputhje me statusin e tij si dëshmitar.⁵²³ ZPS-ja gjithashtu argumenton se Mbrojtja e Krasniqit dhe Mbrojtja e Veselit nuk japin arsye të mjaftueshme pse nuk duhen pranuar provat materiale shoqëruese përkatëse.⁵²⁴

(b) Vlerësimi i Trupit Gjykses

i. Deklarata si dëshmitar e Krasniqit dhënë PSRK-së në qershor 2018

187. Trupi Gjykses vëren se, në deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2018, z. Krasniqi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) pozitën e tij në UÇK;⁵²⁵ (ii) Shtabin e

⁵¹⁸ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 3.

⁵¹⁹ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 4-5.

⁵²⁰ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 7.

⁵²¹ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 7.

⁵²² Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 8.

⁵²³ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 9-12.

⁵²⁴ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 15, 21; Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Veselit, para. 7.

⁵²⁵ SPOE00213595-SPOE00213597-ET, f. 2.

Përgjithshëm të UÇK-së;⁵²⁶ (iii) nëse e dinte vendndodhjen e viktimës në atë rast;⁵²⁷ (iv) mohimin prej tij se e dinte vendndodhjen e viktimës;⁵²⁸ dhe (v) dijeninë e tij për kërkesën e Ramiz Lladrovci për një takim me të akuzuarin Hashim Thaçi.⁵²⁹ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Krasniqi nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2018. Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2018 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

188. Trupi Gjykses vëren se para fillimit të intervistës, z. Krasniqi u informua për të drejtat dhe detyrimet e tij sipas neneve 125 dhe 129 të KPPK-së. Në veçanti, ai u informua se: (i) në qoftë se besonte mund të inkriminonte veten me përgjigjet ndaj pyetjeve, mund të refuzonte të përgjigjej; (ii) në qoftë se besonte se i duhej ndihma e një avokati për t'iu përgjigjur pyetjeve, mund të merrte avokat me pagesë dhe të konsultohet me të; dhe (iii) se “si dëshmitar ai nuk ka detyrimin t'iu përgjigjet pyetjeve konkrete kur ka gjasa se me këtë e vë veten ose ndonjë të afërm të ngushtë para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale”.⁵³⁰ Z. Krasniqi konfirmoi se i kishte kuptuar të drejtat e tij.⁵³¹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2018 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses, në përgjigje të parashtrimeve të përgjithshme të Mbrojtjes lidhur me këtë pikë, gjithashtu vëren se e drejta e mosinkriminimit të vetes nuk e përjashton personin nga detyrimi për të dhënë dëshmi në çështje penale, si ushtrim i detyrave të tij qytetare.⁵³² Përkundrazi, kjo i

⁵²⁶ SPOE00213595-SPOE00213597-ET, f. 2-3.

⁵²⁷ SPOE00213595-SPOE00213597-ET, f. 2-3.

⁵²⁸ SPOE00213595-SPOE00213597-ET, f. 2-3.

⁵²⁹ SPOE00213595-SPOE00213597-ET, f. 2-3.

⁵³⁰ SPOE00213595-SPOE00213597-ET, f. 2.

⁵³¹ SPOE00213595-SPOE00213597-ET, f. 2.

⁵³² *Shih p.sh. ECtHR, Voskuil v. the Netherlands*, Application no. 64752/01, [Judgment](#), 22 November 2007, para. 86.

jep personit garanci mbrojtëse ndaj mundësisë që të japë padashur informacion që mund ta inkriminojë. Nuk ka të dhëna se kjo ka ndodhur në kontekstin aktual. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2018 ka datë dhe është nënshkruar nga prokurori i shtetit, procesmbajtësja dhe z. Krasniqi.⁵³³ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Krasniqit nuk kundërshtoi autenticitetin apo vlerën provuese të deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2018. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2018, është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Duke pasur parasysh relevancën e provave të përfshira në deklaratën si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2018, Trupi Gjykses është gjithashtu i bindur se vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2018, nuk cenohet nga fakti që ajo është e shkurtër apo nga përmbajtja shfajësuese e saj. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova në lidhje me cilindo aspekt të diskutuar në këto dokumente që e konteston dhe/ose të paraqesë prova në lidhje me të. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar dhënë PSRK-së në qershor 2018 ka vlerë provuese, që, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit, nuk zhbëhet prej ndonjë efekti dëmtues.

189. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se deklarata si dëshmitar e Krasniqit dhënë PSRK-së në qershor 2018, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

ii. Dëshmia e Krasniqit e shkurtit 2018 në gjykimin e PSRK-së

190. Trupi Gjykses vëren se në dëshminë e tij të shkurtit 2018 në gjykimin e PSRK-

⁵³³ SPOE00213595-SPOE00213597-ET, f. 1-3.

së, z. Krasniqi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) rolin dhe detyrat e tij në kuadër të UÇK-së;⁵³⁴ (ii) rolin e anëtarëve dhe udhëheqësve të tjerë të UÇK-së;⁵³⁵ (iii) funksionet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së;⁵³⁶ (iv) lidhjen e tij me Fatmir Limajn;⁵³⁷ (v) çfarë dinte për vrasjet e Ramiz Hoxhës dhe Selman Binishit;⁵³⁸ dhe (vi) arrestimin e dy anëtarëve të LDK-së.⁵³⁹ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Krasniqit nuk kundërshtoi relevancën e dëshmisë së tij si dëshmitar të shkurtit 2018 në gjykimin e PSRK-së. Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e shkurtit 2018 në gjykimin e PSRK-së ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

191. Trupi Gjykses vëren se, para fillimit të dëshmisë, z. Krasniqi “u informua nga gjykata se ka detyrimin të tregojë të vërtetën dhe se dhënia e dëshmisë së rreme përbën vepër penale, se mund të refuzojë t’u përgjigjet pyetjeve nëse beson se me këtë mund ta vërë veten ose një të afërm të ngushtë të tij para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose dëmi tjetër”.⁵⁴⁰ Trupi Gjykses është bindur se z. Krasniqi u informua siç duhet për të drejtën e mosinkriminimit të vetes, me gjithë mospërputhjen mes formulimit të paralajmërimit që iu dha në fillim të dëshmisë dhe atij që kërkohet tani nga DHS-ja.⁵⁴¹ Trupin Gjykses nuk e bind argumenti i Mbrojtjes së Krasniqit se është e padrejtë që Trupi Gjykses të mbështetet në dëshmitë që u dhanë pa garancitë që i jepen një të dyshuari, në dëm të z. Krasniqi.⁵⁴² Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklaratë dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një dëshmitar që nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose

⁵³⁴ SPOE00068088-SPOE00068094-ET, f. 2-7.

⁵³⁵ SPOE00068088-SPOE00068094-ET, f. 2-7.

⁵³⁶ SPOE00068088-SPOE00068094-ET, f. 2, 6.

⁵³⁷ SPOE00068088-SPOE00068094-ET, f. 6.

⁵³⁸ SPOE00068088-SPOE00068094-ET, f. 3.

⁵³⁹ SPOE00068088-SPOE00068094-ET, f. 2-7.

⁵⁴⁰ SPOE00068088-SPOE00068094-ET, f. 2.

⁵⁴¹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 41.

⁵⁴² Përgjigjja e Krasniqit, para. 42.

gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t'i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.⁵⁴³ Trupi Gjykses gjithashtu përsërit edhe një herë se parimi i mosinkriminimit të vetes nuk përbën arsye për të refuzuar detyrën qytetare për të dhënë dëshmi në një çështje penale, por është garanci ndaj dhënies pa dashje të ndonjë informacioni inkriminues. Nuk ka asnjë tregues se PSRK-ja e shkeli këtë garanci ose se veprimi në mënyrë të pandershme ose të paarsyeshme kur e intervistoi z. Krasniqi si dëshmitar e jo si të dyshuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e shkurtit 2018 në gjykimin e PSRK-së u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se dëshmia e shkurtit 2018 në gjykimin e PSRK-së ka datë dhe përbëhet nga transkripti i një seance në një proces penal në Gjykatën Themelore të Gjakovës.⁵⁴⁴ Trupi Gjykses është i mendimit se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit,⁵⁴⁵ fakti që dëshmia e shkurtit 2018 në gjykimin e PSRK-së nuk u incizua nuk cenon mbështetshmërinë në të, pasi deklaratimet e z. Krasniqi u transkriptuan gjatë seancës gjyqësore në Gjykatën Themelore të Gjakovës dhe palët nuk kundërshtuan dokumentimin në formë të transkriptuar.⁵⁴⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e shkurtit 2018 në gjykimin e PSRK-së është në pamje të parë autentike dhe, për rrjedhojë, ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova në lidhje me cilindo aspekt të diskutuar në këto dokumente që e konteston dhe/ose të paraqesë prova në lidhje me to. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit,⁵⁴⁷ vlera provuese e dëshmisë së shkurtit 2018 në gjykimin e PSRK-së nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

⁵⁴³ *Shih më lart* para. 129, 159-160.

⁵⁴⁴ SPOE00068088-SPOE00068094-ET, f. 1-7.

⁵⁴⁵ Përgjigjja e Krasniqit, para. 40.

⁵⁴⁶ SPOE00068088-SPOE00068094-ET, f. 1.

⁵⁴⁷ Përgjigjja e Krasniqit, para. 41.

192. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e shkurtit 2018 e Krasniqit në gjykimin e PSRK-së, ka lidhje me lëndën dhe është në pamje të parë autentike, u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj dhe, rrjedhimisht, është e pranueshme sipas rregullës 138(1).

iii. Deklarata si dëshmitar e Krasniqit dhënë TPNJ-së në maj 2007

193. Trupi Gjykses vëren se, në deklaratën si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007, z. Krasniqi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) ngjarjet që lidhen me konfliktin në Kosovë, si sulmi i janarit 1998 kundër familjes Jashari;⁵⁴⁸ (ii) rolin e tij në UÇK;⁵⁴⁹ (iii) strukturën e UÇK-së, organizimin e anëtarëve, zonat operative, armët, rekrutimet dhe fondet;⁵⁵⁰ dhe (iv) Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.⁵⁵¹ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Krasniqit nuk kundërshtoi relevancën e deklaratës së tij si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007. Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007 ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

194. Trupi Gjykses vëren se z. Krasniqi: (i) konfirmoi se shkoi në TPNJ vullnetarisht dhe nuk u detyrua apo kërcënua për të shkuar atje;⁵⁵² (ii) konfirmoi se deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007 ishte autentike, me sa kishte dijeni dhe i kujtohej, dhe se e kishte dhënë atë vullnetarisht, i vetëdijshëm se mund të përdorej në proceset gjyqësore të TPNJ-së dhe se mund të thirrej për të dëshmuar para Tribunalit;⁵⁵³ dhe (iii) në fillim të dëshmisë së majit 2007 në

⁵⁴⁸ IT-04-84 P00328, f. 3.

⁵⁴⁹ IT-04-84 P00328, f. 2.

⁵⁵⁰ IT-04-84 P00328, f. 3-4.

⁵⁵¹ IT-04-84 P00328, f. 2-7.

⁵⁵² IT-04-84 P00328, f. 2.

⁵⁵³ IT-04-84 P00328, f. 8.

gjykimin e TPNJ-së, konfirmoi se i kishte dhënë TPNJ-së deklaratë si dëshmitar në maj 2007 dhe konfirmoi saktësinë dhe vërtetësinë e saj.⁵⁵⁴ Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklarate dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një dëshmitar që nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t'i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.⁵⁵⁵ Trupi Gjykses gjithashtu mbajti parasysh jurisprudencën së cilës i referohet Mbrojtja e Krasniqit në Përgjigjen e saj lidhur me deklaratat e marra nga një institucion tjetër.⁵⁵⁶ Trupi Gjykses nuk është bindur se vendimi i TPNJ-së në çështjen *Delaliq dhe të tjerët*, në të cilin mbështetet Mbrojtja e Krasniqit, përbën precedent relevant për çështjen aktuale. Në atë çështje, z. Delaliq konsiderohej i dyshuar nga autoritetet hetimore vendore, të cilat i morën deklaratën e mëparshme. Si i tillë, ai kishte të drejtën e mbrojtjes në përputhje me atë status. Pyetja ishte nëse mbrojtja që iu akordua atij individ sipas kornizës ligjore vendore – që nuk njihte të drejtën e të dyshuarit për të pasur mbrojtës gjatë marrjes në pyetje dhe, rrjedhimisht, ishte materialisht e ndryshme nga garancitë për të dyshuarit sipas kornizës ligjore të TPNJ-së – e dëmtoi apo i shkaktoi atij padrejtësi. Për dallim nga ajo çështje, Trupi Gjykses vëren se/ kur i dha deklaratë si dëshmitar TPNJ-së në maj 2007, z. Krasniqi nuk konsiderohej i dyshuar dhe nuk kishte dallim material midis mbrojtjes që i takonte sipas kornizës ligjore të TPNJ-së dhe sipas kornizës ligjore të DHS-së. Rrjedhimisht, duhet të shqyrtohet nëse deklarata si dëshmitar u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007 u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe, për rrjedhojë, u mor

⁵⁵⁴ IT-04-84bis P00064, f. 2.

⁵⁵⁵ *Shih më lart* para. 129, 159-160.

⁵⁵⁶ Përgjigjja e Krasniqit, para. 26, që i referohet ICTY, *Prosecutor v. Delalic et al.*, IT-96-21-T, Trial Chamber, [Decision on Zdravko Mucic's Motion for the Exclusion of Evidence](#), 2 September 1997, para. 55. *Shih gjithashtu po aty* para. 46-54.

në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007 ka datë dhe është nënshkruar nga z. Krasniqi dhe personat e tjerë të pranishëm gjatë intervistës.⁵⁵⁷

195. Megjithatë, Mbrojtja e Krasniqit parashtron se, duke qenë se transkripti i deklaratës si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007 nuk pasqyron fjalë për fjalë përmbajtjen e saj dhe z. Krasniqi nuk dha pëlqimin që TPNJ-ja t'ia jepte deklaratën ZPS-së, kjo deklaratë nuk duhet pranuar si provë.⁵⁵⁸ Së pari, Trupi Gjykses vëren se si prova nuk pranohen vetëm deklaratat që dokumentojnë fjalë për fjalë intervistën. Kur ka tregues të mjaftueshëm të mbështetshmërisë, procesverbali i intervistës mund të pranohet si provë megjithëse nuk pasqyron fjalë për fjalë intervistën. Trupi Gjykses është bindur se në këtë rast këta tregues ekzistojnë. Së dyti, mosdhënia e pëlqimit nga z. Krasniqi që procesverbali i intervistës me TPNJ-në t'u jepej të tjerëve nuk është detyrues për këtë juridiksion. Lidhur me pretendimin e Mbrojtjes së Krasniqit për shkelje të premtimit, kjo ka lidhje me një juridiksion tjetër e jo me këtë juridiksion. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se Rregullorja e Procedurës dhe Provave e TPNJ-së nuk duket se përcakton mundësinë që dëshmitarët të kenë të drejtën të mos lejojnë që deklaratat e tyre t'i jepen një juridiksioni tjetër. Në qoftë se Zyra e Prokurorit të TPNJ-së e pyeti të intervistuarin në lidhje me këtë, do ta ketë pyetur në kuadër të politikës së brendshme të saj, jo si kërkesë ligjore. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se fakti që transkripti i deklaratës si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007 nuk përmban çdo fjalë dhe z. Krasniqi nuk dha pëlqimin që deklarata t'i jepej ZPS-së, nuk cenon mbështetshmërinë në dokument, pasi Trupi Gjykses është bindur se z. Krasniqi e

⁵⁵⁷ IT-04-84 P00328, f. 1-8.

⁵⁵⁸ Përgjigjja e Krasniqit, para. 33-34.

dha deklaratën vullnetarisht dhe ai vetë konfirmoi më vonë saktësinë dhe vërtetësinë e deklaratës së tij si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007.⁵⁵⁹

196. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007, është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar deklaratën si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007, të cilën Trupi Gjykses më pas do ta vlerësojë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit,⁵⁶⁰ vlera provuese e deklaratës së tij si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

197. Në lidhje me provat materiale shoqëruese, Trupi Gjykses vëren se ato iu treguan z. Krasniqi dhe u diskutuan me njëfarë hollësie gjatë dhënies së deklaratës së tij si dëshmitar.⁵⁶¹ Trupi Gjykses është bindur se provat materiale shoqëruese janë pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e deklaratës si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se ato: (i) kanë lidhje me lëndën dhe ofrojnë kontekst relevant për dokumentin me shkrim në të cilin diskutohen; (ii) në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit, kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti; dhe (iii) kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre. Trupin Gjykses nuk e bindin argumentet e Mbrojtjes së Veselit në lidhje me provën materiale shoqëruese 13,⁵⁶² pasi ajo përmban një komunikatë me datë, që duket se u lëshua nga UÇK-ja dhe u publikua në gazetën *Koha Ditore*, e, rrjedhimisht, ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti.⁵⁶³

198. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se: (i) deklarata si dëshmitar e Krasniqit dhënë TPNJ-së në maj 2007 u mor në përputhje me

⁵⁵⁹ IT-04-84bis P00064, f. 2.

⁵⁶⁰ Përgjigjja e Krasniqit, para. 37.

⁵⁶¹ IT-04-84 P00328, f. 4-7 (provat materiale shoqëruese 1-19).

⁵⁶² Përgjigjja e Veselit, para. 29-30, 35-37.

⁵⁶³ *Shih* Vendimin e Dytë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 73.

standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; dhe (ii) deklarata si dëshmitar e Krasniqit dhënë TPNJ-së në maj 2007 dhe provat materiale shoqëruese kanë lidhje me lëndën dhe janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).

iv. Dëshmia e Krasniqit e shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së

199. Trupi Gjykses vëren se, në dëshminë e tij të shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së, z. Krasniqi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i)) ngjarje në lidhje me konfliktin në Kosovë;⁵⁶⁴ (ii) krijimin e UÇK-së;⁵⁶⁵ (iii) rolin e tij në UÇK dhe rolin e anëtarëve të tjerë të UÇK-së;⁵⁶⁶ (iv) lëshimin e komunikatave të UÇK-së dhe intervistat e dhëna prej tij si zëdhënës i UÇK-së;⁵⁶⁷ (v) strukturën dhe zonat operative të UÇK-së, dhe anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm;⁵⁶⁸ (vi) arrestimet dhe ndalimet;⁵⁶⁹ (vii) “luftën speciale”;⁵⁷⁰ dhe (viii) konferencën e Rambujesë.⁵⁷¹ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Krasniqit nuk kundërshtoi relevancën e dëshmisë së shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

200. Trupi Gjykses vëren se, në fillim të dëshmisë së tij, z. Krasniqi iu kërkuar të lexonte me zë betimin e shtypur në kartelën që iu dha dhe pas kësaj deklaroi solemnisht se “do të thoshte të vërtetën, gjithë të vërtetën dhe asgjë tjetër përveç të vërtetës.”⁵⁷² Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklarate dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një

⁵⁶⁴ IT-03-66 T3285-T3365, f. 15; IT-03-66 T3366-T3447, f. 3, 15.

⁵⁶⁵ IT-03-66 T3285-T3365, f. 9-10.

⁵⁶⁶ IT-03-66 T3285-T3365, f. 29, 61.

⁵⁶⁷ IT-03-66 T3285-T3365, f. 29-33, 40, 52, 61-62, 75-79; IT-03-66 T3366-T3447, f. 27-29, 58-61.

⁵⁶⁸ IT-03-66 T3285-T3365, f. 26-29, 40; IT-03-66 T3366-T3447, f. 49-51; IT-03-66 T3448-T3540, f. 19-21.

⁵⁶⁹ IT-03-66 T3448-T3540, f. 2-3.

⁵⁷⁰ IT-03-66 T3366-T3447, f. 32-33.

⁵⁷¹ IT-03-66 T3285-T3365, f. 29-30.

⁵⁷² IT-03-66 T3285-T3365, f. 2.

dëshmitar që nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t'i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.⁵⁷³ Trupi Gjykses vëren se Zyra e Prokurorit të TPNJ-së nuk kishte detyrimin ta informonte z. Krasniqi për të drejtën e mosinkriminimit të vetes, pasi ai nuk konsiderohej si i dyshuar, por si dëshmitar.⁵⁷⁴ Z. Krasniqi mori urdhërparaqitje për të dëshmuar në gjykimin *Limaj dhe të tjerët*. Trupi Gjykses vëren se urdhërparaqitja nuk përbën kufizim të së drejtës së dëshmitarit për të mos iu përgjigjur pyetjeve inkriminuese. Kjo është e qartë nga formulimi i rregullës 90(E) të Rregullores së TPNJ-së, e cila ka zbatim të përgjithshëm, përfshirë edhe në atë situatë. Urdhërparaqitja është thjesht instrument procedural që përdoret për ta sjellë dëshmitarin në gjykatë për të dhënë dëshmi. Në këtë kuptim, fakti që z. Krasniqi mori urdhër për t'u paraqitur në gjykatë nuk do të thotë se ai u detyrua të jepte dëshmi inkriminuese. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se z. Krasniqi iu dha mundësia të shpjegonte arsyet për mosparaqitjen vullnetarisht.⁵⁷⁵ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren se ai nuk shprehu ndonjë shqetësim për rrezikun e inkriminimit të vetes. Siç u vu në dukje më lart, e drejta e mosinkriminimit të vetes nuk duhet ngatërruar me të drejtën për të mos dhënë dëshmi në një çështje penale.⁵⁷⁶ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se z. Krasniqi nuk ushtroi të drejtën të mos u përgjigjej pyetjeve për të mos inkriminuar veten. Për rrjedhojë, ndonëse Trupi Gjykses pajtohet se, fakti që z. Krasniqi mori urdhërparaqitje ndikoi në *paraqitjen* vullnetarisht ose jo të tij në TPNJ, nuk ka tregues që kjo e bëri të jepte informacion inkriminues që përndryshe nuk do të kishte qenë i gatshëm t'ia jepte gjykatës. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se në dëshminë së majit 2007 në gjykimin e TPNJ-së, z. Krasniqi konfirmoi se në dëshminë e shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së kishte thënë të vërtetën dhe se po

⁵⁷³ *Shih më lart* para. 129, 159-160, 194.

⁵⁷⁴ *Shih* rregullën 90(E) të RRPP-së të TPNJ-së dhe *më lart* para. 159, poshtëshënimin 451.

⁵⁷⁵ IT-03-66 T3285-T3365, f. 7.

⁵⁷⁶ *Shih më lart* para. 188, 191.

të pyetej sërish për të njëjtën temë, do të jepte të njëjtat përgjigje.⁵⁷⁷ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se, ndonëse mori urdhërparaqitje për të dëshmuar në gjykimin *Limaj dhe të tjerët*, dëshmia e z. Krasniqi e shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se dëshmia e shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së ka datë dhe përbëhet nga transkripti i tri seancave në procesin *Limaj dhe të tjerët* në TPNJ.⁵⁷⁸ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Krasniqit nuk kundërshtoi autenticitetin e dëshmisë së shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së është në pamje të parë autentike dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar cilindo aspekt të dëshmisë së shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së që ajo e konteston, si edhe të thërrasë dëshmitarë, nëse do të jetë e nevojshme, në lidhje me ato aspekte. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit,⁵⁷⁹ vlera provuese e dëshmisë së shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

201. Në lidhje me provat materiale shoqëruese, Trupi Gjykses vëren se z. Krasniqi iu treguan materialet IT-03-66 P49, IT-03-66 P138, IT-03-66 P139 dhe IT-03-66 P140, që u diskutuan me njëfarë hollësie me të gjatë dëshmisë në gjykim.⁵⁸⁰ Trupi Gjykses është bindur se provat materiale shoqëruese janë pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e dëshmisë së shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se ato: (i) kanë lidhje me lëndën dhe

⁵⁷⁷ IT-04-84 P00328, para. 9; IT-04-84bis P00064, f. 4, rreshtat 9-16, f. 127, rreshtat 7-9, f. 141, rreshtat 18-23; IT-04-84bis P00063 Konfidencial, f. 8, rreshtat 22-23, f. 11, rreshtat 14-15, f. 12, rreshtat 17-18, f. 13, rreshtat 1-3, f. 19, rreshtat 23-24, f. 27, rreshtat 1-2, f. 49, rreshtat 24-25, f. 107, rreshtat 3-4. *Shih gjithashtu më lart* paragrafin 194 dhe *më poshtë* paragrafin 204.

⁵⁷⁸ IT-03-66 T3285-T3365; IT-03-66 T3366-T3447; IT-03-66 T3448-T3540.

⁵⁷⁹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 37.

⁵⁸⁰ *Shih p.sh.* IT-03-66 T3285-T3365, f. 28-67, 69-70 (IT-03-66 P49), 67-69, 71-80 (IT-03-66 P138; IT-03-66 P139; IT-03-66 P140); IT-03-66 3366-3447, f. 10-24, 61 (IT-03-66 P49), 57-60 (IT-03-66 P140).

ofrojnë kontekst relevant për dokumentin me shkrim ku diskutohen; (ii) në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes së Krasniqit,⁵⁸¹ kanë tregues të mjaftueshëm autenticiteti; dhe (iii) kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre. Në lidhje me IT-03-66 P1.5, IT-03-66 P147, IT-03-66 P148 dhe IT-03-66 P150, Trupi Gjykses vëren se këto materiale nuk u diskutuan me z. Krasniqi gjatë dëshmisë së shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së.⁵⁸² Trupi Gjykses nuk është bindur se materialet IT-03-66 P1.5, IT-03-66 P147, IT-03-66 P148 dhe IT-03-66 P150 janë pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e dëshmisë së shkurtit 2005 në gjykimin e TPNJ-së dhe, rrjedhimisht refuzon pranimin e tyre si prova materiale shoqëruese, pa përjashtuar mundësinë e paraqitjes së një kërkesë tjetër në lidhje me to.

202. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se: (i) dëshmia e shkurtit 2005 e Krasniqit në gjykimin e TPNJ-së u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; (ii) dëshmia e shkurtit 2005 e Krasniqit në gjykimin e TPNJ-së dhe provat materiale shoqëruese IT-03-66 P49, IT-03-66 P138, IT-03-66 P139 dhe IT-03-66 P140, kanë lidhje me lëndën, janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1); dhe (iii) materialet IT-03-66 P1.5, IT-03-66 P147, IT-03-66 P148 dhe IT-03-66 P150 nuk mund të pranohen si prova materiale shoqëruese të dëshmisë dhe, për rrjedhojë, nuk pranohen, pa përjashtuar mundësinë e paraqitjes së një kërkesë tjetër në lidhje me to.

v. Dëshmia e Krasniqit e majit 2007 në gjykimin e TPNJ-së

203. Trupi Gjykses vëren se, në dëshminë e tij të majit 2007 në gjykimin e TPNJ-

⁵⁸¹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 75(i).

⁵⁸² *Shih p.sh.* IT-03-66, T3448-T3540, f. 55 (IT-03-66 P1.5), 56-57 (IT-03-66 P147), 67-73 (IT-03-66 P148), 75-85 (IT-03-66 P150).

së, z. Krasniqi dha dëshmi në të cilën ZPS-ja synon të mbështetet lidhur me pretendime, ndër të tjera, për: (i) rolin e tij në UÇK dhe kontaktet me anëtarë të tjerë të UÇK-së;⁵⁸³ (ii) operacionet ushtarake të UÇK-së;⁵⁸⁴ (iii) trajtimin e të ashtuquajturve “bashkëpunëtorë”;⁵⁸⁵ dhe (iv) komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe aktivitetet e përshkruara në to.⁵⁸⁶ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Krasniqit nuk kundërshtoi relevancën e dëshmisë së majit 2007 në gjykimin e TPNJ-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se dëshmia e majit 2007 në gjykimin e TPNJ-së ka lidhje me akuzat në Aktakuzë.

204. Trupi Gjykses vëren se, në fillim të dëshmisë, z. Krasniqi iu kërkua të përsëriste deklaratën solemne se “do të thoshte të vërtetën, gjithë të vërtetën dhe asgjë tjetër përveç të vërtetës”, që ai e bëri.⁵⁸⁷ Për arsyet e përmendura më lart, Trupin Gjykses nuk e bind argumenti i Mbrojtjes së Krasniqit se mosinformimi i dëshmitarit për të drejtën e mosinkriminimit të vetes dhe të drejtën për përfaqësim juridik cenon karakterin vullnetar të dëshmisë së dëshmitarit ose mbështetshmërinë në të. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mëparshëm të tij se për pranimin e një deklarate të dhënë autoriteteve hetimore të mëparshme nga një dëshmitar i cili nuk konsiderohej i dyshuar në kohën e dhënies së deklaratës ose gjatë intervistimit apo dhënies së dëshmisë, nuk është e nevojshme që atij t’i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari.⁵⁸⁸ Trupi Gjykses vëren se Zyra e Prokurorit të TPNJ-së nuk kishte detyrimin ta informonte z. Krasniqi për të drejtën e mosinkriminimit të vetes, sepse ai konsiderohej si dëshmitar, jo si i dyshuar.⁵⁸⁹ Trupi Gjykses thekson përsëri se detyrimi për të thënë të vërtetën, nën të cilin dha dëshmi z. Krasniqi, nuk

⁵⁸³ IT-04-84bis P00064, f. 6, 13-14, 33-34, 73-74, 115, 210.

⁵⁸⁴ IT-04-84bis P00064, f. 16-18.

⁵⁸⁵ IT-04-84bis P00064, f. 32, 77-80, 100-101, 120-130, 163-174.

⁵⁸⁶ IT-04-84bis P00064, f. 2, 6, 8-9.

⁵⁸⁷ IT-04-84bis P00064, f. 1.

⁵⁸⁸ *Shih më lart* para. 129, 159-160, 194.

⁵⁸⁹ *Shih* rregullën 90(E) të RPP-së të TPNJ-së dhe *më lart* para. 159, poshtëshënimin 451.

përjashton mundësinë që ai të kundërshtojë dhënien e dëshmisë inkriminuese. Kjo është e qartë nga fjalë e dytë dhe e tretë e rregullës 90(E) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të TPNJ-së, në frymën e së cilës mbështetet drejtpërdrejt rregulla 151. Me fjalë të tjera, betimi nën të cilin dha dëshmi z. Krasniqi, nuk e detyroi atë të hiqte dorë nga e drejta e mosinkriminimit të vetes.⁵⁹⁰ Ai thjesht bëri që ushtrimi i saj të bëhej sipas një procedure të veçantë. Trupi Gjykses është i mendimit se dëshmia e majit 2007 në gjykimin e TPNJ-së u dha vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm dhe u mor në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se dëshmia e majit 2007 në gjykimin e TPNJ-së përbëhet nga transkriptet e tri seancave në gjykimin *Haradinaj dhe të tjerët* në TPNJ.⁵⁹¹ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Mbrojtja e Krasniqit nuk kundërshtoi autenticitetin e deklaratës së tij si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se deklarata si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007 është autentike në pamje të parë dhe ka vlerë provuese. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për të kundërshtuar aspektet e këtij dokumenti që i konteston dhe të thërrasë dëshmitarë, nëse do të jetë e nevojshme, në lidhje me to. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit,⁵⁹² vlera provuese e deklaratës si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj.

205. Në lidhje me provat materiale shoqëruese, Trupi Gjykses vëren se z. Krasniqi iu tregua materiali IT-04-84 D00037 dhe ai u diskutua me njëfarë hollësie gjatë dëshmisë së tij në gjykim.⁵⁹³ Trupi Gjykses është bindur se kjo provë materiale shoqëruese është pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e dëshmisë së majit 2007

⁵⁹⁰ *Shih më lart* para. 159-160.

⁵⁹¹ IT-04-84bis P00064, f. 1-216.

⁵⁹² Përgjigjja e Krasniqit, para. 37.

⁵⁹³ IT-04-84bis P00064, f. 132-133.

në gjykimin e TPNJ-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se ajo: (i) ka lidhje me lëndën dhe ofron kontekst relevant për dokumentin me shkrim në të cilin diskutohet; (ii) ka tregues të mjaftueshëm autenticiteti; dhe (iii) ka vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të saj. Në lidhje me materialin U003-8552-U003-8690, Trupi Gjykses vëren se: (i) dokumentet e përfshira aty, që iu treguan z. Krasniqi dhe u diskutuan me të gjatë dëshmisë së majit 2007 në gjykimin e TPNJ-së, iu treguan z. Krasniqi dhe u diskutuan me të edhe gjatë deklaratës si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007;⁵⁹⁴ (ii) Trupi Gjykses i konstatoi këto dokumente të pranueshme si prova kur trajtoi më lart deklaratën si dëshmitar dhënë TPNJ-së në maj 2007;⁵⁹⁵ dhe (iii) dokumentet e tjera nuk iu treguan z. Krasniqi dhe nuk u diskutuan prej tij në dëshminë e majit 2007 në gjykimin e TPNJ-së, dhe për disa prej tyre Trupi Gjykses tashmë ka marrë vendim.⁵⁹⁶ Për këto arsye, Trupi Gjykses nuk është bindur se materiali U003-8552-U003-8690 është pjesë e domosdoshme dhe e pandashme e dëshmisë së Krasniqit të majit 2007 në gjykimin e TPNJ-së, dhe, rrjedhimisht refuzon pranimin e tyre si prova materiale shoqëruese pa përjashtuar mundësinë e paraqitjes së një kërkesë tjetër në lidhje me to.

206. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se: (i) dëshmia e majit 2007 e Krasniqit në gjykimin e TPNJ-së u mor në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; (ii) dëshmia e majit 2007 e Krasniqit

⁵⁹⁴ *Shih më lart* para. 183, poshtëshënimin 501. *Shih* IT-04-84bis P00064, f. 24, rreshtat 7-10, f. 173, rreshtin 18 deri në f. 175, rreshtin 22 (Shtojca 1); f. 24, rreshtin 23 deri në f. 25, rreshtin 6, f. 100, rreshtin 6 deri në f. 102, rreshtin 1, f. 173, rreshtin 18 deri në f. 175, rreshtin. 22, f. 178, rreshtin 17 deri në f. 181, rreshtin 23 (Shtojca 2); f. 15, rreshtin 14 deri në f. 21, rreshtin 5, f. 23, rreshtin 20 deri në f. 24, rreshtin 3 (Shtojca 3); f. 25, rreshtat 8-11, f. 173, rreshtin 18 deri në f. 175, rreshtin. 22 (Shtojca 4); f. 10, rreshtin 23 deri në f. 14, rreshtin 15, f. 32, rreshtin 14 deri në f. 40, rreshtin 11, f. 49, rreshtin 21 deri në f. 53, rreshtin 23, f. 117, rreshtin 15 deri në f. 119, rreshtin 2, f. 173, rreshtin 18 deri në f. 175, rreshtin 22 (Shtojca 5); f. 25, rreshtat 12-15, f. 26, rreshtat 1-5 (Shtojca 6); f. 26, rreshtat 6-9, f. 123, rreshtin 9 deri në f. 126, rreshtin 24 (Shtojca 7); f. 26, rreshtat 10-13 (Shtojca 8); f. 26, rreshtat 14-16, f. 102, rreshtin 2 deri në f. 104, rreshtin 21 (Shtojca 9); f. 26, rreshtat 17-20 (Shtojca 10); f. 74, rreshtin 11 deri në f. 80, rreshtin 16, f. 99, rreshtat 5-23 (Shtojca 18); f. 26, rreshtin 21 deri në f. 28, rreshtin 15 (Shtojcat 11-19); f. 74, rreshtat 4-9 (Shtojcat 14-19).

⁵⁹⁵ *Shih më lart* paragrafët 197-198.

⁵⁹⁶ *Shih më lart* paragrafin 22, poshtëshënimin 42.

në gjykimin e TPNJ-së dhe prova materiale shoqëruese IT-04-84 D00037, kanë lidhje me lëndën dhe janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1); dhe (iii) U003-8552-U003-8690 nuk mund të pranohet si provë materiale shoqëruese dhe nuk pranohet si provë pa përjashtuar mundësinë e paraqitjes së një kërkesë tjetër në lidhje me të.

(c) Përfundim

207. Bazuar në sa ma lart, Trupi Gjykses konstaton se: (i) deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Krasniqit u morën në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; (ii) deklaratat dhe dëshmitë si dëshmitar të Krasniqit dhe provat materiale shoqëruese IT-03-66 P49, IT-03-66 P138, IT-03-66 P139, IT-03-66 P140 dhe IT-04-84 D00037, kanë lidhje me lëndën dhe janë në pamje të parë autentike, kanë vlerë provuese që nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre, dhe, rrjedhimisht, janë të pranueshme sipas rregullës 138(1); dhe (iii) provat materiale shoqëruese IT-03-66 P1.5, IT-03-66 P147, IT-03-66 P148, IT-03-66 P150 dhe U003-8552-U003-8690, nuk mund të pranohen si prova materiale shoqëruese dhe, për rrjedhojë nuk pranohen si prova pa përjashtuar mundësinë e paraqitjes së një kërkesë tjetër në lidhje me to.

D. PRANUESHMËRIA E DEKLARATAVE TË TË AKUZUARVE KUNDËR TË BASHKAKUZUARVE

208. Pasi ka konstatuar se deklaratat e të akuzuarve dhe provat materiale shoqëruese janë të pranueshme si prova në bazë të rregullës 138, Trupi Gjykses tani do të vlerësojë nëse ka ndonjë kufizim ndaj përdorimit të tyre kundër të bashkakuzuarve.

1. Parashtrime

209. ZPS-ja parashtron se nuk ka arsye për të vënë në dyshim drejtësinë e procesit dhe, për rrjedhojë, të gjitha deklaratat e mëparshme duhet të pranohen si prova. ZPS-ja pranon se aftësia e një të akuzuari për të verifikuar provat kundër tij është aspekt i rëndësishëm i gjykimit të drejtë,⁵⁹⁷ por parashtron se, në qoftë se disa prej tyre, ose të gjithë, zgjedhin të mos dëshmojnë: (i) ata gjithsesi do të jenë në gjendje t'i kundërshtojnë me efektivitet provat duke përdorur prova të tjera, si dhe përmes mundësisë që të paraqesin versionin e tyre të ngjarjeve dhe të kundërshtojnë mbështetshmërinë në ato prova; (ii) ZPS-ja do të paraqesë dëshmi gojore dhe dokumentare për aspektet e trajtuara në deklaratat e mëparshme; dhe (iii) në rastet kur janë të disponueshme audioincizimet dhe/ose videoincizimet e tyre, Trupit Gjykues do të ketë mundësinë të vëzhgojë sjelljen e të akuzuarve.⁵⁹⁸ ZPS-ja parashtron se këto garanci i mundësojnë Trupit Gjykues të kryejë vlerësim të drejtë dhe të saktë të deklaratave në kontekstin e tërësisë së provave dhe vëren se rregulla 140(4) përcakton se, kur Mbrojtja nuk ka pasur mundësi ta pyesë dëshmitarin, shpallja e fajësisë nuk mund të bazohet vetëm, ose në një masë vendimtare, në ato prova.⁵⁹⁹

210. Ndonëse pranon konstatimin e mëhershëm të Trupit Gjykues se “pranimi i dokumentit ose i deklaratës së një të akuzuari, pa faktorë të tjerë, nuk cenon të drejtat themelore të të bashkëpandehurve”, Mbrojtja e Thaçit kundërshton përdorimin në të ardhmen të deklaratave të mëparshme të të akuzuarve si prova në lidhje me elemente kritike të provave dhe argumenteve të ZPS-së, përveç kur konfirmohen nga prova të tjera, ose përdorimin e tyre si prova të veprimeve ose sjelljes së z. Thaçi.⁶⁰⁰

⁵⁹⁷ Kërkesa, para. 91.

⁵⁹⁸ Kërkesa, para. 91.

⁵⁹⁹ Kërkesa, para. 91-92.

⁶⁰⁰ Përgjigjja e Thaçit, para. 36-43 që i referohen ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-AR73.6, Appeals Chamber, Decision on Appeals Against Decision Admitting Transcript of Jadranko Prlić's Questioning

211. Mbrojtja e Selimit përgjigjet se nëse deklaratat pranohen, për to duhet të vendosen kufizime që: (i) ato mund të pranohen vetëm kundër të akuzuarit që ka dhënë deklaratën ose intervistën, jo kundër të bashkakuzuarve të tij; dhe (ii) nëse përdoren kundër një të bashkakuzuari, ato nuk mund të pranohen si prova për veprimet ose sjelljen e të bashkakuzuarve apo si prova në lidhje me elemente kritike të provave dhe argumenteve të ZPS-së, përveç nëse konfirmohen nga dëshmi të tjera.⁶⁰¹

212. Mbrojtja e Veselit përgjigjet se, nëse deklaratat e një të akuzuari pranohen, Trupi Gjyqësor duhet t'i përdorë ato vetëm kundër atij të pandehuri.⁶⁰² Mbrojtja e Veselit parashtrohet se përdorimi i deklaratës së një të bashkakuzuari për të vërtetuar veprimet dhe sjelljen e z. Veseli, do të ishte më shumë dëmtes sesa me vlerë provuese, përveç nëse dhënësi i saj jep dëshmi gojore në proces. Rrjedhimisht, ajo parashtrohet se deklaratat janë të papranueshme si prova kundër të bashkakuzuarve në bazë të rregullës 138(1) – lexuar së bashku me nenin 123 të KPPK-së, i cili plotëson kornizën ligjore të DHS-së e cila nuk e trajton këtë aspekt.⁶⁰³ Për ta çuar më tej këtë argument, Mbrojtja e Veselit rikujton se një numër juridiksionesh pranojnë vendosjen e kufizimeve të ngjashme ndaj qëllimit për të cilin mund të përdoren deklaratat e një të bashkakuzuari.⁶⁰⁴ Si alternativë, Mbrojtja e Veselit parashtrohet se disa pjesë të deklaratave të të bashkakuzuarve duhet të përjashtohen, pasi ndikimi i tyre dëmtes zhbën vlerën provuese të tyre dhe,

Into Evidence ("[Prlić et al. Appeal Decision](#)"), 23 November 2007, paras 57, 59, 60; TPNJ, *Prokurori kundër Shainoviqit dhe të tjerëve*, IT-05-87-T, Dhoma Gjyqësore, [Judgement](#) (Aktgjykim) 26 shkurt 2009, para. 42; ICTR, *Prosecutor v. Karemera and Ndirumapatse*, ICTR-98-44-T, Trial Chamber III, [Decision on Prosecution Motion for Admission into Evidence of Post-Arrest Interviews with Joseph Nzirorera and Matthieu Ndirumapatse](#), 2 November 2007, paras 44-46

⁶⁰¹ Përgjigjja e Selimit, para. 59-85, 87 që i referohet, ndër të tjera, rregullës 155(5); neneve 119(5), 142(4), 256(1) dhe 345 të KPPK-së; ICTY, [Prlić et al. Appeal Decision](#), para. 40; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber II, [Decision on the Admissibility of the Borovčanin Interview and the Amendment of the Rule 65 ter Exhibit List](#), 25 October 2007, footnote 167; ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-2635, Trial Chamber II, [Decision on the Prosecutor's Bar Table Motions](#), 17 December 2010, para. 53.

⁶⁰² Përgjigjja e Veselit, para. 3, 21.

⁶⁰³ Përgjigjja e Veselit, para. 16-19, 21.

⁶⁰⁴ Përgjigjja e Veselit, para. 20.

gjithsesi, nuk duhet të pranohen si provë e vërtetësisë së përmbajtjes së tyre.⁶⁰⁵ Konkretisht, Mbrojtja e Veselit parashtroi se disa pjesë të deklaratave të z. Selimi përbëjnë dëshmi të dorës së dytë të një lloji të veçantë, të cilat, nëse përdoren për vërtetësinë e përmbajtjes së tyre, do të cenonin haptazi të drejtën e z. Veseli për gjykim të drejtë.⁶⁰⁶

213. Mbrojtja e Krasniqit kundërshton përdorimin e deklaratave dhe dëshmive të mëhershme të të bashkakuzuarve, sepse z. Krasniqi nuk mund t'u kundërvihet këtyre provave gjatë pyetjeve në cilësinë e palës jothirrëse, çka bie ndesh me të drejtat e tij sipas nenit 21(4)(f), dhe mbështetja në deklaratat të tilla do të ishte tejet dëmtuese.⁶⁰⁷ Mbrojtja e Krasniqit parashtroi se, në kundërshtim me parashtrimin e ZPS-së, ky efekt dëmtues nuk mund të korrigjohet duke vendosur "garanci mbrojtëse dhe masa kompensuese të konsiderueshme", që nuk është gjë tjetër veçse një formulim i përgjithshëm.⁶⁰⁸

214. ZPS-ja kundërpërgjigjet se deklaratat duhet të pranohen pa kufizime dhe argumenton se, sikurse u konstatua nga Trupi Gjyqësor, pranimi i tyre, pa faktorë të tjerë, nuk cenon të drejtat themelore të të bashkakuzuarve.⁶⁰⁹

2. Vlerësimi i Trupit Gjyqësor

215. Trupi Gjyqësor rikujton paraprakisht se kriteret për pranimin e provave përcaktohen në Rregullore, në varësi të garancive që përcaktohen në Ligj dhe Kushtetutë. As Kushtetuta, as Ligji, dhe as Rregullorja nuk trajtojnë konkretisht çështjen e pranueshmërisë së deklaratave të të bashkëpandehurve. Dispozitat e KPPK-së lidhur me pranimin e deklaratave të dhëna nga një i pandehur, në veçanti

⁶⁰⁵ Përgjigjja e Veselit, para. 4, 23.

⁶⁰⁶ Përgjigjja e Veselit, para. 4, 24-27.

⁶⁰⁷ Përgjigjja e Krasniqit, para. 58.

⁶⁰⁸ Përgjigjja e Krasniqit, para. 59.

⁶⁰⁹ Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Krasniqit, para. 14; Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Selimit, para. 10, f. 6-7; Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Thaçit, para. 10, f. 5-6; Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Veselit, para. 2.

nenet 119(5), 256(1) dhe 257(2) të KPPK-së, nuk janë pjesë e kornizës ligjore të DHS-së dhe nuk zbatohen në këtë proces. Rrjedhimisht, siç u theksua më lart, pranimi i këtyre deklaratave bëhet sipas rregullave dhe parimeve të përgjithshme për pranimin e provave në DHS, para së gjithash rregullës 138(1). Sidoqoftë, aspekti kryesor që trajtohet në nenet 119(5), 256(1) dhe 257(2) të KPPK-së, është se fajësia e të akuzuarit nuk duhet të bazohet vetëm, ose në masë vendimtare, në deklaratat të tilla. Kjo është pjesë përbërëse e sistemit për pranimin e provave që zbatohet në këtë gjykatë.⁶¹⁰

216. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se nuk ka një parim të përgjithshëm ligjor apo detyrim sipas të drejtave të njeriut që i bën këto prova të papranueshme, ose që e bën pranimin e tyre të padrejtë për të akuzuarin në një çështje penale. Trupi Gjykses mban parasysh jurisprudencën e gjykatave të tjera ndërkombëtare (të ndërkombëtarizuara), sipas së cilës pranimi i deklaratave të një të akuzuari kundër të bashkëpandehurit/bashkëpandehurve të tjerë, nuk cenon të drejtën e këtyre të fundit për gjykim të drejtë, me kusht që vlera provuese e deklaratave të mos zhbëhet prej efektit dëmtues që mund t'i shkaktojë pranimi i tyre të bashkëpandehurit/ bashkëpandehurve.⁶¹¹ Po kështu, Trupi Gjykses ka konstatuar më herët se “pranimi i dokumentit ose deklaratës së një të akuzuari, pa faktorë të tjerë, nuk cenon të drejtat themelore të të bashkëpandehurve”.⁶¹²

217. Trupi Gjykses mban parasysh se gjyksesve të fakteve u është dhënë njëfarë diskrecioni, të cilin disa prej tyre e kanë ushtruar, për të vendosur mospranimin e deklaratave të një të bashkëpandehuri në rrethanat kur kjo do të shkaktonte dëm të papërligjur.⁶¹³ Megjithatë, Trupi Gjykses i ka konstatuar të gjitha deklaratat me

⁶¹⁰ Shih rregullën 140(4); Vendimi sipas rregullës 155, para. 18.

⁶¹¹ Shih p.sh. ICTY, [Prlić et al. Appeal Decision](#), para. 62; *Prosecutor v. Gotovina et al.*, IT-06-90-T, Trial Chamber I, [Judgement](#), 15 April 2011, para. 44; *Prosecutor v. Kvočka et al.*, IT-98-30/1, Trial Chamber, [Decision on the Admission of the Record of Interview of the Accused Kvočka](#), 16 March 2001.

⁶¹² F01380, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Pranimin e Provave të Dymbëdhjetë Dëshmitarëve të Parë të ZPS-së sipas Rregullës 154*, 16 mars 2023, konfidencial, para. 50.

⁶¹³ Shih p.sh. ICTY, [Prlić et al. Appeal Decision](#), para. 62; *Prosecutor v. Boškoski and Tarčulovski*, IT-04-82-T, Trial Chamber II, [Decision on Prosecution's Motion for Admission into Evidence of Documents MFI](#)

vlerë provuese për aspekte të rëndësishme në këtë çështje gjyqësore. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se të katër të akuzuarit dhanë vullnetarisht dhe disa herë deklarata dhe dëshmi gjatë një periudhe të gjatë kohore, duke e bërë të qartë dëshirën dhe synimin për të dhënë versionin e tyre për aspekte relevante. Gjatë këtyre intervistave asnjë prej të akuzuarve nuk kërkoi të ushtronte të drejtën e mosinkriminimit të vetes, por treguan gatishmëri të jepnin versionet e tyre për fakte dhe rrethana relevante. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses vëren se, në faza të ndryshme, të akuzuarit u ndihmuan dhe këshilluan nga mbrojtës. Kjo nuk ndryshoi gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar në këto procese. Pesha apo vlera provuese që Trupi Gjykses do të jetë i gatshëm t'i japë secilës prej dëshmimeve të tyre do të vendoset në fund të procesit, bazuar në të gjitha provat relevante, sidomos ato që konfirmohen nga prova të tjera. Trupi Gjykses rithekson gjithashtu se Mbrojtja do të ketë mundësinë që përmes dëshmitarëve përkatës, të kundërshtojë cilindo aspekt të deklaratave të pranuar dhe/ose të paraqesë prova për ato aspekte. Për këtë arsye, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e deklaratave të të akuzuarve dhe e provave materiale shoqëruese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.⁶¹⁴ Trupi Gjykses është bindur se ky konstatim vlen njësoj për të akuzuarit dhe për të bashkakuzuarit, dhe se pranimi i deklaratave dhe provave materiale shoqëruese të një të akuzuari, *në vetvete*, nuk dëmton të akuzuarin apo të bashkakuzuarit. Për këto arsye, Trupi Gjykses rrëzon parashtrimet e Mbrojtjes se deklaratat e një të akuzuari mund të pranohen si prova vetëm kundër të akuzuarit që i ka dhënë.

218. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, shpallja e fajësisë e bazuar vetëm, ose në masë vendimtare, në dëshminë e një dëshmitari apo të bashkakuzuari, kur i

[P251, P379 and P435](#), 7 December 2007, paras 19, 46, 65(B)(i)-(ii); ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-2635, Trial Chamber II, [Decision on the Prosecutor's Bar Table Motions](#), 17 December 2010, para. 53.

⁶¹⁴ *Shih më lart* para. 65-67, 74-76, 80-82, 88-91, 114-115, 120-122, 129-130, 132-133, 135-137, 141-142, 144-145, 147-148, 150-151, 153-154, 156-157, 159-164, 168-169, 171-172, 174-175, 177-178, 180-182, 188-189, 191-192, 194-198, 200-202, 204-207.

akuzuari nuk pati mundësinë që dëshmitarit t'i bënte pyetje, apo që t'i bëheshin pyetje në emër të tij, gjatë hetimit ose gjykimit, cenon të drejtat e mbrojtjes sepse bie ndesh me garancitë e nenit 6 të Konventës Evropiane.⁶¹⁵ Në përputhje me këtë, rregulla 140(4)(a) përcakton se shpallja e fajësisë nuk mund të bazohet vetëm, ose në masë vendimtare, në deklaratën e një dëshmitari që Mbrojtja nuk ka pasur mundësi ta pyesë.⁶¹⁶ Trupi Gjykues vëren se i akuzuari mund të zgjedhë të mos japë dëshmi dhe, sipas kornizës ligjore të DHS-së, nuk mund të detyrohet ta dëshmojë. Nga vendimi i të akuzuarit për të mos dhënë dëshmi nuk duhet të nxirret asnjë konstatim negativ në dëm të tij. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues është i vetëdijshëm se të bashkakuzuarit mund të mos jenë në gjendje të verifikojnë plotësisht përmbajtjen e deklaratave të dhëna nga të bashkëpandehurit, të cilat mund të përmbajnë informacion që sipas tyre është i rremë, inkriminues dhe/ose në të cilin nuk mund të mbështetesh. Kjo kërkon kujdes të veçantë nga ana e Trupit Gjykues kur të vendosë se çfarë peshe do t'u japë, nëse do t'u japë peshë, deklaratave të tilla. Në këtë kontekst, Trupi Gjykues do t'i kushtojë vëmendje të veçantë ekzistencës ose jo të provave konfirmuese të verifikuara, para se të mbështetet në deklaratën e një të akuzuari në lidhje me një të bashkakuzuar, veçanërisht lidhur me ndonjë aspekt kritik ose material të provave dhe argumenteve të Prokurorisë.⁶¹⁷

⁶¹⁵ ECtHR, *Lucà v. Italy*, Application no. 33354/96, [Judgment](#), 27 February 2001, paras 39-45; *Al-Khawaja and Tahery v. the United Kingdom*, Application nos. 26766/05 and 22228/06, [Judgment \[GC\]](#), 15 December 2011, paras 126-147. *Shih gjithashtu* Vendimin sipas rregullës 155, para. 18 dhe referencat e cituara në të.

⁶¹⁶ *Shih më lart* para. 14.

⁶¹⁷ ICTY, [Prlić et al. Appeal Decision](#), paras 40, 57-61; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber II, [Decision on the Admissibility of the Borovčanin Interview and the Amendment of the Rule 65 ter Exhibit List](#), 25 October 2007, paras 77-80 (që përjashton përdorimin në lidhje me "veprimet dhe sjelljen" e një të bashkakuzuari); ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-2635, Trial Chamber II, [Decision on the Prosecutor's Bar Table Motions](#), 17 December 2010, paras 53-54 (që përjashton mbështetjen në deklarata si "provë e çdo fakti që ka të bëjë me" një të bashkakuzuar). *Shih gjithashtu* STL, *Prosecutor v. Merhi and Oneissi*, STL-11-01/A-2/AC, Appeals Chamber, [Appeal Judgment](#), 10 March 2022, para. 202, që i referohet ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 30 January 2015, para. 1226.

219. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është i mendimit se asgjë nuk pengon pranimin e deklaratave të të akuzuarve dhe provave materiale shoqëruese kundër katër të akuzuarve. Gjithsesi, Trupi Gjykses thekson se do të ushtrojë kujdesin më të madh në vlerësimin e deklaratave të të akuzuarve, duke mbajtur parasysh tërësinë e provave, lidhur me ndonjë aspekt kritik ose material të provave dhe argumenteve të Prokurorisë.

V. KLASIFIKIMI

220. Trupi Gjykses vëren se Përgjigjja e Selimit (F01473), Përgjigjja e Thaçit (F01474), Përgjigjja e Krasniqit (F01475), Përgjigjja e Veselit (F01476), Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Selimit (F01510), Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Thaçit (F01511) dhe Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Veselit (F01512), janë dorëzuar si konfidenciale. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se ZPS-ja ka kërkuar riklasifikimin si publike të Kundërpërgjigjes ndaj Përgjigjes së Selimit (F01510), Kundërpërgjigjes ndaj Përgjigjes së Thaçit (F01511) dhe Kundërpërgjigjes ndaj Përgjigjes së Veselit (F01512).⁶¹⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses: (i) udhëzon Zyrën Administrative të riklasifikojë si publike Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Selimit (F01510), Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Thaçit (F01511) dhe Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Veselit (F01512); dhe (ii) urdhëron Mbrojtjen që deri të premten, 24 nëntor 2023, të dorëzojë versionet e redaktuara publike të Përgjigjeve.

⁶¹⁸ F01665, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara F01510, F01511 dhe F01512*, 11 korrik 2023.

VI. VENDIM

221. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues:

- a) **MIRATON**, pjesërisht, Kërkesën;
- b) **PRANON** si prova këto materiale dhe përkthimet e tyre: (i) intervistën e ZPS-së me z. Thaçi të janarit 2020⁶¹⁹ dhe provat materiale shoqëruese;⁶²⁰ (ii) intervistën e ZPS-së me z. Thaçi të korrikut 2020⁶²¹ dhe provat materiale shoqëruese;⁶²² (iii) intervistën e ZPS-së me z. Selimi të nëntorit 2019 ⁶²³ dhe provën materiale shoqëruese;⁶²⁴ (iv) intervistën e ZPS-së me z. Selimi të shkurtit 2020⁶²⁵ dhe provat materiale shoqëruese;⁶²⁶ (v) intervistën e PSRK-së me z. Thaçi të majit 2016;⁶²⁷ (vi) intervistën e PSRK-së me z. Krasniqi të dhjetorit 2013;⁶²⁸ (vii) deklaratat si dëshmitar të Thaçit;⁶²⁹ (viii) deklaratat si dëshmitar dhe dëshmitë e Selimit⁶³⁰ dhe provat materiale shoqëruese;⁶³¹ (ix) deklaratat si dëshmitar dhe dëshminë e Veselit;⁶³² dhe (x) deklaratat së dëshmitar dhe dëshmitë e Krasniqit⁶³³

⁶¹⁹ 071840-TR-ET Pjesët 1-9.

⁶²⁰ 071793-071793-ET; 071794-071839.

⁶²¹ 076563-TR-ET Pjesët 1-21.

⁶²² 076565-076565-ET; 076565-076705; 076603-076603-ET; 076630-076630-ET; 076642-076642-ET.

⁶²³ 068933-TR-ET Pjesët 1-14.

⁶²⁴ 068932-068932-ET.

⁶²⁵ 074459-TR-ET Pjesët 1-9.

⁶²⁶ 074439-074439-ET; 074440-074458A.

⁶²⁷ 051716-051719-ET.

⁶²⁸ SITF00364476-00364497; 031024-05-TR-ET Pjesa 1 ; 031024-05.

⁶²⁹ SITF00009007-00009016; SPOE00213717-SPOE00213719-ET; U008-1957-U008-1967.

⁶³⁰ SITF00009289-00009298; SITF00371392-00371396; SPOE00067168-SPOE00067174-ET; SPOE00213583-SPOE00213586; SPOE00068075-SPOE00068087-ET; T000-2344-T000-2345; IT-03-66 T6583-T6589; IT-03-66 T6590-T6679; IT-03-66 T6680-T6699; IT-03-66 20050527; IT-03-66 20050530 Pjesët 1-3; IT-03-66 20050531.

⁶³¹ IT-03-66 P1.7; IT-03-66 P24; IT-03-66 P248.

⁶³² SITF00398137-SITF00398157; SITF00009124-00009133; SPOE00213660-SPOE00213662-ET; SITF00398181-00398216; SITF00253817-00253819.

⁶³³ SPOE00213595-SPOE00213597-ET; SPOE00068088-SPOE00068094-ET; IT-04-84 P00328, f. 1-9; IT-03-66 T3285-T3365; IT-03-66 T3366-T3447; IT-03-66 T3448-T3540 (f. 1-46); IT-03-66 10 shkurt 2005 Jakup KRASNIQI Pjesët 1-3; IT-03-66 14 shkurt 2005 Jakup KRASNIQI Pjesët 1-3; IT-03-66 15 shkurt 2005 Jakup KRASNIQI Pjesët 1-2; IT-04-84bis P00064; IT-04-84bis P00063 Konfidencial; IT-04-84 T5000-T5086 paredaktuar Pjesët 1-3 Konfidencial; IT-04-84 T5087-T5185 Pjesët 1-2 Konfidencial; IT-04-84 29 maj 2007

- dhe provat materiale shoqëruese IT-04-84 P00328, f. 10-94, IT-03-66 P49, IT-03-66 P138, IT-03-66 P139, IT-03-66 P140 dhe IT-04-84 D00037;
- c) **REFUZON** pranimin si prova të materialeve në vijim: IT-03-66 P1.5, IT-03-66 P147, IT-03-66 P148, IT-03-66 P150 dhe U003-8552-U003-8690 pa përjashtuar mundësinë e paraqitjes së kërkesave të tjera për to;
- d) **UDHËZON** Administratoren t'u caktojë numër prove materialeve të përmendura në paragrafin 221(b), duke i lidhur provat materiale shoqëruese të pranuar me deklaratat gjegjëse, siç përcaktohet në paragrafët 61, 68, 77, 83, 138, 183 dhe poshtëshënimet përkatëse;
- e) **UDHËZON** Zyrën Administrative që të riklasifikojë si publike Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Selimit (F01510), Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Thaçit (F01511) dhe Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Veselit (F01512);
- f) **URDHËRON** Mbrojtjen që deri **të premten, 24 nëntor 2023**, të dorëzojë versionet e redaktuara publike të Përgjigjeve; dhe
- g) **URDHËRON** ZPS-në që deri **të premten, 24 nëntor 2023**, të dorëzojë çdo kërkesë për ruajtjen e konfidencialitetit të materialeve të pranuar si prova. Përgjigjet ndaj saj duhet të dorëzohen deri **të premten, 1 dhjetor 2023**. Nuk do të pranohen Kundërpërgjigje.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 9 nëntor 2023

Në Hagë, Holandë.

Jakup KRASNIQI Pjesët 1-2; IT-04-84 30 maj 2007 Jakup KRASNIQI Pjesët 1-3; IT-04-84 31 maj 2007
Jakup KRASNIQI Pjesët 1-2.